



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në  
“Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i  
Ndërmarrjeve”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i  
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Alban Korbi

2. PhD Ani Mbrica

Korrik/2019

## **PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Përshkrim përmbledhës; 200 – 400 fjalë**

Universiteti Bujqësor i Tiranës (përmendur në vijim me inicialet UBT) është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.548, datë 28.07.1951. IAL është akredituar me Vendim BA Nr. 11, datë 07.04.2017, me kohëzgjatjen 4 vite, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2021.

UBT përbëhet nga 5 Fakultete dhe 1 Institut i Resurseve Gjenetike të Bimëve


Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” ofrohet nga departamenti “Drejtim Agrobiznesi” të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA) në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT).

Ky fakultet përbëhet nga

- Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit
- Departamenti i Ekonomisë dhe i Politikave të Zhvillimit Rural
- Departamenti i Financë-Kontabilitetit
- Departamenti i Matematikës dhe Informatikës
- Departamenti i Menaxhimi i Turizmit Rural
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja.
- Instituti i Ekonomisë dhe i Vlerësimit të Njohurive

Pranimi i studentëve që ndjekin këtë program studimi të ofruar nga Departamenti përkatës pranë UBT është realizuar sipas kritereve që vendos ligji Nr.80/2015, datë 21/05/2007 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i UMSH dhe Rregullorja e programit.

Përzgjedhja e kandidatëve vijon pas procedurës së shpalljes, nga një komision i caktuar nga dekani, bazuar në dokumentacionin e përfshirë në dosjen personale të kandidatit.



## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; (rreth 200 fjalë)**

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” filloi me prezantimin dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga IAL dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj procedure u identifikuan dhe u listuan pyetje në lidhje me standarde dhe kritere përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në Universitetin Bujqësor të Tiranës u realizua gjatë datave 14-15/05/2019, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shoqëruar nga ekspertet e ASCAL, të caktuara për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Përgjegjësin e Departamentit dhe Dekanin e FEA, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi si dhe vizitoi zyra të caktuara të këtij institucioni dhe mjediset e FEA. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe çështje për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Koordinatorë Teknike e ASCAL është Znj. Aviola Bardhi.

Më datë 19.07.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 44/46 Prot., datë 19.07.2019 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, UBT është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 24.07.2019, UBT përcjell në sistemin AMS përgjigjen për Draft – Raportin e vlerësimit të jashtëm, me të cilën shpreh dakordësinë me përmbajtjen e tij. Draft Raporti është edhe Raporti përfundimtar.


## **Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve”**

### **I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve”, i ofruar nga i ofruar nga Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, UBT i cili lidhet më së shumti me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehur në planin strategjik të Universitetit Bujqësor të Tiranës” dhe të planit strategjik të zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës bazuar në një studim të tregut të punës të përgatitur nga institucioni që përfshinë mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në përqsasje me sa më sipër, programi i studimit Master i shkencave në fushën e menaxhimit të ndërmarrjeve të agrobiznesit pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale në fushën përkatëse, i pajis studentët me njohuritë praktike, mbi metodat, parimet, si dhe formimin e shprehive të veçanta në fushën e menaxhimit të agrobiznesit, marketingut të produkteve bujqësore si edhe në atë të menaxhimit të burimeve njerëzore në këto ndërmarrje. Sipas rregullores së brendshme të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), Rregullores së brendshme të Departamentit Drejtim Agrobiznesi (DDA)” dhe strukturës së planit mësimor evidentohet se

	<p>qëllimi i programit është pajisja e studentëve me njohuritë e avancuara të karakterit profesional në fushën e menaxhimit të ndërmarrjeve, duke synuar formimin e shprehive të veçanta, kompetencave dhe aftësive të nevojshme nëpërmjet lëndëve të programit me qëllimin për të punuar e për tu bërë ekspertë të denjë në fushën e menaxhimit të bizneseve të orientuara nga sektori i agrobiznesit. Në kuadrin e ndryshimeve dhe rëndësisë që po i jepet këtij sektori për zhvillimin ekonomik të vendit, nevoja për profesionistë të formuar në këtë aspekt është e madhe.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit është konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të elementëve përbërës të tij si: plani mësimor/ kurrikula, programet e lëndëve, kreditet (ECTS), metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat lidhen me fushën e studimit, emërtimin e programit, nivelin dhe kapacitetet akademike të njësisë ku zhvillohet ky program studimi. Ky program studimi MSc. është në përputhje dhe me emërtimin e titullit të diplomës përkatëse (të realizuar për dy vite akademike me 120 ECTS gjithsej). Rezulton se nga ana e UBT është realizuar analiza e nevojave e tregut për hapjen/zhvillimin e programeve bachelor dhe master.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Programi i studimit i ofruar nga Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, UBT i cili lidhet më së shumti me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehur në planin strategjik të Universitetit Bujqësor të Tiranës” dhe të planit strategjik të zhvillimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës bazuar në një studim të tregut të punës të përgatitur nga institucioni që përfshin: mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p><b>Standardi I.2</b>  <b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i</p>	<p>Programet e studimeve të ofruara në UBT/FEA janë në përputhje me strategjinë kombëtare të bujqësisë. Ato janë në përputhje me</p>



<p>studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>planin strategjik për zhvillim të UBT-së dhe synojnë pajisjen e studentëve me njohuri që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të debatojnë e marrin vendime të sakta, të orientohen menjëherë përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen, si edhe të sigurojnë formimin e shprehive profesionale.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Duke analizuar dokumentat strategjike të UBT-së, (Statuti, Plani Strategjik, Rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit) dhe nga vizita në institucion arrijme në përfundim se: Organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në këtë fushë është bazuar në dokumenta strategjike që orientojnë misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Plani strategjik si një pikë e fortë orientuese, vendos si prioritetet studentët, kërkimin dhe mësimdhënien.</p> <p>Bazuar në të gjitha dokumentet e mësipërme strategjike, këto programe studimi synojnë: - Rritje të standardeve të cilësisë; - Përmirësimin e programeve të studimit me fokus krijimin e aftësive praktike; - Orientimin gjithnjë e më tepër të studentëve drejt tregut; - Krijimin e kompetencave profesionale të shumëfishta; - Zgjerimin e edukimit drejt specializimeve të gjera dhe zhvillimi i formave të reja të edukimit; - Sigurimin e infrastrukturës së mësimin dhe asaj organizative; - Forcimin e kompetencave akademike, profesionale, sociale dhe etike të edukimit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit i përket nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit dhe ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit. Ky program ofrohet në përputhje me fushat e menaxhimit të ndërmarrjeve, marketingut, agroturizmit, financës, kontabilitetit, ekonomisë dhe politikave agrare, zhvillimit rural të integruar etj</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës ka një plan të zhvillimit strategjik për periudhën 2016-2025 dhe ka parashikuar politikën e zhvillimit të programeve të studimeve master.</p> <p>Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit e mbështet zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. Programi synon gjithashtu që t’u lehtësojë studentëve aplikimin për studime të mëtejshme në institucione rajonale e më gjerë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nu përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				✓
--	--	--	--	---


### Standardi I.3

**Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Sipas Rregullors së Studimeve të UBT-së: Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë, dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë ata në përfundim të tij. Kështu, qëllimi i këtij programi studimi është të përgatitë specialistë me njohuri të thelluara, profesionale, të aftë të mirë-orientohen në fushat e agrobiznesit, të njohin aspektet menaxheriale dhe kuadrin rregullator të sektorit të Agrobiznesit. Sipas një studimi tregu të diplomuarit në këtë program studimi do të mund t’i përgjigjen mjaft mirë nevojave të vendit, veçanërisht të zonave rurale dhe sistemit të agrobiznesit për vënien në efikasitet të burimeve natyrore. Rezulton se nga ana e UBT është realizuar analiza e nevojave të tregut për hapjen/zhvillimin e programeve bachelor dhe master. Në këtë analizë janë marrë në shqyrtim karakteristikat e nevojave të tregut.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Analiza e tregut të punës merr në shqyrtim mundësitë për punësim dhe nevojat e tregut në sektorin e agrobiznesit, në harmoni me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.</p> <p>Sikundër u evidentua më lart, UBT ka bërë përpjekje për të analizuar nevojat e tregut të punës, në përshtatje me programin e studimit. Përshtatja me këto nevoja reflektohet dhe në strategjinë e zhvillimit të programit. U konstatua, gjithashtu, nga takimet në institucion me studentët se pjesa më e madhe e tyre janë të punësuar. Për këtë është realizuar dhe një studim nga Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), me synim gjurmimin e ecurisë së studentëve të UBT në tregun e punës, ka evidentuar se opinionet e tyre lidhur me tre komponentë: a) profilet e studentit, b) vlefshmërinë e diplomës së UBT për tregun e punës, dhe c) punësimin e tyre</p> <p>Ky program realizohet me 120 kredite, dhe kohëzgjatja është 2 vite akademike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësi, shkathësi e</p>	<p>Bazuar në qëllimin, objektivat dhe tërësia e komponentëve të tjerë të programit të studimit si dhe në kontaktet që GVJ pati me stafin dhe studentët, rezulton se ky program studimi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës për specialist.</p>



<p>kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Në përputhje me aktet e brendshme strategjike, programi Master është përpjekur të ndjekë përvojat e universiteteve evropiane, gjë që është reflektuar në përmbajtjen e programit dhe në syllabus-et e lëndëve të veçanta. Programi studimit është i ngjashëm me programet e studimit në universitete analoge dhe në këtë mënyrë ai lehtëson mobilitetin e studentëve apo punësimin e tyre në të ardhmen në tregun ndërkombëtar</p> <p>Nga shqyrtimi i akteve të vënë në dispozicion nga institucioni konstatohet se syllabus-et janë përditësuar sipas modelit që është pjesë e VKM Nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Çdo program ka të pasqyruar përmbajtjen e detajuar dhe është vlerësuar në kredite Evropiane sipas sistemit ECTS. Diploma që jepet në përfundim të programit të studimit Master shoqërohet me suplementin e diplomës.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi synon gjithashtu që t’u lehtësojë studentëve aplikimin për studime të mëtejshme në institucione rajonale e më gjerë. Programet e studimeve në UBT, organizohen në përputhje me Procesin e Bolonjës, në tre cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, i dytë dhe i tretë (Doktoratë).</p> <p>Programi i studimit, është hartuar mbi bazën e kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë në udhëzimet e MAS si dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Nga studimi i materialeve si i Rregullores së FEA-s (Rregullores së DDA-së) dhe Rregullores së Programit të Studimit GVI konstatoi se në to janë përcaktuar në mënyrë të detajuar organizimi dhe vlerësimi i praktikave profesionale në këtë program studimi. Në cdo rast praktikatat profesionale organizohen në përputhje me qëllimin dhe objektivat e programit, por ka vend për përmirësim në lidhje me organizimin e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe</p>	<p>Ky kriter nuk plotësohet pasi nuk përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë në gjuhë të huaj, pasi, programi, zhvillohet në gjuhën shqipe përveçse për lektorët e huaj të ftuar.</p>





ndërkombëtarizimin e institucionit.									
<b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Kriteri 8 nuk aplikohet për këtë program.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						

#### Standardi I.4

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UBT ka një përvojë dhe një kapacitet njerëzor në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të këtij institucioni, përcjelljen e dijës tek studentët. Staf i UBT-së përbëhet nga 591 punonjës ku 288 prej tyre janë staf akademik dhe pjesa tjetër staf administrativ dhe ndihmës. Konkretisht 149 punonjës janë staf administrativ dhe 139 punonjës janë staf ndihmës. Ndërkohë që vetë FEA, si njësi kryesore që ofron këtë program studimesh përbëhet nga 93 anëtarë staf akademik dhe 19 anëtarë staf ndihmës; DDA, njësi bazë përgjegjëse për këtë program ka 20 anëtarë staf akademik dhe 1 anëtar staf ndihmës. Kualifikimi i stafit akademik brenda njësisë bazë është: 4 profesorë, 8 profesorë të asociuar, 6 doktorë dhe 2 Msc. Rekrutimi i stafit të ri bëhet sipas kriteve të mirëpërcaktuara dhe akteve nënligjore në fuqi. Në vite vihet re një rekrutim i vazhdueshëm i stafit të ri të dalë nga vetë kjo IAL si dhe të ardhur nga IAL të tjera.
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas	UBT vepron brenda kornizave ligjore dhe respekton rigorozisht ligjin e arsimit të lartë në fuqi (L. 80/2015: Neni 23, Pika 1) si edhe përcaktimet statutoare. Strukturat e saj janë të formësuara në mënyrë të tillë që të garantojnë plotësisht arritjen e misionit të UBT-së si edhe përmbushjen e objektivave. Autonomia dhe liria akademike janë në funksion të sensit zhvillimor të UBT-së. I

klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	gjithë stafi akademik i UBT-së zhvillon objektivat e kërkimit në përputhje me fushën përkatëse të formimit në kufij të plotë të respektimit të lirisë akademike për këtë qëllim. Emërtimi i programit të studimit, është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	Kriteri 3 nuk aplikohet për këtë program.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga vizita ne institucion GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit te studimit dhe për të përmbushur qëllimin e këtij programi studimesh, njësia bazë dhe ajo kryesore, koordinojnë punën për të angazhuar staf akademik të kualifikuar. Një pjesë e moduleve të këtij programi ofrohen nga stafi i DDA (14 module), ndërkohë që ka disa module specifike që ofrohen nga departamente të tjera brenda FEA-s (8 module). Ndërkohë që stafi i DDA angazhohet gjithashtu edhe në programet të tjera të ofruara nga departamentet e tjera brenda fakultetit. Mbarëvajtja dhe mbikëqyrja e programit të studimit bëhet në formë të koordinuar nga të gjitha instancat drejtuese të UBT-së .Një sërë zyrash jane përgjegjëse për

	mbarëvajtjen e procesit mësimor, si: Zyra e Studimeve dhe Studentëve, sekretaritë e departamenteve, Zyra e Kurrikulave në Rektorat, Zv. Rektori për mësimin. Ne cdo vit akademik behet dhe një analize e punes se tyre.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe praktikave profesionale, UBT ka marrëveshje me institucione ku palët angazhohen për shkëmbim eksperience dhe ekspertizë në funksion të përmirësimit të procesit mësimor dhe realizimit të objektivave të programeve të studimit. Një bashkëpunim të gjerë UBT ka edhe me aktorë biznesi brenda vendit, ku marrëveshjet e nënshkruara ju japin përgjegjësi palëve për tu dhënë mundësi studentëve të kryejnë praktika profesionale në këto biznese. Qëllimi i praktikës është i dyfishtë. Në nivelin akademik ajo synon që studenti të arrijë që njohuritë teorike t'i shohë të zbatuara në praktikë. Për këtë qëllim UBT garanton që institucioni apo pozicioni ku studentët do të kryejnë praktikën të jetë sa më i lidhur me fushën e studimit. Në nivelin më konkret praktika profesionale synon të shkathtësojë studentin në ambientin e punës dhe t'i ofrojë atij një mundësi për të krijuar njohje, kontakte dhe njohuri në lidhje me tregun e punes Panairi i karrierës që zhvillohet çdo vit në UBT është një aktivitet që sjell së bashku akademinë dhe biznesin dhe ku krijohen premisat për zgjerimin e bizneseve partnere me universitetin dhe punesimin e studenteve
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	UBT ofron trajnime të ndryshme për studentët e diplomuar. Për këtë fillimisht bashkëpunojnë me punëdhënësit për të evidentuar fushat specifike të trajnimit.





<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Në fund të vitit departamenti DDA bën analizën e punës mësimore dhe shkencore ku përvec aspekteve të tjera të punës trajton në detaje kontekstin e bashkëpunimit shkencor të stafit të departamentit dhe të aspekteve pozitive që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit që UBT ka me institucione të tjera në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p>Këto raporte, (analiza e punës mësimore dhe analiza e punës shkencore) evidentojnë dhe nxjerrin në pah perfitimet nga këto marrëveshje bashkëpunimi dhe japin rekomandimet se çfarë duhet bërë në të ardhmen.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>✓</p>

<p><b>Standardi I.6</b>  <b>Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Pedagogët e Departamentit që mbulon programin e studimit janë mjaft të angazhuar në:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1 – Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> <li>2 – Publikime në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> <li>3 – Pjesëmarrje në Konferenca Shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> </ol>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Disa punime janë edhe në revista të mirënjohura me faktor impakti.</p> <p>Rezultatet e punimeve të kërkimit shkencor shpesh diskutohen në mbledhje Departamenti etj. Por nuk mund të thuhet që ka shumë politika specifike të motivimit të punës kërkimore – shkencore.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Ndërsa për studentët kjo realizohet kryesisht në disa lëndë ku ata angazhohen në projekte të ndryshme kërkimore të cilat më pas mund ti prezantojnë edhe në kuadrin e detyrave të kursit në lëndët përkatëse brenda programit mësimor. Apo ti vazhdojnë si studime më të thelluara e më të zgjeruara në kuadër të temës së diplomës që përgatitet në semestrin e fundit të vitit të dytë të studimeve të programit Master i Shkencave.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	

<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve”, është organizuar në module të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi. DDA ka hartuar dhe miratuar Rregulloren e këtij programi studimi Master (<b>Doc. no.12</b>) dhe bazuar në të ka përgatitur dosjen e plotë të këtij programi. Bazuar në kurrikulën e programit të studimit (<b>Doc.no.46-Kurrikula e programit të studimit 2018-2019,</b>) ky program është organizuar në 18 module ku secili modul është vlerësuar me 5 kredite, ndërsa Mikroteza vlerësohet në total me 30 kredite. Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik në këtë program studimi është 60 kredite. Ky program realizon 120 kredite formimi në fund të tij. (<b>Doc.no. 6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 30, Pika 5; Doc. no. 12: Rregullore e programit të studimit- Neni 18, Pika 5</b>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” formon studentët me shprehi të veçanta në profesione specifike. Programi përgatit studentët me aftësitë e duhura për të performuar në profesione të ndryshme, të tilla si: menaxher të ndërmarrjeve të inpleteve bujqësore dhe blektorale, fermat bujqësore dhe blektorale, sipërmarrjet e agrobiznesit, agjencitë shtetërore, sistemin bankar dhe mikrofinanciar, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe analitike në fushën e agrobiznesit, të nevojshme për zgjidhjen e problematikave komplekse në këtë fushë. Ai është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit (<b>Doc. no.7: Studim tregu</b>). Gjithashtu, ky program kujdeset të pajisë të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike dhe aftësitë e nevojshme për kërkim shkencor në fushën e agrobiznesit</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe</p>	<p></p>

<p>kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p><i>(Doc.no. 6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 9; Doc. no. 12: Rregullore e programit të studimit- Neni 15, Pika 1).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Duke u bazuar në dosjen e këtij programi studimi dhe konstatimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, mund të konkludojmë se ky program studimi përmban elementet e nevojshëm që lejojnë krijimin e strukturës së tij <i>(Doc.no.46: Kurrikula e programit të studimit 2018-2019, Doc.no.26: Kategorizimi i lëndëve, Doc.no.45: Plani mësimor dhe struktura 2018-2019, Doc. no.69: Syllabuset e programit të studimit, Doc.no.61: Pasqyra e vlerësimit të studentit gjatë vitit, Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA dhe Doc. no.5: Rregullore e FEA )</i> konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi <i>(VKM no.41 (Dt.24/01/2018, pika 2).</i></p> <p>Regjistrimi në këtë program bëhet në përputhje me ligjin në fuqi dhe vendimet e udhëzimet e MASR <i>(Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 29, pika 5).</i> Gjithashtu, programi i studimit është i organizuar me 120 kredite formimi dhe ka një kohëzgjatje dy vite akademike <i>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 27, pika 2; Doc. no. 12: Rregullore e programit të studimit- Neni 15, Pika 2).</i></p> <p>Departamenti harton kurrikulen e programit të studimit dhe më pas ajo shqyrtohet dhe miratohet nga këshilli i FEA-s si dhe nga Senati i UBT-së. Në fillim të çdo viti akademik, departamenti harton planin mësimor të mbështetur në kurrikulën përkatëse, i cili miratohet nga dekani i fakultetit dhe Rektori i Universitetit <i>(Doc. no. 12: Rregullore e programit të studimit- Neni 24, Pika 2&amp;3).</i></p> <p>Në planin mësimor pasqyrohen disiplinat mësimore, raporti teori-praktikë, numri i krediteve për secilën disiplinë, detyrimet mësimore për çdo disiplinë, mënyra dhe afatet e shlyerjes së detyrimeve, si dhe praktikatat profesionale <i>(Doc. no. 12: Rregullore e programit të studimit- Neni 25).</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet</p>	<p>Ky program studimi ka përcaktuar veprimtaritë formuese duke grupuar modulet në përputhje me kategoritë e përcaktuara në <i>VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.5)</i> dhe ka përcaktuar gjithashtu edhe ngarkesën përkatëse në kredite për secilën kategori të veprimtarive</p>

<p>sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>formuese brenda këtij programi studimi duke respektuar peshën e përcaktuar në <i>VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (shtojcën nr. 1, tabela 1)</i>. Më poshtë paraqitet situata e klasifikimit të lëndëve në këtë program (<b>Doc.no.26: Kategorizimi i lëndëve</b>):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëndë bazë (përgatitja metodologjike dhe kultura e përgjithshme) - 10 kredite (8.3%)</li> <li>• Lëndë karakterizuese, ( formim specifik) - 60 kredite (50%)</li> <li>• Lëndë ndërdisiplinore (nëndisiplina, profile grup-lëndë me zgjedhje) – 15 kredite (12.5%)</li> <li>• Lëndë plotësuese (gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale të) – 5 kredite (4%)</li> <li>• Detyrime përmblylëse (përgatitja e tezës së diplomës) – 25 kredite (25%)</li> </ul> <p>Siç shihet edhe nga paraqitja e mësipërme ky programi i jep një peshë të rëndësishme punimit të diplomës, pra punës kërkimore të realizuar nga studenti, duke e vlerësuar me 25 kredite.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën “Master i Shkencave” në programin e studimit “Menaxhim Agrobiznesi”. Ky dokument zyrtar firmoset nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori i UBT-së (<b>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 34, pika 1 &amp; Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 22, pika 1</b>) .</p> <p>Modeli i diplomës "Master i shkencave" në programet e Studimit të DDA-s, ku përfshihet edhe programi në fjalë, miratohet nga senati akademik (<b>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 34, pika 2, Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 22, pika 2 &amp; Doc. no. 73: Model Diplome i plotësuar</b>)</p> <p>Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin/shtojcën e diplomës, sipas modelit të miratuar nga IAL. (<b>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 34, pika 3, Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 22, pika 3, Doc. no. 43: Lista e notave i MSh në Administrim i Ndërmarrjeve &amp; Doc. No. 74 Diplomë suplement MSc</b>).</p> <p>Emërtimi i diplomës "Master i shkencave" bëhet në përputhje me programin e studimit “Menaxhim Agrobiznesi” që ka ndjekur studenti (<b>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 34, pika 4, Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 22, pika 4</b>).</p> <p>Siç përmendet edhe më sipër në kategorizimin e lëndëve, gjithashtu e pasqyruar në kurrikulën e programit, tema e diplomës së Masterit</p>



	<p>Shkencor vlerësohet më 30 ECTS (<i>Doc.no.46: Kurrikula e programit të studimit 2018-2019, Doc.no.26: Kategorizimi i lëndëve</i>).</p> <p>Për realizimin e temës së diplomës, studenti i Masterit Shkencor “Menaxhim Agrobiznesi” punon në mënyrë të pavarur. Megjithatë, nga diskutimi i realizuar me studentët dhe pedagogët e këtij programi rezultoi se studentët janë në komunikim të vazhdueshëm, duke përdorur si formën elektronike dhe komunikimin ballë për ballë me pedagogun udhëheqës për finalizimin e këtij procesi. Studentët pohuan se aktiviteti i tyre kërkimor është plotësisht i mbështetur nga ndihma e pedagogut. Ata gjithashtu pohuan pjesëmarrjen në konferencat të ndryshme studentore, në të cilat pasqyrojnë punën e tyre kërkimore që lidhet me temën e diplomës (<i>Doc. no. 31: Book of proceedings, Konferencë studentore</i>). Nga ana tjetër, pedagogët pohuan se ka një angazhim nga ana e studentëve të këtij programi në kërkime, projekte apo studime të ndryshme që i vijnë në ndihmë studentit në përzgjedhjen e tematikës së punimit të diplomës, kjo gjë u konfirmua edhe nga studentët.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Sipas ligjit në fuqi (<i>L. 80/2015, Neni 22, pika 1</i>) IAL-të duhet të përbëhen nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera të përcaktuara në statutin e tyre.</p> <p>Në përputhje me ligjin në fuqi (<i>L. 80/2015, Neni 22, pika 2</i>), njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimeve Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve”, është Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA).</p> <p>Kjo njësi kryesore përbëhet nga 6 Departamente në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi. Përbërja e FEA-s jepet si më poshtë (<i>Doc. no.5: Rregullores se FEA-s-Neni 5, Pika 1 &amp; Neni 6 Pika 1</i>)</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit;</li> </ol>


	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural;</li> <li>3. Departamenti i Financë - Kontabilitet;</li> <li>4. Departamenti i Matematikës dhe Informatikës;</li> <li>5. Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural;</li> <li>6. Departamenti i Gjuhëve të Huaja.</li> </ol> <p>Pjesë e këtij fakulteti është dhe Instituti për Studime Ekonomike dhe Transferim të Njohurive (ISETNJ).</p> <p>Në përputhje me ligjin në fuqi (<i>L. 80/2015 - Neni 22, pika 3, Neni 25, pika 1</i>) njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, është Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit (DDA). Departamenti është i organizuar në grupe mësimore me karakter kërkimor (<i>L. 80/2015 - Neni 25, pika 5</i>), përkatësisht 2 grupe mësimore kërkimore (GMK) në fushën e marketingut dhe drejtimit (<i>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 3</i>).</p> <p>Personeli i DDA-s përbëhet nga personeli akademik, dhe personeli ndihmës akademik (<i>L. 80/2015 - Neni 57 , pika 1</i>). Departamenti ka në përbërjen e tij 20 anëtarë si personel akademik efektiv dhe 2 anëtarë si personel ndihmës akademik (<i>Doc. no. 23 – Lista e Stafit FEA-DDA 2018-2019</i>), në përputhje me detyrimet në fuqi (<i>L. 80/2015 - Neni 25, pika 4</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Njësia kryesore e këtij programi, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta dhe të ndërthurura njëra me tjetrën (<i>L. 80/2015, Neni 23, pika 1</i>). Ai ofron programe studimore të niveleve të ndryshme, ku në përfundimin e të cilave i pajisë studentët me diplomë (<i>Doc. no.5: Rregullores se FEA-s-Neni 5 pika 1.a,b</i>). FEA ofron programe studimi në 3 cikle studimi: cikli i parë (bachelor), cikli i dytë (Master i Shkencave dhe Master Profesional) dhe cikli i tretë (master ekzekutiv dhe doktoraturë) (<i>Doc. no.5: Rregullores se FEA-s-Neni 16</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Siç përmendet edhe më sipër në kriterin nr.1, ky fakultet është i organizuar në 6 njësi bazë për zhvillimin e mësimimit dhe punës kërkimore-shkencore (<i>Doc. no.5: Rregullores se FEA-s-Neni 6, Pika 2</i>). Organizimi dhe funksionimi i këtyre njësive bazë parashikohet në statutin e UBT-së.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program, DDA, ka në përbërjen e saj 20 anëtarë si personel akademik efektiv dhe 2 anëtarë si personel ndihmës akademik (<i>Doc. no. 23 – Lista e Stafit FEA-DDA 2018-2019</i>). Personeli akademik për 2 GMK përkatëse të këtij departamenti paraqitet si më poshtë:</p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• GMK- Marketing - 5 anëtarë të personelit akademik</li> <li>• GMK- Drejtim - 14 anëtarë të personelit akademik</li> </ul> <p><b>( Doc. no. 21- Analiza e Punës Shkencore DDA 2018)</b></p> <p>Në bazë të nevojave vjetore, DDA, përveç personelit akademik të brendshëm, angazhon edhe personel të jashtëm akademik. Planifikimi për stafin akademik të ftuar (PAK) bëhet në fillim të çdo viti akademik dhe miratohet nga Dekanati dhe nga Rektorati (<b>Doc. no.3- statuti i UBT-s – neni 34</b>)</p> <p>Bazuar në dokumentin që pasqyron ngarkesën mësimore të personelit akademik të përfshirë në këtë program masteri, për vitin 2017-2018, mund të konkludojmë se planifikimi është mbuluar vetëm nga stafi akademik i brendshëm i DDA (<b>Doc. no. 48: Ngarkesa stafi i programit Msc. viti 2017-2018</b>). Nga biseda e realizuar me përgjegjësën e departamentit Prof. Asoc. Dr. Ilir Kapaj, u informuam se edhe planifikimi i ngarkesës mësimore për vitin 2018-2019 është bërë duke angazhuar vetëm stafin akademik të brendshëm.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Siç përmendet edhe më sipër, personeli i DDA-s përbëhet nga 20 anëtarë të personelit akademik dhe 2 anëtarë të personelit ndihmës akademik.</p> <p>Personeli akademik i DDA i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar dhe i aftë për të përmbushur detyrimet e këtij programi studimi në përputhje me ligjin në fuqi (<b>L. 80/2015 - Neni 59, pika 6</b>).</p> <p>Bazuar në listën e stafit të FEA rezulton se personeli akademik i DDA-së zotëton kualifikimet e mëposhtme:</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Profesor – 4  Profesor të asociuar – 8  Doktor – 6  Master – 2</p> <p>Bazuar në listën e personelit akademik të përfshirë në këtë program masteri, si nga DDA dhe departamente të tjera të FEA-s, rezulton se ky personel mban kualifikimet e mëposhtme:</p> <p>Profesor – 10 ( ku 3 prej tyre janë anëtarë të DDA-së)  Profesor i Asociuar – 11 ( ku 6 prej tyre janë anëtarë të DDA-së)  Doktor – 4 ( ku 1 anëtarë është i DDA-së)</p> <p><b>( Doc. No.23: Stafi FEA-DDA, Doc. no. 48: Ngarkesa stafi i programit Msc. viti 2017-2018, Doc. No. 39: Të dhënat tabelare për personelin akademik në programin e studimit dhe kualifikimet e tyre &amp; Doc no. 108: Të dhënat për titujt dhe gradat e stafit akademik të programit Msc).</b></p>



	<p>Në raportin e vlerësimit të brendshëm krijohet konfuzion në lidhje me numrin e pedagogëve të përfshirë në këtë program dhe kualifikimet e tyre, nëse informacioni në të krahasohet me informacionin e paraqitur në dokumentet që pasqyrojnë këto kualifikime dhe numrin e pedagogëve të përfshirë në program.</p> <p>Siç është permednur edhe më sipër, në këtë program studimi nuk ka personel akademik me kohë të pjeshme, sepse nevojat mbulohen nga stafi akademik i brendshëm.</p> <p>Studentët e këtij programi studimi kryejnë praktika laboratorike përkatësisht në lëndët: “Ekonometri”, “Sistemet e Informacionit të Drejtimit” dhe “Optimizim Ekonomik”. Gjatë këtyre orëve, krahas pedagogut të lëndës, asistojnë edhe stafi ndihmës akademik që janë përgjegjës për këto laboratorë, të cilët japin ndihmën e tyre në realizimin dhe mbështetjen e orëve laboratorike. (<i>Doc .no. 20- Curriculum Vitae e stafit ndihmës akademik</i>).</p> <p>Nga vizita e realizuar në ambjentet e FEA-s rezultoi se në funksion të studentëve janë vendosur 6 laboratorë informatike, të cilët përdoren për kryerjen e praktikave laboratorike në lëndë të caktuara. Këta laboratorë janë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e këtyre praktikave. Personeli ndihmës akademik në FEA përbëhet nga 3 anëtarë ku secili prej tyre është përgjegjës për dy salla laboratorie. Ata kujdesen për mirëmbajtjen e mjediseve të laboratorëve dhe mjeteve përkatëse në to (<i>Doc. no. 47 - Tabelë përmbledhëse mbi kapacitetet infrastrukturore të FEA &amp; UBT-së</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit përfaqëson autoritetin drejtues të njësisë bazë (departamentit) përgjegjëse për programin në fjalë (<i>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 4 pika a</i>). Ai koordinon dhe monitoron mbarëvajtjen e ecurisë së zhvillimit të mësimin si edhe kujdeset për ruajtjen e cilësisë dhe disiplinës së zhvillimit të mësimin në programin e studimit. Gjithashtu, ai kujdeset për mbarëvajtjen e orarit; angazhohet në zgjidhjen problemeve që dalin gjatë semestrit; ndjek zhvillimin e mësimin në përputhje me objektivat e programit dhe syllabuset e lëndëve; dhe raporton ecurinë e programit në mbledhje departamenti, aspektet positive, negative dhe masat që duhet të ndërmerren në zgjidhjen e tyre (<i>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni 5 pika 6, 7, 8 14 dhe 16</i>).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓


### Standardi II.3

**Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve”, disponon dokumentacionin e plotë për programin e studimit ku përfshihen: Kurrikulat e programit të studimit (<i>Doc.no.46</i>), Planet mësimore (<i>Doc.no.45</i>); Syllabuset e lëndëve (<i>Doc. no. 69</i>) si dhe Kategorizimin e lëndëve (<i>Doc.no.26</i>) sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Kurrikula e këtij programi studimi është ndërtuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. (<i>VKM nr.41 dt. 24/01/2018</i>) Në të pasqyrohen objektivat formues dhe kompetencat profesionale përcaktuese dhe specifike që duhet të ofrojë një program studimi Master i Shkencave në fushën e Menaxhimit të Agrobiznesit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Kurrikula përmban 18 module të shpërndara në tre semestra. Në secilin semestër studentët zhvillojnë 6 module, ku 5 prej tyre janë module të detyrueshme dhe 1 modul është me zgjedhje. Secili modul vlerësohet me 5 European Credit Transfer System (ECTS). Për llogaritjen e krediteve është marrë parasysh ngarkesa e çdo moduli ku një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (<i>Pika 2.1.b</i>).</p> <p>Objektivat formues dhe kompetencat profesionale përcaktuese i gjejmë të pasqyruara në modulet e semestrit të parë, të cilat presupozohen të jenë të njëjta për programe të ngjashme të fushës së administrimit.</p> <p>Kompetencat profesionale specifike, të cilat diferencojnë këtë program studimi, i gjejmë të pasqyruara në modulet që zhvillohen në semestrin e dytë dhe të tretë. Konteksti aplikativ në këto module i referohet fushës së ekonomisë bujqësor dhe sistemit të ndërmarrjeve të agrobiznesit. Këto module synojnë të aftësojnë studentët të analizojnë aktorët që përfshihen në zinxhirin e prodhimit të ushqimeve.</p>

	<p>Semestri i katërt përmban zhvillimin e temës së diplomës që finalizon këtë cikël studimi. Totali i krediteve për çdo semestër është 30 ECTS. Duke plotësuar në këtë mënyrë numrin total të krediteve, 120 ECTS formimi, përcaktuar për finalizimin e ciklit të dytë të studimeve me një kohëzgjatje dy vite akademike (<i>Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit-Neni 15, pika 2</i>).</p> <p><i>(Doc.no.46-Kurrikula e programit të studimit 2018-2019)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Duke u bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve”, kuptojmë se plani mësimor buron nga kurrikula e këtij program studimi dhe pasqyron periudhën kohore përgjatë së cilës zhvillohet secili modul i këtij programit (<i>Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 25, pika 1</i>).</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ. Ai hartohet nga Përgjegjësi i Departamentit (Njësia Bazë) dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UBT-së (<i>Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 25, pika 2, 3</i>)</p> <p>Siç shpjegohet edhe në rregulloren e këtij programi studimi (<i>Neni 25, pika 2</i>) plani mësimor përfshin elementët e mëposhtëm në përputhje me VKM nr.41 dt. 24/01/2018 (<i>Pika 2.6</i>):</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Emërtimin për secilin modul të këtij programi studimi, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës;</li> <li>2. Numrin e krediteve për çdo modul (siç është përmendur edhe më sipër 5 ECTS/ per modul)</li> <li>3. Orët në total për secilin modul (60 orë) dhe raporti i orëve (2 orë leksione : 2 ore seminare);</li> <li>4. Detyrimet për secilin modul (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi, detyra kontrolli);</li> <li>5. Raporti i vlerësimit të studentit ( rezulton kryesisht 40% gjatë vitit : 60 % provimi në modulet e këtij programi)</li> <li>6. Periudha (në varësi të semestrit që zhvillohet 1,2,3,4) dhe mënyra e kontrollit të dijeve për çdo modul (provim ose kolokium – rezulton provim për të gjitha lëndët);</li> <li>7. Mënyra e zhvillimit të provimit final për çdo modul (provim me goje, me shkrim, me goje &amp; me shkrim-rezulton provim me shkrim për të gjitha lëndët, përveç mikrotezës që zhvillohet me gojë).</li> </ol>

	<p><i>(Doc.no.45 – Plani mësimor i programit dhe struktura mësimore 2018-2019)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në Rregulloren e DDA dhe të programit të studimit pasqyrohen qartë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në përputhje me ligjin në fuqi (<i>L. 80/2015, Neni 76, 89, VKM, 2.7 kuotat e pranimit</i>).</p> <p>“Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” përcaktohen nga Departamenti. Kriteret bëhen publike nga DDA dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe miratohen sipas përcaktimeve në statutin e UBT-së” (<i>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni -29 &amp; Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 17</i>).</p> <p>“Kanë të drejtë të aplikojnë dhe të regjistrohen në programin e studimeve për të fituar Diplomën “Master i Shkencave”, individët që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare “Bachelor” apo “Master Profesional” në sistemin me kohë të plotë dhe të pjesëshme, dhe që plotësojnë kriteret akademike si më poshtë” (<i>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni -29, pika 1.a &amp; Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 17, pika 1.a</i>):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Kriteri i meritës.</i> Nota mesatare e ponderuar në studimet e ciklit të parë (bachelor) në profilet e ekonomisë, të jetë 7.5 e lart. Në rast se ka ende kuota të lira, nuk përjashtohen aplikantët me mesatare më të ulët, por në asnjë rast më të ulët se 7.</li> <li>- <i>Kriteri i rëndësisë</i> (koeficienti i profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programin e studimit të DDA-s).</li> <li>- <i>Kuota të paracaktuara nga DDA.</i></li> </ul> <p>“Përzgjedhja e kandidatëve fitues në programin Master i Shkencave do të jetë rezultat i produktit: notë mesatare në bachelor*koeficient (sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet); duke gjeneruar një listë vlerësimi e cila shpall fitues të renditurit sipas kësaj liste brenda kuotave të paracaktuara nga DDA” (<i>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA- Neni -29, pika 1.b &amp; Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 17, pika 1.b</i>).</p> <p>“Kriteri pranimit në një program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të</p>



huaja të Bashkimit European: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë, si dhe me vendim të Senatit Akademik të UBT” (**Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA-Neni -29, pika 2 & Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 17, pika 2).**

Në rastet kur studenti nuk zotëron një dëshmi të tillë, me Vendim Rektorati no. 41, dt. 28/09/2016 (**Doc. no. 6: Vendim për gjuhën e huaj**), është i detyruar të mbyll këtë detyrim brenda vitit të parë të studimeve.

“DDA ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, ndërmjet programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UBT-së apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë” (**Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA - Neni 69, pika 1 & Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni46, pika 1).**

“Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm me programet e studimit të DDA-s” (**Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA - Neni 69, pika 2 & Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 46, pika 2).**

“Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta, ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve si dhe transferimi i studimeve, përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, aktet e tjera nënligjore dhe në këtë rregullore” (**Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA - Neni 69, pika 3 & Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 46, pika 3).**

“ DDA ofron mundësi për transferime të studentëve në vite të ndërmjetme midis programeve të të njëjtit cikël, brenda institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitetet të tjera, sipas procedurave të parashikuara në këtë Rregullore” (**Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA -Neni 70, pika 1 & Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 47, pika 1).**



	<p>“Për të gjithë studentët që kërkojnë të transferojnë studimet ose kërkojnë të vazhdojnë një program të dytë studimi të njëjtë ose të ngjashëm, DDA bën të mundur ekuivalentimin e një pjese të programeve të plota ose diplomave të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja, sipas përcaktimeve në Statutin e UBT”  <i>(Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA -Neni 72, pika 1 Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 49, pika 1) .</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Modeli që përdoret për hartimin e syllabuse-ve, në programin e studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” është modeli i përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 <i>(Pika 2.8, shtojca no.2)</i>.  Në përgjithësi syllabuset e lëndëve të këtij program studimi respektojnë elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve të VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 <i>(Shtojca no.2)</i>. Vlen të përmendet se syllabuset e lëndëve si: “Makroekonomia II, “Drejtim Marketingu”, “Drejtim Strategjik i Agrobiznesit”, “Drejtim i Institucioneve Financiare”, “Biznes Nderkombetar”, respektojnë plotësisht elementët përbërës të modelit. Megjithatë, vlen të përmendet se ka ende vend për përmirësime për elemente të caktuara si: literatura përkatëse për çdo temë, shpjegimi i temave dhe paraqitja e referencave (mungesa e një stili të caktuar) konstatuar në syllabuset e lëndëve si: “Drejtim Financiar 2”, “Sjellje Konsumatore”, “Ekonometria”, dhe “Drejtim i Riskut Financiar” <i>(Doc. no. 69 - Syllabuset e programit të studimit)</i>.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Nga takimi i realizuar me Përgjegjësën e Departamentit dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, u informuam se kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave ka pësuar përmirësime me përfshirjen e lëndëve me zgjedhje krahas lëndëve të detyrueshme për çdo semestër <i>(Doc.no.46-Kurrikula e programit të studimit 2018-2019)</i>. Ky ndryshim nuk kapërcen kufirin (20%) e parashikuar nga ligji në fuqi <i>(L. 80/2015 - Neni 35, pika 1)</i>. Gjithashtu, ata pohuan se programi i nënshtrohet një përmirësimi të vazhdueshëm në përputhje me kërkesat e tregut dhe duke marrë parasysh zhvillimit e fundit.  Nga ky takim si dhe nga takimi me pedagogët që japin mësim në këtë program studimi u informuam se çdo fillim viti, por edhe gjatë vitit, diskutohet dhe bëhet përditësimi dhe rifreskim i syllabuseve duke përfshirë në to informacione mbi zhvillimet më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit, vlen të</p>

	<p>permendim ketu vendosjen në dispozicion të studentëve të rasteve të studimit më të fundit.</p> <p>Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këto ndryshime, sidomos referuar pjesës praktike të realizuar gjatë seminarit, duhet të pasqyrohen edhe në syllabus.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa mësimore javore në auditor për programin e studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” është në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi (<i>VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, Pika 2.1.d</i>). Ngarkesa mësimore javore në auditor në lidhje me leksione, seminare, ushtrime, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe praktika të zhvilluara në auditor, është 24 orë mësimore 50-minutëshe (<i>Doc. No. 42 – Orari mësimor semestri dimëror 2018-2019</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive formuese të këtij programi studimi mundësojnë thellimin dhe aftësimin e studentëve në fushën e menaxhimit të agrobiznesit duke i dhënë atyre mundësi të mira punësimi në këtë fushë. Në takimin e realizuar me studentët e këtij programi mësuam se orët e mësimin në auditor (leksione, seminare, ushtrime apo praktika në laboratorë) zhvillohen në formë interaktive ndërmjet pedagogut dhe studentit, ku pedagogët paraqesin shembuj të ndryshëm për të mbështetur pjesën teorike dhe raste studimi të ndryshme për të stimuluar mendimin krijues dhe kritik të studentit.</p> <p>Ndarja e orëve mësimore në auditor (leksione dhe seminare, /laboratorë) për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit (<i>Doc.no.45 – Plani mësimor i programit dhe struktura mësimore 2018-2019</i>), në bazë të krediteve që ka secila disiplinë. Në këtë program studimi, raporti ndërmjet formimit teorik dhe atij praktik për të gjitha lëndët është 2:2 (2 orë leksione në auditor dhe 2 seminare/ushtrime/laboratorë).</p>


	<p>Në disa lëndë të caktuara, gjatë seminarit mund të aplikohen raste studimi, detyra apo projekte kursi për të zhvilluar aftësitë komunikuese të studentëve si dhe për t'i nxitur ata të përvetësojnë procesin e kërkimit. (psh. në lëndë si “Drejtimit Marketingu”, “Kërkim dhe Analizë Tregu”, “Drejtimit Strategjik i Agrobiznesit”, etj.) ndërsa në lëndë të tjera, orët e seminareve realizohen në laboratore për të përmirësuar aftësitë e studentëve në lidhje me menaxhimin e informacionit apo përpunimin dhe analizimin e të dhënave (psh. në lëndë si “Ekonometri”, “Sistemet e Informacionit të Drejtimit” dhe “Optimizim Ekonomik”). Mundësia për t'i orientuar studentët me raste dhe situata praktike i aftëson ata të adaptohen në tregun e punës në përfundim të studimeve.</p> <p>Programi i lëndëve të këtij programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që i krijon studentëve mundësi transferimi të studimeve, pasi përmbajtja është e krahasueshme me dijet që studenti mund të marrë në institucione të tjera brenda apo jashtë vendit.</p> <p>Gjithashtu, duke u bazuar në dokumentin (rasti i Universitë Politecnica delle Marche) Learning Agreement që tregon mbi mobilitetin Erasmus që është realizuar si për studentët e këtij programi që kanë studiuar për një periudhë të caktuar kohe në një universitet të huaj, por edhe për studentë të huaj që janë pritur në departamentin e DDA, vihet re se ka një përafërsi të lëndëve të këtij programi me lëndët e programeve të institucioneve të huaja pritëse (<i>Doc. no. 41- LA Student Outgoing-Student Incoming</i>). Në bisedën e realizuar me studentët e këtij programi mësuam se si rezultat i këtyre mobiliteteve 3 nga studentët e programit aktualisht ndodhen jashtë vendit në programe Erasmus dhe 2 studentë janë në pritje të përgjigjes së aplikimit që kanë kryer.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Modulet e kurrikulës së këtij programi studimi janë organizuar në formë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të njëjtë përgjatë tre semestrave, si në aspektin e ngarkesës mësimore ashtu edhe në lidhje me kreditet për çdo modul. Siç është përmendur dhe më sipër, raporti i orëve të mësimit në auditor për të gjithë modulet rezultojnë 2x2, ndërkohë që çdo modul vlerësohet me 5 kredite. Ngarkesa totale në kredite për çdo semestër është 30 ECTS (<i>Doc.no.45 – Plani mësimor i programit dhe struktura mësimore 2018-2019</i>). Kjo shpërndarje mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Në takimin e</p>

	<p>realizuar me studentët mësuam se ata nuk ndiejnë se ka ngarkesë apo pamundësi për tu përgatitur siç duhet gjatë një semestri. Koha është e mjaftueshme për përgatitjen e çdo lënde dhe për rrjedhojë arritjen e rezultateve të dëshiruara.</p> <p>Ndarja e lëndëve me karakter formues dhe aplikativ krijon mundësinë për të thelluar njohuritë teorike që janë marrë nga cikli i parë i studimit në semestrin e parë dhe mundëson aftësimin gradual praktik në semestrin e dytë e të tretë. Studenti, në 15 javë mësimore në auditor, gjatë leksioneve (2 orë në javë) merr njohuritë e duhura rreth çështjeve apo tematikave të caktuara për secilin modul. Gjatë seminareve (2 orë në javë), studentët analizojë çështjet e leksionit si dhe punojnë në mënyrë të pavarur apo në grup raste studimore në funksion të temave të lëndëve. Nga takimi i realizuar me studentët kuptuam se rastet e studimit që analizoheshin në klasë janë në përputhje me temat e mësimit dhe prekin çështje që kanë interes të veçantë në ditët e sotme. Ndërsa nga takimi i realizuar me pedagogët mësuam se realizimi i detyrës së kursit i aftëson studentët për të punuar në grup, për të ndarë punën, për të komunikuar në mënyrë elokvente, gjithashtu i mëson sesi duhet të mbledhin dhe të analizojnë informacion për çështje të caktuara. Edhe nga takimi i realizuar me studentët vërtetuam këtë aspekt të rëndësishëm të detyrave të kursit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e këtij programi studimi duke përfshirë natyrën e moduleve të ofruara, ngarkesën e tyre në ECTS, raportin e aspekteve teorike dhe aplikimeve të mundshme praktike është në përputhje me profilin e këtij programi master “Administrimin e Ndërmarrjeve” në fushën e agrobiznesit, karakteristikë që e veçon nga profile të tjera MSc që ofrohen nga institucione të tjera arsimore të larta. Gjithashtu për specifikën që paraqet tenton të mbulojë nevojat në tregun e punës në fushën e agrobiznesit.</p> <p>Nga biseda e realizuar me Përgjegjës të Departamentit mësuam se për ngritjen e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës, përveç studimit të tregut janë shfrytëzuar edhe eksperiencat ndërkombëtare nga vende të zhvilluara. Gjithashtu vlen të përmendet se nga takimi me pedagogët rezultoi se shkëmbimi i eksperiencave të pedagogëve në kuadër të programeve Erasmus ka ndikuar në pasurimin dhe përmirësimin e syllabuseve (eksperiencat e Prof. Asoc. Dr. L. Thoma).</p>



	<p>Siç është përmendur edhe më sipër, ky program studimi për faktin se ka përafërsi me programe të ngjashme ndërkombëtare ka realizuar mobilitete të studentëve në programe Erasmus dhe gjithashtu ka një përputhje shumë të mirë të Learning Agreement. Ky shkëmbim është realizuar si për studentët e këtij programi që kanë studiuar për një periudhë të caktuar kohe në një universitet të huaj, por edhe për studentë të huaj që janë pritur në departamentin e DDA (<i>Doc. no. 41- LA Student Outgoing-Student Incoming</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në bisedën e realizuar me Përgjegjësin e Departamenti dhe me pedagogët që japin mësim në këtë program studimi mësuam se DDA analizon ecurinë e çdo programi studimi, duke përfshirë në to mendimin dhe opinionin si të lektoreve, por edhe të studentëve lidhur dhe me programin e çdo moduli. Pedagogët pohuan se çdo fillim viti, por edhe përgjatë vitit, diskutohet dhe bëhet përditësimi apo rifreskim i syllabuseve duke u kujdesur për të përfshirë në to informacione mbi zhvillimet më të fundit të shkencës. Gjithashtu, ata pranuan se shkëmbimi i eksperiencave të tyre në kuadër të programeve Erasmus ka ndikuar në pasurimin dhe përmirësimin e syllabuseve (eksperienca në Poloni - Prof. Asoc. Dr. L. Thoma).</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të programeve të moduleve, një feedback vjen edhe nga rezultatet e anketës që realizohen me studentët, ku ata japin mendimin e tyre si për pedagogët dhe për lëndët përkatëse të tyre. Një iniciativë e rëndësishme në kuadër të përmirësimit apo pasurimit të programit të studimeve do të ishte edhe feedback-u nga studentët e diplomuar, të cilët janë më në brendësi dhe njohin mundësitë dhe problematikat e tregut të punës.</p> <p>Bazuar në opinionet dhe mendimet e marra, DDA ndërmerr masa për të pasqyruar ndryshime të mundshme të syllabuseve sipas moduleve. Përmirësimet e realizuara në syllabuse miratohen nga Grupet Mësimore Kërkimore (GMK). Të gjitha syllabuset arkivohen në departament në kopje dixhitale dhe në hardcopy.</p> <p>Në përgjithësi syllabuset e lëndëve të këtij program studimi respektojnë elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve të VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Shtojca no.2). Në çdo syllabus literatura ndahet në literaturë bazë e detyrueshme dhe literaturë ndihmëse.</p>

	<p>Nëse i referohemi shqyrtimit të syllabuseve të këtij programi studimi, për një pjesë të mire të tyre (<i>Doc. no. 69 - Syllabuset e programit të studimit</i>) rezulton se literatura, qoftë bazë apo ndihmëse, nuk është plotësisht e mjaftueshme si dhe mbulon një hark kohor më të gjatë se 5 vitet e fundit. Mungesa e përdorimit të një stili të caktuar të paraqitjes së literaturës në syllabus, i cili do të lejonte evidentimin e disa elementeve të rëndësishëm duke përfshirë këtu vitin e botimit të librit apo artikullit përkatës, e bën të vështirë përcaktimin e literaturës së përditësuar për disa lëndë (“Drejtim financiar 2”, “Optimizimi ekonomik”, “Drejtim i riskut financiar” dhe “Sjellje konsumatore”).</p> <p>Në disa lëndë pedagogët përdorin cikël leksionesh dhe është e vështirë të identifikohet nga është marrë materiali për temat e përfshira në syllabus.</p> <p>Duke qënë se pedagogët e këtij programi deklaruan, fakt që vërtetohet në dokumentacionin e paraqitur për vlerësim, se kanë eksperiencë jashtëzakonisht të mira në përfshirje të tyre në projekte të ndryshme, në bashkëpunime për realizimin e artikujve apo librave me pedagogë të institucioneve të tjera jashtë vendit apo pjesëmarrje në koferenca dhe botime të artikujve në revista të njohura, dhe sidomos referuar viteve të fundit, dokumentimi i punës së tyre kërkimore-shkencore në syllabus do të sillte vlerë të shtuar për të.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>“Programet e studimit “Master i shkencave” në DDA pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar “(<i>Doc.6: Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 27, pika 1</i>). Fokusi i programit Master Shkencor në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” bën të mundur përfundimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave që ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të karakterit shkencor.</p> <p>Studentët në këtë cikël studimi marrin njohuri mbi shkencat bazë ( lëndët: Mikroekonomi dhe Makroekonomi) si dhe kompetenca në mbledhjen dhe analizën e të dhënave (në lëndën e Ekonometrisë), për tu aftësuar që të punojnë me të dhëna të natyrave të ndryshme nëse do të duhet të punojnë në institucione akademike, kërkimore apo në nivele të larta menaxheriale në biznese. Gjithashtu, për të aftësuar studentët që të marrin vendime apo të nxjerrin rezultate nga këto të dhëna. Më tej ata marrin njohuri dhe afësohen në aspekte të menaxhimit dhe planifikimit si dhe të ekonomiksit menaxherial apo të drejtimit</p>



	<p>të riskut në ndërmarrjet e agrobiznesit duke kompletuar aspektin e njohurive. Njohuritë e fituara, duke përfshirë dhe praktikën kërkimore, materializohet në punimin final të temës.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p><b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë për Doktoraturë pranë DDA, por edhe në programe të tjera të ngjashme të ciklit të tretë të studimeve në fushën e menaxhimit. (<i>Doc. no. 36:Regullore e ciklit të tretë Doktoraturë-Neni 5, Pika 2 &amp; Neni 9, Pika 1</i>). Gjithashtu vlen të përmendet se mikroteza e Masterit mund të identifikojë çështje kërkimi që kanë nevojë për studime të thelluara dhe të detajuara që mund të realizohen në ciklin e tretë të studimeve. Studentët që mbarojnë ciklin e dytë të studimit mund të vazhdojnë ciklin e tretë Doktoraturë brenda vendit, në shumicën e rasteve në DDA, por edhe jashtë vendit, duke qënë se programet e FEA janë ristrukturuar nga projekte të huaja (SARA, GIZ, TEMPUS) duke mundësuar në këtë mënyrë edhe përafrimin me programe të ngjashme studimi në vendet e zhvilluara.</p> <p>Në takimin e realizuar me përfaqësuesit e Degës së Projekteve, Kërkimit dhe Kooperimit Shkencor në UBT, krahas diskutimeve mbi ndërkombëtarizimin dhe pjesëmarrjen në projekte, u diskutua edhe për pjesëmarrjen e kënaqshme të studentëve të FEA, të vitit të fundit bachelor dhe master, në konferencat studentore të organizuara nga shoqata e studentëve çdo vit. Në këto konferenca studentët e DDA paraqesin punën e tyre kërkimore të diplomës apo mikrotezës (<i>Doc. no. 31 – Book of proceedings, Koferencë studentore</i>). Gjithashtu, disa prej tyre marrin pjesë edhe në konferencat e organizuara nga Universiteti/Fakultetet në bashkëpunim me pedagogët.</p> <p>Nga të gjithë studentët e gjurmuar të FEA të diplomuar gjatë vitit 2017-2018, rezulton se 12,17% janë të diplomuar të programit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve”. Kompetencat, njohuritë dhe aftësitë e fituara pas mbarimit të këtij programi studimi i kanë dhënë mundësi studentëve të punësohen në sektorin e Agrobiznesit apo edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë, duke qënë se 57.14% e të diplomuarve janë punësuar në profilin për të cilin janë diplomuar [<i>Doc- Gjurmimi (mbajtja e të dhënave) viti akademik 2017-2018</i>].</p>

	Studentët e diplomuar shprehen se profilet e punës që ofron tregu përputhen me njohuritë dhe aftësitë që ofrojnë programet e studimeve në UBT, duke konfirmuar që diploma e UBT është e vlefshme për tregun e punës ( <i>Doc. no.8 – Raport Performanca e QKA, fq. 19</i> ).								
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Kurrikulat e tri programeve të DDA janë zhvilluar dhe ristrukturuar duke u bazuar kryesisht në eksperiencën e universiteteve amerikane dhe europiane (projektet si SARA, GIZ & TEMPUS). Megjithatë, zhvillimet e reja në tregje kanë bërë të nevojshme përshtatjen e këtyre kurrikulave. Për rrjedhojë në kryerjen e ndryshimeve në kurrikula apo në përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin në fjalë, DDA kryen një studim tregu për të identifikuar nevojat që ka biznesi dhe agrobiznesi për ekspertët në fushën e menaxhimit të biznesit/agrobiznesit. Kjo procedurë realizohet nga DDA çdo 2-3 vjet dhe duke qënë se studimi i fundit i tregut daton në 2016, nga biseda e realizuar me Përgjegjësin e Departamentit, mësuam se ky studim mendohet të përsëritet së shpejti. Metodologjia e këtij studimi konsiston në përdorimin e një pyetësori në mbledhjen e të dhënave, ku kampioni i marrë në analizë përbëhet nga menaxherë të nivelit të lartë e të mesëm si dhe nga pronarë të bizneseve, kryesisht përfaqësues të sektorit të ushqimit dhe industrisë e agrobiznesit në Shqipëri. Ky studim ka patur si qëllim të identifikojë se cilat janë njohuritë, aftësitë apo kompetencat që kërkojnë bizneset nga ekspertët e rinj apo nga studentët e diplomuar, si punonjës potencial në tregun e punës. Rezultatet e këtij studimi janë reflektuar në ndryshimet e mundshme në kurrikul apo në syllabuset e lëndëve, për të përgatitur studentët në përputhje me kërkesat e tregut të punës. ( <i>Doc.no.7- Studimi i tregut</i> ).								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Pa përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> </tr> </tbody> </table>	Pa përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
Pa përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” përmbush të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. I gjithë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi mban gradën professor dhe doktor, një grade më lartë sesa cikli i studimit ku japin mësim (<i>L. 80/2015 - Neni 59, pika 6</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Siç permendet edhe në Standardin II.2.4, personeli i DDA-s përbëhet nga 20 anëtarë të personeli akademik dhe 2 anëtarë të personeli ndihmës akademik.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin për personelin akademik të përfshirë në këtë program masteri, si nga DDA-së dhe nga departamente të tjera të FEA-s, rezulton se personeli akademik mban kualifikimet e mëposhtme:</p> <p>Profesor – 10 ( ku 3 prej tyre janë anëtarë të DDA-së)  Profesor i Asociuar – 11 ( ku 6 prej tyre janë anëtarë të DDA-së)  Doktor – 4 ( ku 1 anëtarë është i DDA-së)</p> <p><i>(Doc. No.23: Staf i FEA-DDA, Doc. No.39: Të dhënat tabelare për personelin akademik në programin e studimit dhe kualifikimet e tyre &amp; Doc no. 108: Të dhënat për titujt dhe gradat e stafit akademik të programit Msc).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim. Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik të këtij programi del në pah se orientimi i studimeve master, doktoraturë, apo kërkimor i tyre përkon me ekspertizën në fushat që ata mbulojnë në kurrikulën e programit të studimit dhe me natyrën e moduleve që mbulojnë në këtë program studimi (<i>Doc.no 24- Curriculum Vitae e stafit akademik</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të</p>	<p>Ky programi studimi përfshin vetëm kryerjen e mikrotezës. Duke ju referuar kurrikulës së studimit rezulton se praktika profesionale nuk është pjesë e këtij programi studimi (<i>Doc.no.46-Kurrikula e programit të studimit 2018-2019</i>).</p> <p>Semestri i katërt i është dedikuar plotësisht punimit të mikrotezës (<i>Doc.no.46-Kurrikula e programit të studimit 2018-2019</i>). Gjatë kësaj peirudhe studenti supervizohet nga pedagogu udhëheqës në procesin e mbledhjes së të dhënave, përpunimit dhe analizës së tyre, si dhe në shkrimin e finalizimin e materialit të mikrotezës. Kryerja e mikrotezës është një punë e pavarur e studentit dhe për këtë arsye nuk kërkon angazhimin e një personeli të dedikuar nga</p>

<p>tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>ana e subjekteve përgjegjëse për të mbikëqyrur këtë process. Megjithatë, nga diskutimi i realizuar me studentët e këtij programi rezultoi se aktiviteti i tyre kërkimor është plotësisht i mbështetur nga ndihma e pedagogut dhe departamenti i DDA. Ata gjithashtu pohuan se janë në komunikim të vazhdueshëm me pedagogun udhëheqës, duke përdorur si formën elektronike edhe komunikimin ballë për ballë, për çdo problematikë që mund të hasin gjatë këtij procesi.</p> <p>Megjithatë, vlen të përmendet se krijimi i mundësisë për të kryer një intership apo praktikë profesionale pranë një biznesi apo organizate të caktuar gjatë periudhës së realizimit të mikrotezës, do t'i vinte në ndihmë studentit për ta aftësuar dhe parapërgatitur atë për tregun e punës. Kjo mundësi mund të krijohet nëpërmjet Projektit Gradua i cili, përveç të tjerave do të krijojë lehtësi në vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit dhe bizneseve.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Studentët e këtij programi studimi kryejnë praktikala laboratorike përkatësisht në lëndët: “Ekonometri”, “Sistemet e Informacionit të Drejtimit” dhe “Optimizim Ekonomik”. Gjatë këtyre orëve, krahas pedagogut të lëndës asistojnë edhe personeli ndihmës akademik, që janë përgjegjës për këto laboratorë, duke dhënë ndihmën e tyre në realizimin dhe mbështetjen e orës laboratorike. <b>(Doc .no. 20- Curriculum Vitae e stafit ndihmës akademik).</b></p> <p>Nga vizita e realizuar në ambjentet e FEA-s rezultojnë se janë në funksion të studentëve 6 laboratorë informatike, të cilët përdoren për kryerjen e praktikave në lëndë të caktuara. Këta laboratorë janë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e këtyre praktikave. Personeli ndihmës kademik në FEA përbëhet nga 3 anëtarë ku secili është përgjegjës për dy salla laboratorit. Ata kujdesen për mirëmbajtjen e mjediseve të laboratorëve dhe mjeteve përkatëse në to. <b>(Doc. no. 47 - Tabelë përmbledhëse mbi kapacitetet infrastrukturore të FEA &amp; UBT-së).</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

**Standardi II.6**  
**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Kurrikulat e tri programeve të DDA janë zhvilluar dhe ristrukturuar duke u bazuar kryesisht në eksperiencën e universiteteve amerikane dhe europiane (projektet si SARA, GIZ &amp; TEMPUS. Megjithatë, zhvillimet e reja në tregje kanë bërë të nevojshme përshtatjen e këtyre kurrikulave. Për rrjedhojë në kryerjen e ndryshimeve në kurrikula apo në përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin në fjalë, DDA kryen një studim tregu për të identifikuar nevojat që ka biznesi dhe agrobiznesi për ekspertët në fushën e Menaxhimit të Agrobiznesit. Kjo procedure realizohet nga DDA çdo 2-3 vjet dhe duke qënë se studimi i fundit i tregut daton në 2016, nga biseda e realizuar me Përgjegjësin e Departamentit, mësuam se ky studim mendohet të përsëritet së shpejti. Metodologjia e këtij studimi konsiston në përdorimin e pyetësorit në mbledhjen e të dhënave, ku kampioni i marrë në analizë përbëhet nga menaxherë të nivelit të lartë e të mesëm si dhe nga pronarë të bizneseve kryesisht përfaqësues të sektorit të ushqimit dhe industrisë e agrobiznesit në Shqipëri. Ky studim ka patur si qëllim të identifikojë se cilat janë njohuritë, aftësitë apo kompetencat që kërkojnë bizneset nga ekspertët e rinj apo nga studentët e diplomuar si punonjës potencial në tregun e punës. Rezultatet e këtij studimi janë reflektuar në ndryshimet e mundshme në kurrikul apo në syllabuset e lëndëve, për të përgatitur studentët në përputhje me kërkesat e tregut të punës. <b>(Doc.no.7- Studimi i tregut).</b></p> <p>Nga ana tjetër, Komisioni i Kurrikulës i cili është përgjegjës për hartimin e procedurave edhe në lidhje me rishikimin e programit, shqyrton arsyetimin e zhvillimit të kurrikulës nëse është e bazuar tek nevojat e identifikuar të tregut <b>(Doc.no.37- Manuali i Cilësisë në UBT, 2018).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në “Manualin e Cilësisë në UBT” (Pika 6.3, fq.12), studentët inkurajohen që të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata gjithashtu kanë të drejtë të vlerësojnë dhe ofrojnë mendimet e tyre përmes procedurave të vlerësimit të kurseve në UBT. Studentët kanë përfaqësinë e tyre në Senatit akademik, Komisionin e cilësisë dhe të kurrikulave si dhe në Komisionin e etikës me një mandat për një periudhë kohore 2 vjeçare.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në</p>	<p>Gjatë kohës së realizimit të vizitës nga ekspertët e jashtëm në IAL, FEA ishte e përfshirë në procesin zgjedhor të anëtarëve të këtyre</p>

<p>mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>komisioneve për një periudhë 2 vjeçare, ku pjesë e këtij procesi janë edhe studentët me përfaqësinë e tyre.</p> <p>Studentët gjithashtu organizohen në Këshilla studentore, ku shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për problematika të ndryshme duke përfshirë këtu edhe çështje të planeve dhe programeve të studimeve (<i>Doc. no.3- Statuti i UBT – Neni 65</i>). Nga takimi i realizuar me studentët mësuam se ata janë në dijeni të këtyre strukturave dhe të funksionimit të tyre.</p> <p>Nga Raporti i performances së QKA rezulton se Bordi i Alumnit si strukture formale është ngritur, por ende nuk ka realizuar aktivitete sipas parashikimeve të planit të punës apo edhe përshkrimeve në rregulloren e QKA (<i>fq. 19</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>UBT në mënyrë të vazhdueshme ka përditësuar dhe riorganizuar programet e saj të studimit në përputhje me vizionin strategjik të zhvillimit të ekonomisë shqiptare në përgjithësi dhe fushës së bujqësisë dhe ekonomisë bujqësore në veçanti. Këto rregullime bëhen në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të vendit. Ndër vite, të gjitha programet e FEA janë organizuar dhe ristrukturuar nga projekte dhe programe të huaja (si psh. SARA, GIZ, TEMPUS)</p> <p>Një iniciativë e rëndësishme në kuadër të bashkëpunimit me partnerë vendas dhe të huaj është projekti Smart AL i DEPZH, i cili konsiston në ndëtimin e një masteri ekzekutiv në fushën e administrimit të territorit dhe politikave në zonat rurale në bashkëpunim me tre universitete shqiptare dhe 4 universitete evropiane. (<i>Doc.no.116- Lista e Projekteve FEA 2017-2018</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plot përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p><b>Standardi II.7</b> <b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” përcakton objektiva e studimit në përputhje me objektivat e UBT.</p> <p>“Ndërtimi i programeve të studimeve në UBT udhëhiqet nga nevojat e biznesit dhe fleksibiliteti, për t’iu përgjigjur përfituesve në tregun e punës”. Arritja e këtij vizioni fokusohet në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve bujqësore e blegtorale me cilësi të</p>

	<p>lartë në kontekstin e administrimit të ndërmarrjeve të agrobiznesit.</p> <p>Gjithashtu ky program është hartuar në përputhje me zhvillimin e njohurive shkencore, teknologjike si dhe në përputhje me të gjitha metodologjitë e reja të mësimdhënies duke synuar krijimin e:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Programe mësimore që mbështeten në arritjet e shkencës dhe inkurajojnë zhvillimin e saj, të teknologjisë dhe marrëdhënieve sociale;</li> <li>2. Programe që lejojnë hyrjen në tregun e punës, zotërim të shpejtë të niveleve të mira të njohurive dhe aftësive konkurruese.</li> </ol> <p>Realizimi i programeve mësimore mbështetet në metoda që e vendosin theksin tek studenti, si dhe që kërkojnë formimin e njohurive hap pas hapi. <b>(Doc.no.4 - Plani strategjik i UBT, fq.34)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Në takimin e realizuar me pedagogët e këtij programi studimi u pohua se departamenti mbështet, nxit dhe respekton pedagogët në organizimin e veprimtarive të mësimdhënies, në punën e tyre kërkimore-shkencore, në pjesëmarrjen në studime dhe projekte të ndryshme në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe të huaj si dhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe kualifikimin e tyre.</p> <p>Në Statutin e UBT <b>(Doc.no. 3)</b>, në nenin përkatës, <b>(Neni 3, fq.6-7)</b> parashtrohen të drejtat që sigurojnë lirinë akademike të institucionit në fjalë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>DDA angazhon, nxit dhe motivon studentët të bëhen pjesë e studimeve dhe projekteve kërkimore në nivel njësie apo fakulteti. Nga takimi i realizuar me pedagogët e këtij programi studimi dhe sidomos me anëtarët e GMK-ve të DDA mësuam se studentët janë nxitur gjithmonë dhe janë përfshirë realisht në kërkime, studime dhe projekte të ndryshme. Gjithashtu ata kanë bashkëpunuar me pedagogët në realizimin e produkteve reale të studimeve apo në artikuj të paraqitur në konferenca studimore. Këtë fakt e phuan edhe përfaqësuesit e Degës së Projekteve, Kërkimit dhe Kooperimit Shkencor në UBT gjatë takimit që u realizua me ta.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Vlen të përmendet Projekti Akademia A100+F, financuar nga Qeveria Shqiptare, në të cilin përveç pjesëmarrjes së pedagogëve të DDA janë angazhuar edhe studentë të programit në fjalë. Projekti me titull “Sustainable Rural Development in Balkan Areas” financuar nga MADA // CIHEAM, ku krahas anëtarëve të DDA janë përfshirë edhe studentë. Fokusi i këtij projekti ishte në përputhje me programin e studimit në fjalë, sepse u studiu</p>

	<p>zinxhiri i vlerës, cili është subjekt i një numri të konsiderueshëm modulesh në këtë program (Drejtimit Marketingu, Kërkim dhe Analizë Tregu, Biznes Ndërkombëtar etj).</p> <p><b>(Doc. no. 21 – Analiza e punës shkencore në DDA 2018)</b></p> <p>Gjithashtu edhe projekti i financuar nga Komisioni European “The impact of policy instruments on the farming systems in Albania”, ku krahas anëtarëve të stafit të DDA-s janë përfshirë edhe 12 studentë të programit master shkencor në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” për mbledhjen e të dhënave nëpërmjet pyetësorëve. Fokusi i këtij studimi përputhej me fokusin e objektivave të programit master: Gjetja e zgjidhjeve dhe hartimi i politikave publike për zhvillimin e fermave shqiptare në përgjithësi. Ky ka qënë një studim rajonal, i cili ka përfshirë tre rajone të Shqipërisë (Berat, Lezhë dhe Elbasan) <b>(Doc. no. 34 - Studimi IPTS, Cover Pages).</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>UBT angazhohet që të mbështesë aktivitetet kërkimore dhe studimore të njësi bazë, duke qënë se kërkimi dhe projektet kërkimore shkencore janë pjesë e objektivave që merren parasysh në hartimin e projekt buxhetit të institucionit <b>(Doc.no. 110 - Relacion Projekt Buxheti 2017-2019, Pika 7 &amp; 11).</b> Kjo rritje në financim nënkupton rritjen e të ardhurave për financimin e projekteve prioritare të identifikuar nga vetë universiteti dhe/ose si bashkëfinancim për projekte dhe programe që e kërkojnë këtë <b>( Doc. No. 33- Projekt Buxheti i Adriaftouring).</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p><b>Standardi II.8</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Institucioni ka siguruar bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore për realizimin e kërkimit shkencor që përmbush objektivat e këtij programi studimi. Në këto bashkëpunime ka një përfshirje jo vetëm të stafit të DDA, por edhe të studentëve të këtij programi studimi. Një nga projektet që pasqyron atë çfarë u tha më sipër është projekti me titull “Sustainable Rural Development in Balkan Areas”, një bashkëpunim ndërmjet DDA /Institutit për Studime Ekonomike dhe Transferimit të Njohurive (ISETNJ) dhe</p>

	<p>agjencisë MADA (Mountain Area Development Agency)/CIHEAM. Projekti konsistonte në studimin e zinxhirit të vlerës, i cili përputhet me këtë program studimi duke qënë se është subjekt i një numri modulesh në të, të tilla si: Drejtim Marketingu, Kërkim dhe Analizë Tregu, etj. Gjithashtu vlen të përmendet se ky project ka patur një impakt të rëndësishëm.</p> <p><i>(Doc. no. 21 – Analiza e punës shkencore në DDA 2018 &amp; Doc. no.4-IESKT Report_2015-2016-MADA)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Vlen të përmendet Projekti Akademia A100+F, financuar nga Qeveria Shqiptare, në të cilin përveç pjesëmarrjes së 7 pedagogëve të DDA janë angazhuar edhe studentë të programit në fjalë.</p> <p>Gjithashtu edhe projekti i financuar nga Komisioni European “The impact of policy instruments on the farming systems in Albania”, ku krahas 5 anëtarëve të stafit të DDA-s janë përfshirë edhe 12 studentë të programit master shkencor në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” për mbledhjen e të dhënave nëpërmjet pyetësorëve. Fokusi i këtij studimi përputhej me fokusin e objektivave të programit master: Gjetja e zgjidhjeve dhe hartimi i politikave publike për zhvillimin e fermave shqiptare në përgjithësi. Ky ka qënë një studim rajonal, i cili ka përfshirë tre rajone të Shqipërisë (Berat, Lezhë dhe Elbasan) <i>(Doc. no. 34 - Studimi IPTS, Cover Pages)</i>.</p> <p><i>(Doc. no. 21 – Analiza e punës shkencore në DDA 2018)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Në takimet e realizuara me përfaqësuesit e Degës së Projekteve, Kërkimit dhe Kooperimit Shkencor në UBT, pedagogët dhe përfaqësuesit e GMK-ve u diskutua për pjesëmarrjen e studentëve të FEA, të vitit të fundit bachelor dhe master, në konferencat studentore të organizuara nga shoqatat studentore. Organizatorë të këtij aktiviteti janë studentët e vitit të tretë të ciklit Bachelor dhe studentët e Masterit Shkencor të FEA, të cilët ndihmohen edhe nga pedagogët e rinj të fakultetit. Shoqata e studentëve të FEA për gjashtë vitet e fundit ka organizuar 6 konferenca studentore. Studentët marrin pjesë gjithashtu edhe në konferenca të organizuara nga Universiteti/Fakultetet ku prezantojnë punën e tyre kërkimore të mikrotezës.</p> <p>Konferencat Studentore FEA janë aktivitete që organizohet nga studentët me synimin për t’i dhënë zgjidhje probleme të ndryshme që prekin bujqësinë, agrobiznesin, politikat bujqësore, agroturizmin, financën, kontabilitetin, informatikën e biznesit dhe fushat të tjera që lidhen me bujqësinë.</p>

	<p><i>(Doc. no. 31 – Book of proceedings, Konferencë studentore &amp; Doc.no. 32 -Call for proposal, Konferencë Studentore).</i></p> <p>Ndër vite FEA dhe UBT organizon konferenca ndërkombëtare të ndryshme, këtu vlen të përmendet konferenca ndërkombëtare me titull “2nd International Conference on Agriculture and Life Sciences “ICOALS” e organizuar gjatë vitit akademik 2017-2018. Stafi i DDA-së ka marrë pjesë në këtë konferencë me pesë prezantime/postera.</p> <p>Bazuar në dokumentin mbi analizën e punës shkencore të realizuar në DDA për vitin 2017-2018, pjesëmarrja e stafit të DDA në konferenca shkencore ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit ka qënë e kënaqshme <i>(Doc. no. 21 – Analiza e punës shkencore në DDA 2018)</i> .</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓





### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës harton një plan masash në nivel institucional që duhet të zbatohen brenda një afati të përcaktuar ku përfshihen problematike dhe çështje nga të gjitha njësitë kryesore dhe bazë. Në këtë plan masash përfshihen edhe çështje që prekin aktivitetin e mësimdhënies si zhvillimi dhe përdorimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies. Në zbatim të këtij plani masash ngarkohen personat përgjegjës nga Departamentet dhe Dekanatet <i>(Doc. No. 104 - Plani i masave FEA)</i>.</p> <p>Përveç planit të masave, UBT përdor edhe një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Zhvillimi i vazhdueshëm i teknologjisë ka krijuar mundësinë e futjes së këtyre metodave të reja si e-learning që përfshin format e të mësuarit dhe dhënies së dijeve me ndihmën e pajisjeve elektronike. Me anë të këtyre metodave bëhet zëvendësimi i materialeve të shtypura me versione elektronike si video, teste, forume, animacione etj.</p> <p>Këto metoda ndihmojnë personelin akademik që të krijojë forma më të qëndrueshme dhe të standartizuara të shpërndarjes së të nxënit.</p> <p><i>(Doc. no.29 – Udhëzues për zhvillimin e metodave inovative)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike nga UBT/FEA dhe nga departamentet përkatëse. Ky proces realizohet duke përdorur disa instrumenta:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Vlerësimi nga studentët</b> Në përfundim të çdo semestri, në javën e 14 dhe 15, zhvillohet pyetësori me studentët. Ky pyetësor realizohet 2 herë brenda vitit akademik. Pasi përpunohen të dhënat dhe nxirret rezultati, grupi i posaçëm i punës me përfaqësues nga dekanati dhe departamenti përgatit një raport, të cilin e vendos në dispozicion të departamenteve përkatëse. Rezultatet e këtij pyetësori janë pjesë e analizën vjetore të</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë</p>	

<p>mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>njesisë kryesore dhe asaj bazë. Në rastet kur evidentohen elementë që kanë nevojë të përmirësohen, përgjegjësi i departamentit diskuton rezultate me pedagogun përkatës.</p> <p><b>(Doc. No.28 - Model Pyetëtori Studentët)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Vlerësimi i procesit të mësimdhënies nga stafi akademik</b> Instrumenti i dytë që përdoret për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse është dokumenti i Normimit të Procesit të Mësimdhënies. Ky dokument plotësohet në përfundim të çdo viti akademik nga personeli akademik efektiv në bashkëpunim me titullarët e grupeve Kërkimore Shkencore dhe Drejtuesit të Departamentit. <p><b>(Doc.no.27 - Formulari i normimit të mësimdhënies)</b></p> <li>• <b>Dokumentimi i ngarkesës mësimore</b> Instrumenti i tretë që përdoret nga FEA, është dokumenti i Performancës akademike, ku stafi akademik dokumenton ngarkesën mësimore, performancën në kërkim shkencor, botime si dhe shërbimet ndaj të tretëve. <p><b>(Doc. - Performanca Akademike)</b></p> </li></li></ul>
	<p>Institucioni i jep një rëndësi të veçantë realizimit të pyetësorit me studentët, duke lejuar në këtë mënyrë përfshirjen e tyre në procesin e vlerësimit të mësimdhënies. Për hartimin e këtij pyetëtori angazhohet zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila më pas kalon modelin e pyetësorit në instancat përkatëse për të marrë miratimin. Anketa është e thjeshtë, disponohet në hard-copy dhe synon tërheqjen e opinionëve të studentëve lidhur me procesin e mësimin dhe çdo dukuri tjetër që lidhet me të. Ky proces ndodh 2 herë në vit, përpara sezonit të provimeve, për të evituar ndikimin apo deformimin e vlerësimit. Pasi përpunohen të dhënat dhe nxirret rezultati, grupi i posaçëm i punës përgatit një raport, të cilin e vendos në dispozicion të departamenteve përkatëse. Rezultatet e këtij pyetëtori janë pjesë e analizën vjetore të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p> <p>Nga takimi i realizuar me zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, mësuam se studentëve, përveç pyetësorit në hard-copy, iu vihet në dispozicion edhe një pyetësor online (<b>Doc.no.106-Anketa institucionale</b>) ku ata mund të japin opinionin e tyre në lidhje me procesin mësimor në përgjithësi. Megjithatë, ky pyetësor nuk është plotësuar në masë nga studentët.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin</p>	<p>Strukturat përgjegjëse (njësia bazë dhe kryesore) publikojnë rezultatet e anketave nëpërmjet analizave vjetore. Kjo analizë</p>

dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	diskutohet në mbledhjen përkatëse të departamentit. Pas diskutimeve në Departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat. <i>(Doc. no.50 - Minutat e mbledhjes së departamentit)</i> <i>(Doc.nr.22 - Analiza e Punës Mësimore, DDA, 2017-2018)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Rezultatet e anketave duke përfshirë edhe komentet përkatëse të bëra nga studentët, bëhen publike në mbledhjet e hapura të departamentit Pas diskutimit dhe reflektimit mbi problematikat e gjetura, analiza miratohet dhe në Dekanat.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓


### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në programin e studimeve Master i Shkencave, në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët/orët laboratorike dhe detyra/projekte kursi në varësi të llojit të lëndës. Metodatat e transmetimit të njohurive tek studentët kanë qenë përgjithësisht bashkëkohore në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies. Përdorimi i metodave innovative, përfshirja e mjete bashkëkohore, (si pajisje audio-vizive) apo edhe aplikacione të ndryshme që mundësojnë realizimin e aktiviteteve të mësimin ndikon në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Nga biseda e realizuar me studentët e këtij programi kuptuam se zhvillimi i leksioneve interaktive i lejon ata të përfshihen më tepër në diskutime gjatë orës së mësimin, qoftë leksion apo seminar. Gjithashtu, studentët treguan eksperiencën e tyre në lidhje me leksionet e hapura të zhvilluara me pedagogë të huaj në kuadër të programeve Erasmus+ (polak/gjerman), të cilat i cilësuan tepër inetersante për nga metodika e përdorur.

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Duke iu referuar edhe bisedës së realizuar me studentët e këtij programi, del në pah përkushtimi dhe gadishmëria e personeli akademik për t'iu përgjigjur nevojave të tyre. Studentët tregojnë se pedagogët kanë qënë gjithmonë të gatshëm t'i përgjigjen pyetjeve apo t'i sqarojnë për paqartësi që mund të kenë patur gjatë orës mësimore.</p> <p>Më poshtë listohen format e mësimdhënies dhe mësimnxënies që përdoren në DDA:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma parashikohen në planet mësimore, programet e moduleve, dhe rregulloren mësimore të programit të studimit.</li> <li>• Format e mësimimit teorik e praktik janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj. Në përfundim të secilit modul është parashikuar zhvillimi i provimit përkatës. Modulet klasifikohen në dy grupe kryesore: module të detyruara dhe module me zgjedhje.</li> <li>• Format e kontrollit të dijeve: testimet ndërmjetëse, mbrojtja e punëve laboratorike, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtja e temave të diplomave.</li> </ul> <p><i>(Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA -Neni 51)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës ka investuar në teknologji të reja për të rritur mundësinë që seanca të caktuara apo tema leksioni të mund të zhvillohen në mënyrë më aplikative. Kjo gjë është bërë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies.</p> <p>Në funksion të moduleve aplikative janë vënë në dispozicion të studentëve salla të pajisura me kompjutera dhe programe kompjuterike (6 laboratorë informatike). Këto kapacitete krijojnë mundësi edhe për personelin akademik për të përdorur metoda dhe për të krijuar një mjedis më të favorshëm në funksion të transferimit të dijeve tek studentët.</p> <p><i>(Doc. no. 47 - Tabelë përmbledhëse mbi kapacitetet infrastrukturore të FEA &amp; UBT-së).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në</p>	<p>Nëse i referohemi infrastruktura mësimore, si detyrë dhe përgjegjësi direkte e personelit akademik, ajo paraqitet mjaft mirë. Për të gjitha modulet që zhvillohen në këtë program studimi, ka një</p>

<p>shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>literature bazë dhe rekomanduese ku përfshihen tekste, skripte apo dhe materiale të tjera ndihmëse.</p> <p>Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” përmbush të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. I gjithë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi mban gradën professor dhe doktor, një grade më lartë sesa cikli i studimit ku japin mësim (<b>L. 80/2015 - Neni 59, pika 6</b>).</p> <p>I gjithë personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi është i angazhuar në kërkim-shkencor. Fusha kërkimore-shkencore e secilit nga anëtarët e këtij stafi është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku ata japin mësim.</p> <p><b>Doc. No.39 – Të dhënat tabelare për personelin akademik në programin e studimit dhe kualifikimet e tyre; Doc no. 108- Të dhënat për titujt dhe gradat e stafit akademik të programit Msc &amp; Doc.no. 24- Curriculum Vitae e stafit akademik)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti dhe dekanati realizojnë kontrolle (leksione të hapura) lidhur me disiplinën në procesin mësimor. Raporti i këtij procesi i kalohet përgjegjësve të departamenteve përkatëse. Nga kontrollet e realizuara është konstatuar se procesi mësimor nga ana e pedagogëve të DDA është zhvilluar me korrektësi.</p> <p><b>(Doc.no.98 - Raport mbi asistimin e stafit në orët e hapura)</b></p> <p>Çdo vit akademik, grupi përkatës i punës organizohet në nivel departamenti për të vlerësuar arritjet dhe për të identifikuar problemet që duhen përmirësuar në të ardhmen.</p> <p>DDA, sipas rastit, shikon mundësinë e leksioneve të hapura ku të ftuarit janë përfaqësues nga komuniteti i biznesit dhe institucione të tjera të cilat janë të lidhura me fushat e studimit në FEA dhe DDA. Në këtë mënyrë, studentët kanë një mundësi më shumë për t’u njohur me natyrën e punës së tyre dhe problematikat përkatëse. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet që merren nga pyetëtori i realizuar me studentët.</p> <p><b>(Doc.nr.22 - Analiza e Punës Mësimore, DDA, 2017-2018)</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimimit.</p>	<p>Metodat inovative që përdoren dhe zhvillohen për rritjen dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies listohen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>E-Learning</i> është një mënyrë elektronike e të mësuarit, që nënkupton dhënie e njohurive, mësimdhënies ose studimit, duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike si kompjuter, pajisje mobile etj;</li> </ul>





	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Google site</i> është një aplikacion online që ndihmon në krijimin e një projekti në web ose të një faqe web-i. Pedagogët në UBT kanë krijuar me anë të këtij aplikacioni websitet e tyre personale ku studentët mund të aksesojnë materialet e lëndëve që zhvillohen nga këta pedagogë. <a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/site%20menager/home">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/site menager/home</a></li> <li>• <i>MOODLE</i> (Virtual Learning Enivornment) - një aplikacion LMS (Learning Management System) i cili mundëson menaxhimin e materialit mësimor dhe administrimin e procesit mësimor, nëpërmjet krijimit të faqeve web dinamike për studentët nga ana e pedagogëve.</li> <li>• <i>TEEAL</i> (The Essential Electroniv Agricultural Library) është një bibliotekë online ku stafi akademik I UBT mund të aksesojë publikime të ndryshme.</li> <li>• <i>Moduli online "Njohuri për informacionin"</i> është një pakete e përkthyer me libra online të Universitetit të Cranfield (Mbretëria e Bashkuar), e cila orienton studentin se si të gjejë informacionin e duhur për të shkruar një detyrë apo punë shkencore. Ky modul është rezultat i Projektit TEMPUS.</li> <li>• <i>Sistemi ESSE3</i> është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi në Universitet, jeta unversitare deri në mbrojtjen e diplomës.</li> </ul> <p>Në bisedën e realizuar me studentët e këtij programi mësuam se leksionet janë interaktive duke lejuar pjesëmarrjen e të gjithë studentëve në diskutim. Përdorimi i rasteve të studimit me tematika aktuale (psh. në lëndën Drejtim Marketingu) krijon interes dhe përfshirje serioze të studentëve në diskutim dhe zgjidhjen e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi, si dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. Institucioni përdor metoda të mësimdhënies që fokusohen tek aftësitë, mundësitë dhe intereset e studentëve të tyre.</p> <p>Personeli akademik i këtij programi studimi dallohet për një komunikim etik dhe profesional. Gjithashtu, ky personel kujdeset që nëpërmjet komunikimit të nxisë mendimet dhe opinionet e studentëve. Studentët inkurajohen të ndërmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura gjatë përgatitjes së punës së tyre, tilla si: zgjedhja</p>

	<p>e rasteve të studimit apo tematikave të detyrave të kursit, mënyra e organizimit të prezantimeve që pasqyrojnë punën e tyre të pavarur, si dhe përzgjedhja e personave për tu përfshirë në grupin e punës. Nëpërmjet detyrave të ndryshme që caktohen, studentët udhëzohen dhe mbështeten nga personeli akademik për të mos frenuar kurajon në debat apo kërkim. Bashkëpunimi i ndërsjelltë pedagog-studentë vihet re jo vetëm në procesin e përjavshëm të mësimit, por edhe në procesin e punës për realizimin e mikrotezës, duke filluar me zgjedhjen e temës, mbledhjen e informacionit, përpunimin dhe analizën e rezultateve. Ky bashkëpunim lejon që të krijohet një klimë e mirë e punës dhe si pasojë rezultate pozitive në fund të këtij procesi.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plot përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<p><b>Standardi III.3</b>  <b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Procesi mësimor për programin e studimeve Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi zhvillohet pranë ambjentëve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Këto ambiente janë të ndara në dy godina kryesore, Godina A dhe Godina B.</p> <p>Godina A është e organizuar në 2 kate dhe ka në përbërje të saj 7 salla leksionesh dhe 14 salla seminaresh, si dhe 4 laboratorë (të pajisura me 25 kompjutera secila sallë) për zhvillimin e lëndëve të ndryshme të programit. Ndërsa godina B është e organizuar në 4 kate dhe ka në përbërje të saj 8 salla leksionesh dhe 23 salla seminaresh, si dhe 2 laboratorë (krijuar dhe vendosur në funksionim në shtator 2017) për zhvillimin e lëndëve të ndryshme të programit. Gjithashtu, në Godinën B është i pozicionuar edhe Dekanati i FEAs.</p> <p>Nga vizita e realizuar në ambjentet e këtyre dy godinave vumë re se ato mirëmbahen dhe pastrohen rregullisht nga stafi ndihmës i fakultetit.</p> <p><i>(Doc. no. 47 - Tabelë përmbledhëse mbi kapacitetet infrastrukturorë të FEA &amp; UBT-së).</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>UBT/FEA zotëron ambiente, salla, zyra, studio dhe laboratorë, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e këtij programi studimi.</p> <p><i>(Doc. no. 47 - Tabelë përmbledhëse mbi kapacitetet infrastrukturore të FEA &amp; UBT-së).</i></p> <p>Nga vizita e realizuar në ambjentet e Fakultetit konstatoam se mjediset ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret e nevojshme për të zhvilluar një proces sa më cilësor të mësimdhënies. Në këto mjedise gjejmë mjete mësimore të duhura ( kompjutera, Lap-Top, video-projektorë, etj.) që lejojnë një zhvillim normal të procesit mësimor. Gjithashtu, mundësimi i sistemit wireles në mjediset e Fakultetit ndihmon në përmirësimin e këtij procesi.</p> <p>Ambientet ku zhvillohet mësimi i këtij programi studimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme në përputhje me normativën e përcaktuar në VKM. nr. 418 date 10.05.2017, sipas të cilit kërkohen 2.5 m<sup>2</sup> për një student. Duke ju referuar sipërfaqes totale rezulton se FEA zotëron kapacitete mbajtëse për një numër prej 1544 studentë (3860:2.5).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Për të realizuar praktikant/semnaret në module të caktuara të këtij programi nevojiten laboratore kompjuterike. Studentët e këtij programi studimi realizojnë praktika/seminare në laboratorë, përkatësisht në lëndët: “Ekonometri”, “Sistemet e Informacionit të Drejtimit” dhe “Optimizim Ekonomik”. Laboratorët janë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e këtyre praktikave.</p> <p>FEA-s ka vendosur në dispozicion të studentëve të saj, duke përfshirë këtu dhe programin e studimit në fjalë, pesë salla të pajisura me kompjutera (rreth 25 kompjutera secila sallë) si dhe dy salla të reja laboratorike me kompjutera të realizuara në muajin shtator 2017. Në këto kompjutera janë instaluar të gjitha programet (software) e nevojshme për realizimin me sukses të punës së pavarur nga studenti. Këto salla janë produkt i projekteve të ndryshme ndërkombëtare (të koordinuara nga anëtarët e stafit të FEA-s) dhe investim i universitetit (dy sallat me fonde të Universitetit).</p>




	<p>Gjithashtu, në FEA ekzistojnë dy salla speciale: një është në dispozicion të studentëve të doktoraturës (produkt i projektit IPA- Adriatic Food and Tourism, koordinuar nga një anëtar i stafit të DDA-së), e cila është e pajisur me kompjutera (laptop), ndërsa salla tjetër speciale (produkt i një projekti TEMPUS koordinuar nga një tjetër anëtar i stafit të DDA-së) përdoret për mbrojtjen e disertacioneve (doktoraturave) para jurisë dhe për prezantime në kuadër të promovimit të stafit akademik të FEA</p> <p><b>(Doc. no. 47 - Tabelë përmbledhëse mbi kapacitetet infrastrukturore të FEA &amp; UBT-së).</b></p> <p><b>(Doc. No. 116 – Lista e projekteve FEA)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë e përdorur në modulet e këtij programi studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore që u ofrohet studentëve, në vartësi të modulit, përfshin: tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt, material në web, etj. Nëse i referohemi kontrollit të kryer në syllabuset e këtij programi studimi <b>(Doc. no. 69 - Syllabuset e programit të studimit)</b> rezulton se literatura, qoftë bazë apo ndihmëse, garanton marrjen e dijeve të nevojshme të programit të studimit.</p> <p>Përveç materialeve fizike të cilat ofrohen në librarinë e UBT apo dhe në Bibliotekën e FEAs, institucioni zotëron edhe library elektronike TEEAL (mundësuar nga projekti AHEED që UBT ka patur me Universiteti e Hawaii), përmendur më sipër në këtë kategori standardesh, me akses në disa prej revistave më të mira. Përditësimi i kësaj biblioteke në vazhdimësi bëhet nga IAL.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Në Bibliotekën e FEAs, studentët e këtij programi studimi gjejnë tekstat mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve që ndjekin dhe literaturën ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazën e planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. Fondi i bibliotekës pasurohet në mënyrë të vazhdueshme (në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj) duke synuar të reflektojë ndryshimet cilësore të programit të studimit si edhe azhurnimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në përditësimin e fondit merren në konsideratë vazhdimisht edhe sugjerimet e studentëve në mënyrë që të sigurohet literaturë sa më e përshtatshme. Biblioteka ofron hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët.</p> <p><b>(Doc.no.53 - Informacion nga Biblioteka Mentor Përmeti)</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët e FEAs,</p>

<p>mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>aksesojnë libraritë on-line TEEAL që zotëron Universiteti. I gjithë stafi akademik mund ta aksesojë këtë librari nga zyrat e tyre ndërkohë që studentët mund ta aksesojnë nga biblioteka. <b>(Doc.no.52 - Biblioteka online TEEAL)</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër në këtë standard, salla special apo ndryshe “videoconference- room” ka të instaluar një platformë e-learning për të zhvilluar mësim në distancë. Qëllimi i krijimit të kësaj salle ka qënë përdorimi i një platforme on-line për realizimin e kursit teorik të një programi të përbashkët doktore ndërmjet UBT, UT dhe Universitetit të Bitolës në Maqedoni.</p> <p>Siç u përmend edhe më sipër në këtë kategori standardesh, Moduli “Njohuri për informacionin” aktualisht është implementuar në Kurrikulën e FEA, në programin e studimeve bachelor, por për natyrën e tij është i aksesueshëm online për të gjithë personelin akademik dhe studentët e UBT, panvarësisht programit të studimit. Ky modul është përkthimi i një pakete me libra online të Universitetit të Cranfield (Mbretëria e Bashkuar) dhe orienton studentin se si të gjejë informacionin e duhur për të shkruar një detyrë apo punë shkencore (versioni shqip gjendet në: <a href="http://ubt.edu.al/albagt_final/albagt_start.html">http://ubt.edu.al/albagt_final/albagt_start.html</a> dhe versioni anglisht gjendet në: <a href="http://info-lit.shrivenham.cranfield.ac.uk/index.html">http://info-lit.shrivenham.cranfield.ac.uk/index.html</a> ).</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Informacioni me karakter didaktik gjendet në portalin e UBT-së, në websitet personale të pedagogëve, duke mundësuar në këtë mënyrë vendosjen e një komunikimi sa më të mirë dhe marrjen e informacionit në distancë nga studentët (<a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/home">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/home</a> ). Në këto portale studentët mund të aksesojnë syllabusin e lëndëve që frekuentojnë, leksionet e këtyre lëndëve, informacionin mbi detyrat që do të kryejnë gjatë frekuentimit të kurseve specifike dhe vlerësimin përkatës, si dhe materiale e informacione të tjera në funksion të realizimit të lëndës në fjalë.</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti Drejtim Agrobiznesi. Në përfundim të semestrit të tretë, studenti plotëson një formular tip, ku specifikohet emri i studentit, fusha e studimit të kërkuar, propozimi për profesorin udhëheqës pasi</p>

	<p>është marrë edhe aprovimi i tij. Ky dokument dorëzohet në department, ku ky i fundit organizon një mbledhje për miratimin e temave dhe propozimeve të studentëve.</p> <p>Gjithashtu, Departamenti përcakton kriteret dhe standartet e përgatitjes së një punimi diplome të nivelit të dytë “Master i shkencave” (<i>Doc.no.12: Rregullore e Programit të Studimit – Neni 20, pika 3</i>).</p> <p>Udhëheqësi i punimit të diplomës (personeli akademik) përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit dhe pedagogu (<i>Doc.no.12:Rregullore e Programit të Studimit – Neni 20, pika 4</i>). Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë (<i>Doc.no.12:Rregullore e Programit të Studimit – Neni 20, pika 5</i>).</p> <p><i>(Doc. no. 54 - Formulari i propozimit të temës së mikrotezës)</i>  <i>(Doc. no. 55: Lista e miratuar e udhëheqjeve shkencore për vitin akademik 2017-2018)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht ✓


<b>Standardi III.4</b> <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë	UBT ka krijuar në nivel institucional njesitë qe promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Këto njësi ndihmëse që vihen në funksion të procesit mësimor-kërkimor listohen si më poshtë ( <b>Doc. No. 3 - Statuti i UBT, Neni 26</b> ): 1. Sektori i Mësimin, Kurrikulave & Vlerësimit Institucional



<p>aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>2. Sektori i Informacionit &amp; Transferimit të Njohurive Këto dy sektore ndjekin me përgjegjësi problemet që lidhen me mësimin, vlerësimin institucional dhe karrierën studentore në Universitet (<i>Doc. No. 56 – Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ 2017, Neni 9</i>).</p> <p>3. Sektori i Kërkimit, Koop. Shkencor &amp; Projekteve. Ky sektor lehtëson zbatimin e projekteve në fushat e ndryshme të shkencave bujqësore me synim përfshirjen e stafit akademik, kërkuesve të rinj dhe studentëve të UBT-së në projekte për zhvillim kapacitetesh, kërkime shkencore, studime të orientuara dhe iniciativa të tjera që lidhen ngushtë me arsimin e lartë.</p> <p>4. Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë &amp; Publikun që përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe</li> <li>✓ Zyra e Marrëdhënieve me Publikun.</li> </ul> <p>Veprimtaria e këtyre sektorëve disiplinohet me rregullore që miratohen nga Senati i UBT-së.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Cilësia e procesit të mësimdhënies dhe të programeve të studimit janë në focus të vazhdueshëm të Departamentit të Agrobiznesit në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të performances akademike-mësimore, të dy këto njësi organizojë më mënyrë periodike, leksione të hapura. Këto orë të hapura organizohen në të dy drejtimet në lidhje me personelin akademik të ri në Universitet:: (a) personeli akademik i ri ndjek orë leksionesh nga stafi më me përvojë dhe gjithashtu ai (b) asistohet gjatë orëve të hapura nga titullarët e modulit si dhe nga përfaqësues të departamentit dhe fakultetit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Një praktikë tjetër e rëndësishme e ndjekur nga DDA janë edhe leksionet që zhvillohen nga lektorë vendës, si personalitete të fushës në Shqipëri, por edhe lektorë të huaj, të ftuar në kuadër të programeve ERASMUS+ nga universitete perëndimore. Në lidhje me këtë të fundit DDA ka një eksperience mjaft të mirë dhe të pasur. Këtë e konfirmuam edhe në takimin e realizuar me studentët e këtij programi, të cilët i cilësuan këto leksione (leksione të realizuara me pedagogë gjerman/polak) tepër inetersante për nga metodika e përdorur dhe tematikat e trajtuara. Kuptohet që këto shkëmbime eksperience i shërbejnë jo vetëm rritjes së ndërgjegjësimit të personeli akademik dhe studentëve për cilësinë</p>

	<p>e mësimdhënies dhe përmirësimit të saj, por edhe përdorimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p><b>(Doc.no.98 - Raport mbi asistimin e stafit në orët e hapura)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në strategjinë e UBT ndër të tjera, prioritet është edhe kërkimi shkencor. Kërkimi shihet si pjesë integrale e rolit akademik dhe një faktor kyç në promovimin Institucioni ka vendosur theksin në identifikimin e fushave të qendrueshme të kërkimit si dhe në bashkërendimin e përfshirjen e elementeve të planifikimit të veprimtarisë shkencore në nivel departamenti. Mësimdhënia në Universitet mbështetet nga kërkimi shkencor, i cili përdoret si një mënyrë për të përmirësuar mësimdhënien dhe nxënien e dijeve.</p> <p><b>(Doc. no.4 – Plani Strategjik i UBT)</b></p> <p>Personeli i DDA-s përbëhet nga 20 anëtarë të personeli akademik dhe 2 anëtarë të personeli ndihmës akademik. I gjithë personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” mban gradën professor dhe doktor, një grade më lartë sesa cikli i studimit ku japin mësim (<b>L. 80/2015 - Neni 59, pika 6</b>). Krahasuar me vitin akademik 2016-2017 në DDA ka fituar gradën shkencore “Doktor” një anëtar departamenti duke e çuar numrin e anëtarëve të departamentit me titullin Doktor në 6.</p> <p>Stafi akademik i fakultetit është i organizuar në dy Grupe Mësimore Kërkimore (GMK), të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre duke ndërthurur mësimdhënien dhe kërkimin, në dy drejtime të rëndësishme; Drejtim dhe Marketing.</p> <p>Personeli akademik i DDA ka treguar arritje të kënaqshme në fushën e kërkimit. Ky fakt mbështetet në numrin e kënaqshëm të artikujve shkencorë të botuar në revista të huaja të njohura si edhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare organizuar brenda dhe jashtë vendit. Siç u përmend edhe më sipër në prioritetin e strategjisë së UBT, kualifikimi i personelit akademik në fushën e kërkimit ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p><b>(Doc. no.14 - Publish&amp;Perish_Staf akademik DDA 2018)</b></p> <p><b>(Doc. no.16 - Raporti i Analizës së Punës Kërkimore UBT 2017)</b></p> <p><b>(Doc. no. 21 - Analiza e punes shkencore DDA 2018)</b></p> <p><b>(Doc. No.39 – Të dhënat tabelare për personelin akademik në programin e studimit dhe kualifikimet e tyre)</b></p>

	<i>(Doc.no.18 - Lista e konferencave organizuar nga UBT 2013-2016)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Personeli akademik i UBT/DDA në kuadër të projekteve të ndryshme të bashkëpunimit, por edhe në kuadër të marrëveshjeve që ka UBT me institucione të tjera publike është trajnuar në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie. Ttrajtime të rëndësishme në këtë kontekst janë “Grant Writing” dhe “Prioritization Settings” (organizuar nga projekti AHEED), trajnimi i realizuar nga projekti DOCSMEC në lidhje me e-learning si dhe trajnimi për përdorimin e metodës “Conjoint Choice Analyses” (projekti AHEED - UBT me Universitetin e Hawaii) si një metodologjie kërkimi. Si rezultat i përdorimit të metodologjisë së kërkimit janë realizuar shumë artikuj shkencor dhe punime doktorature.
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Në lidhje me trajnimin e personelit ndihmësakademik përmendet projekti Consus dhe E- library, i cili ka organizuar një numër trajnimesh për stafin ndihmësakademik të bibliotekës së UBT për organizimin dhe sistemimin e informacionit akademik.
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik i trajnuar i këtij programi studimi,ka përgjegjësinë që të transmetojë tek studentët metodat dhe praktikat e reja të fituara gjatë trajnimit. Një shembull i përdorimit dhe transmetimit të njohurive të fituara gjatë trajnimit “Grant Writing” dhe “Prioritization Settings” tek studentët e ciklit të dytë master shkencor është në lëndën “Metodologjia e Kërkimit”. Këto metoda të reja por edhe të tjera të fituara në kuadër të trajnimeve të ndryshme janë transmetuar tek studentët duke rezultuar si metoda me vlerë dhe të suksesshme.
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	<i>(Doc. no. 71 - Çertifikatë trajnimi Grant Writing + Prioritization Settings)</i> Në kuadër të programe Erasmus+, personeli akademik i DDA-së rezulton të ketë një bashkëpunim dhe partneritetit të suksesshëm me kolegë të universiteteve të tjera homologe në rajon dhe në Europë. Vlen të përmendet këtu përfshirja e personelit akademik në ”exchange mobility” në kuadër të projekteve Erasmus+ që UBT ka me universitete të tjera partnere. Disa pedagogë të DDA-së kanë realizuar vizita shkëmbimi në kuadër të projekteve Erasmus + në Universitetin e Milanos dhe në atë të Shkencave të Jetës në Varshavë/Poloni për një eksperiencë një javore në mësimdhënie apo trajnime. Numri i mobiliteteve në kuadër të projekteve



	<p>Erasmus+ po rritet nga viti në vit. Gjatë vitit akademik 2017-2018 nga departamenti i DDA-së ka patur gjashtë mobilitete në projektet Erasmus+. Tre mobilitete për 'teaching' janë realizura në Universitetin e Shkencave të Jetës në Warshavë dhe tre të tjera për 'Training' në Afyon Kocatepe University/Turqi. Po ashtu kolegë nga këto universitete kanë ardhur dhe janë angazhuar për periudha të shkurtra në mësimdhënie pranë FEA të supervizuar nga pedagogë të DDA-së. Shkëmbimi në kuadër të këtyre programe i referohet përveç personelit edhe studentëve të programit në fjalë. Këto bashkëpunimeve dhe shkëmbime eksperiencash ndikojnë në cilësinë e performancës së personelit por edhe ngritjen në një nivel më të lartë të transmetimit të dijeve tek studentët (praktika të reja mësimdhënie, potencialisht mjete të reja mësimdhënie, metoda të reja të përfshirjes së studentëve në diskutim - interaktivitet më intensiv). Ky fakt u pohua edhe nga pedagogët e këtij studimi gjatë takimit të realizuar me ta.</p> <p><i>(Doc. no. 58: Lista e mobiliteteve ERASMUS)</i>  <i>(Doc. no. 41- LA Student Outgoing-Student Incoming).</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Bazuar në Rregulloren e studimeve UBT (Neni no. 57), format e kontrollit të dijeve përcaktohen si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që ka përvetësuar studenti gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli janë: testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, projektet apo detyrat e kursit, esetë dhe provimi final.</li> <li>2. Detyrat e kontrollit janë elementë të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Detyrat e kontrollit organizohen në javën e tetë të çdo semestri, mbi bazë grupi mësimor dhe vetëm gjatë orëve të planifikuara për seminare. Detyrat e kontrollit organizohen vetëm me shkrim.</li> <li>3. Provimi final organizohet: (a) me shkrim, b) me gojë, ose (c) i kombinuar (me shkrim e me gojë). Departamenti përcakton</li> </ol>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	<p>4. Mënyrat e kontrollit të dijeve sipas pikës (a) të këtij neni, përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor.</p> <p>5. Provimi final organizohet dhe përfundon në datën dhe orarin e përcaktuar në grafikun e provimeve. Grafiku i provimeve hartohet nga Zv. Dekani për mësimin në bashkëpunim me përgjegjësat e departamenteve dhe miratohet nga Dekani. Grafikët e provimeve shpallen jo më vonë se katër javë para fillimit të sezonit.</p> <p>6. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimsht, kthehet në note. Tezat e provimit hartohen nga titullari i modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet ndërrimi i tezës</p>
	<p><i>( Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 36 ).</i>  <i>(Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 59 )</i>  <i>(Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 65)</i></p>
	<p>Format e kontrollit të dijeve edhe pse gjendet në rregulloret e FEA, DDA dhe në atë të programit të studimit, i bëhet me dije studentit në javën e parë të fillimit të mësimit nga pedagogu/pedagogët përgjegjës i/të lëndës përkatëse. Studenti mund të informohet edhe në distancë përmes website të pedagoqeve në lidhje me elementët e mësimit dhe vlerësimit të tij, nëpërmjet syllabusit apo planit kalendar që plotësohet në fillim të semestrit.</p>
	<p>Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: (1) vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit, si dhe (2) vlerësimi përfundimtar <i>(Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 35; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 64 &amp; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 58 )</i>.</p>
	<p>Raporti i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me vlerësimin përfundimtar, përcaktohet nga pedagogu/pedagogët përgjegjës për lëndën përkatëse në programin e modulit (i cili miratohet para fillimit të çdo viti akademik nga përgjegjësi i departamentit). Duke shqyrtuar syllabuset e lëndëve të programit dhe takimet e realizuara me personelin akademik dhe studentët e këtij programi, rezultoi se për shumicë e lëndëve (16 module) ky raport është në masën 60 %</p>





	<p>vlerësimi përfundimtar (përfitohet nga provimi përfundimtar) dhe 40% vlerësimi i vazhduar ( përfitohet nga seminarët/ushtrimet, detyra/projekte kursi, raste studimi dhe detyrë kontrolli) gjatë vitit. Për shkak të llojit të lëndës apo specifikave përkatëse ky raport gjëndet edhe në masë 50% ( 2 module), 70% (1 modul) dhe 80% ( 1 modul) vlerësimi përfundimtar dhe 50% ( 2 module), 30% (1 modul) dhe 20% (1 modul) vlerësimi i vazhduar gjatë vitit. Vlerësimi përfundimtar nuk është më pak se 50% dhe nuk e kalon masën 80%. Në lidhje me vlerësimin e vazhduar, studenti në të gjitha lëndët e programit realizon: (a) një detyrë kontrolli ku vlerësimi, në varësi të llojit të lëndës, varion nga 10 % deri 40%; (b) një detyrë/project kursi/raste studimi ku vlerësimi, në varësi të llojit të lëndës, varion nga 10%-20%; ndërsa nga angazhimi aktiv i studentëve enë orët e seminareve/praktikave laboratorike vlerësimi varion nga 10%-15%. Kjo formë vlerësimi inkurajon angazhimin e plotë të studentëve gjatë gjithë kursit, por gjithashtu i parapërgatit ata për sezonin e provimeve ku mjafton vetëm një përsëritje e asaj çfarë kanë mësuar gjatë semestrit. Ky fakt na u pohua edhe nga studentët e këtij programi studimi.</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi III.6</b> <b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	<p>Vlerësimi i vazhdueshëm lejon interaktivitetin e studentit përgjatë kursit, inkurajon angazhimin e plotë të tyre gjatë gjithë kursit, por gjithashtu i parapërgatit ata për sezonin e provimeve.</p> <p>Siç u përmend edhe më sipër në Standardin III.5, vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit, i cili përbën 20%-50% të vlerësimit total të studentit.</li> <li>2. Vlerësimi përfundimtar në sezonin përkatës, i cili përbën 50%-80% të të vlerësimit total të studentit.</li> </ol> <p><i>(Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 35; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 64 &amp; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 58)</i></p>

	<p>Raporti i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me vlerësimin përfundimtar, përcaktohet nga pedagogu/pedagogët përgjegjës për lëndën përkatëse në programin e modulit, ky i fundit miratohet para fillimit të çdo viti akademik nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimi përfundimtar gjenden në formë elektronike përmes sistemit ESSE3. Historiku i tyre ruhet nga sistemi pasi duhet të konsiderohet nga pedagogu për sezonet e tjera për efekt vlerësimi në rastet kur studenti rezulton me status ngelës në sezonin normal të modulit (<i>Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 37; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 66 &amp; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 60</i>)</p> <p>Gjithashtu, informacioni mbi vlerësimin e vazhduar gjatë vitit të studentit dokumentohet edhe në hardcopy në dokumenta si regjistri dhe pasqyra e rezultateve (<i>Doc. no. 60 - Regjistri i pedagogut &amp; Doc. no.61 - Pasqyra e vlerësimit të studentit gjatë vitit</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UBT i kushton shumë rëndësi transparencës të procesit të vlerësimit. Nga diskutimi i realizuar me studentët e këtij programi rezultoi se metoda e përdorur tregon transparence dhe mungesë abuzimi, ku secili student shikon vetëm vlerësimin e tij dhe askush nuk ka access për të parë vlerësimet e tjetrit. Në këtë mënyrë rritet privatësia e studentit. Gjithashtu vlerësimi bëhet në kohë dhe studentët lajmërohen me anë të një email-i për daljen e notave.</p> <p>Për vitin e ardhshëm akademik UBT po shikon mundësinë e blerjes dhe vënies në funksionim të një sistemi të brendshëm elektronik të kontrollit të dijeve (provimeve finale dhe testeve të ndërmjetme) në mënyrë që të reduktojë në maksimum abuzimin dhe subjektivitetin në vlerësimin e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Procedura e përdorur në testimin përfundimtar të dijeve dhe atësive të fituara gjatë kursit është standarde dhe përdoret për të gjitha programet e studimit (BA, MP, MSc). Komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Zv. Dekanin për mësimin dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Çdo komision provimi përbëhet nga jo më pak se dy anëtarë,ku njëri prej tyre është titullari i lëndës.</p> <p>Nëse njëri nga pedagogët nuk mund të marrë pjesë në provim, ose kur përgjegjësi i departamentit e gjykon, ai përcakton pedagogun që do ta zëvendësojë. Në rast pamundësie zëvendësimi, me propozim të dekanit dhe miratim të Rektorit, provimi shtyhet jashtë sezonit brenda 5 ditëve nga përfundimi i tij.</p>

	<i>(Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 40; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 69 &amp; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 63)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	UBT ka krijuar në proces standard të vlerësimit të njohurive, i cili përdoret në të gjitha programet e studimit ( BA,MP, MSc) Për realizimin e këtij procesi përdoren fletore tip të cilat janë dizenuar në mënyrë të tillë ku faqja e parë ka elemente të sigurisë. Në të bëhet sekretimi dhe ruajtja e anonimatit të studentëve ( <i>Doc. no.63 - Model Fletore Provimi</i> ). Në ambjentet e FEA-s, ku zhvillojnë mësim edhe studentë të programit Master Shkencor në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” janë të monitoruara me sistem qëndror kamerash si edhe me personel shërbimi që ka si detyrë kryesore ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe provimeve.
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studentët e këtij programi masteri, pothuajse në të gjitha lëndët zhvillojnë detyra/projekte kursi/ si dhe raste studimi. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, në fillim të çdo semestri në shpjegimin e syllabusit të modulit përkatës, instruktoren, këshillon dhe orienton studentët në lidhje me kryerjen e detyrave/projekteve të kursit. Detyrat/projektet e kursit prezantohen përpara kursit dhe pedagogut të lëndës përkatëse, duke përdorur software prezantimi (si programi ppt). Në fund të këtij procesi studentët që prezantojnë punën e tyre marrin feedback nga studentët e tjerë dhe nga pedagogu në lidhje me aspektet positive dhe aspekte që kërkojnë përmirësim). Ky process synon të ndihmojë studentët që të përmirësohen në aspekte të mesimnxënies dhe të përballojnë procesin e ballafaqimit me audiencën gjatë referimit apo prezantimit. ( <i>Doc.no. 64 - Model vlerësimi i detyrës së kursit</i> )
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Gjatë zhvillimit të provimit ndalohet hyrja e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të personelit të Universitetit, me përjashtim të drejtuesit të departamentit dhe personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani/Rektori/Rektorati për të kryer monitorimin apo kontrollin e procesit. Studenti nuk lejohet të futet në provim nëse nuk disponon një mjet identifikimi të tillë si: librezë e studentit, karta e studentit si dhe karta e indentitetit. Gjatë provimit mund të lejohet përdorimi i mjeteve ndihmëse, por në asnjë rast i celularëve. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme përjashtohet nga provimi.

	<p><i>(Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 41; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 70 &amp; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 64)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli janë: testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit dhe provimi final.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Detyrat e kontrollit janë elemente të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Detyrat e kontrollit organizohen në javën e 8 të çdo semestri, mbi bazë grupi mësimor dhe vetëm gjatë orëve të planifikuara për seminare. Detyrat e kontrollit organizohen vetëm me shkrim.</li> <li>✓ Provimi final organizohet a) me shkrim, b) me gojë, c) i kombinuar (me shkrim e me gojë). Departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.</li> <li>✓ Mënyrat e kontrollit të dijeve si më sipër përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor.</li> </ul> <p><i>( Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 36; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 59 &amp; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 65)</i></p> <p>Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 8 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë.</p> <p>Në rastet kur ka një proces ankimi apo në rastet kur ka gabim në hedhjen e notës procesi mund të zgjasë 12 ditë.</p> <p><i>( Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 43,Pika 1&amp;3; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 66, Pika 1&amp;3 &amp; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 72, Pika 1&amp;3)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni, i garanton studentëve të drejtën për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Në nenin përkatës <i>(Neni 43, Pika 2-5)</i> të Rregullores së këtij programi studimi <i>(Doc.no.12)</i> janë pasqyruar kushtet dhe procedurat e shpalljes së rezultateve të provimit, të cilat përfshijnë: (a) procedurën e ndjekur për sqarimin e studentëve në lidhje me paqartësi apo kundërshtim që mund të kenë ndaj vlerësimit të kryer; (b) procedurë e korrektimit në rastin e hedhjes së notës/notave gabim; si dhe (c) procedurën e përmylljes së procesit të rezultateve provimit.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i</p>	

<p>posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Këtë procedurë e gjejmë të pasqyruar edhe në rregulloren e FEA dhe DDA, në seksionet përkatëse.  <i>(Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 66, Pika 2,3,4 &amp; 5; &amp; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 72, Pika 2,3,4 &amp; 5)</i>  Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, ose brenda 2 ditëve (48 orëve) pas shpalljes së rezultatit dhe i drejtohet dekanit të fakultetit. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjës të departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë.  Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjës të Departamentit, që studenti të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat.  <i>(Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 44; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 67 &amp; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 73)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Kurrikula e programi të studimeve “Master i Shkencave” në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” studimi është ndërtuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. <i>(VKM nr.41 dt. 24/01/2018)</i>, si dhe</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Kurrikula ka 18 module nga të cilat 3 module janë me zgjedhje, ku studenti thëllon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të vendimmarrjes së biznesit, ku kjo e fundit i referohet planifikimit dhe menaxhimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të bizneseve si dhe përdorimit të informacionit nga tregu në funksion të kësaj vendimmarrje. Kjo garantohehet nëpërmjet zhvillimit të një miksi të balancuar të lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Kjo kurrikul garanton gjithashtu zhvillimin e aftësive të veçanta përveç atyre specifike për profilin, duke ofruar një modul në fushën e menaxhimit të teknologjisë së informacionit (lënda Sistemet Informativ të Drejtimit). Në lidhje me njohuritë mbi gjuhën e huaj, që i referohet fushës së ndërveprimit, studentët e ciklit të studimit Master i Shkencave duhet të dëshmojnë përpara regjistrimit në këtë program se zoterojnë e një nga 5 gjuhët e Komunitetit Evropian (KE). Në rastet kur studenti nuk zotëron një dëshmi të tillë, me Vendim Rektorati no. 41, dt. 28/09/2016 (<i>Doc. no. 6- Vendim për gjuhën e huaj</i>), është i detyruar të mbyll këtë detyrim brenda vitit të pare të studimeve.</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde, studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat, aftësitë dhe njohuritë që marrin në modulin përkatës. Në module të caktuara, si psh në lëndë Ekonomiksi i Drejtimit, studentët përfitojnë 3 lloje kompetencash: (a) kompetenca instrumentale që i referohen vlerësimit dhe përfitimeve që kanë organizatat e biznesit; (b) kompetenca sistemike – angazhimi i studentëve në menaxhimin e bizneseve për maksimizimin e fitimeve pavarësisht natyrës së biznesit ku ata do të punojnë në të ardhmen; (c) kompetenca komunikuese – aftësimi I studentëve elaborimin e situatave të biznesit në raport me realitetin ekonomik.</p> <p>Në javën e fundit të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Njëkohësisht, merret edhe feedback nga ana e studenteve lidhur me objektivat e vendosura për këtë qëllim.</p> <p>Në javën e fundit të semestrit studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre</p>


	<p>për provimin final si dhe strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi.</p> <p>Në përfundim, të çdo moduli pedagogu i bënë me dije studentët për çështjet më të rëndësishme ku duhet të përqëndrohen si dhe mbi natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin final.</p> <p><b>(Doc.no.26- Kategorizimi i lëndëve; Doc. no. 69 - Syllabuset e programit të studimit &amp; Doc.no.46-Kurrikula e programit të studimit 2018-2019)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i brendshëm gjatë orëve të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij, informon studentët me të rejat e fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit. Në përcjelljen e një informacioni të tillë kanë ndihmuar edhe shkëmbimet e eksperiencave që kanë patur pedagogët e DDA në kuadër të programeve Erasmus+.</p> <p>Në lidhje me personelin akademik të ftuar, DDA ka një eksperiencë mjaft të mire dhe të pasur në këtë drejtim. DDA pret jo vetëm lektorë vendës, si personalitete të fushës në Shqipëri, por gjithashtu edhe një numër të konsiderueshëm përdagogësh nga universitete partnere në kaudër të projekteve Erasmus+ të cilat japin leksion me studentët e masterit shkencor për përmbajtjen e të cilave bihet dakort paraprakisht me departamentin. Synohet që përmbajtja e leksioneve jashtë programit të studimit të përfshijë te rejat më të fundit të shkencës dhe/ose teknologjisë së informacionit. Rasti i fundit, ishte leksioni i mbajtur nga profesoresha Elzbieta Jadęiga Szymanka nga Warsaw University of Life Sciences me studentët e masterit shkencor, ku u diskutua në lidhje me Bujqësinë Organike dhe Eksperiencat më të mira Europine.</p> <p>Këtë fakt e konfirmuam edhe në takimin e realizuar me studentët e këtij programi, të cilët i cilësuan këto leksione (leksione të realizuara me pedagogë gjerman/polak) tepër inetersante për nga metodika e përdorur dhe tematikat e trajtuara.</p> <p><b>(Doc. no. 58: Lista e mobiliteteve ERASMUS; Doc. no. 41- LA Student Outgoing-Student Incoming &amp; Doc. no. 70 - Teaching Staff Agreement, E. Szymanka)</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në</p>	<p>Për module të caktuara të kurrikulës së Masterit Shkencor (të materializuara në syllabuse) studentët, pas marrjes së inforamacionit teorik, testohen në aplikimin e grupit të kompetencave përkatëse në laboratorë kompjuterik (Ekonometri,</p>

laboratorë dhe praktikat profesionale.	Sist.Info. te Drejtimit, Kërkim. & Analizë Tregu, Optimizim Ekonomik, Menaxhim Projektsh) dhe më pas vihen të punojnë në grupe prej tre apo katër studentësh, punë e cila materializohet në një detyrë apo projekt kursi, ku qëllimi është testimi i kompetencave të fituara.
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon grupin e studentëve në realizimin e detyrës së caktuar (Case study/situatë reale tregu/ simulim i zgjidhjes së një problemi biznesi apo edhe një problemi optimizimi në biznes).
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Në këtë proces, personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat dhe momentet që kanë nevojë për më tepër informacion dhe studim të metejshëm. Këto probleme pastaj bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në tema masteri për finalizimin e studimeve. <i>(Doc. no. 69 - Syllabuset e programit të studimit)</i>
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Siç u përmend edhe në standardin II.8, në takimet e realizuara me përfaqësuesit e Degës së Projekteve, Kërkimit dhe Kooperimit Shkencor në UBT, pedagogët dhe përfaqësuesit e GMK-ve u diskutua për pjesëmarrjen e studentëve të FEA, të vitit të fundit bachelor dhe master, në konferencat studentore të organizuara nga shoqatat studentore. Organizatorë të këtij aktiviteti janë studentët e vitit të tretë të ciklit Bachelor dhe studentët e Masterit Shkencor të FEA, të cilët ndihmohen edhe nga pedagogët e rinj të fakultetit. Shoqata e studentëve të FEA për gjashtë vitet e fundit ka organizuar 6 konferenca studentore. Studentët marrin pjesë gjithashtu edhe në konferenca të organizuara nga Universiteti/Fakultetet ku prezantojnë punën e tyre kërkimore të mikrotezës. Konferencat Studentore FEA janë aktivitete që organizohet nga studentët me synimin për të dhënë zgjidhje probleme të ndryshme që prekin bujqësinë, agrobiznesin, politikat bujqësore, agroturizmin, financën, kontabilitetin, informatikën e biznesit dhe fushat të tjera që lidhen me bujqësinë. <i>(Doc. no. 31 – Book of proceedings, Konferencë studentore &amp; Doc.no. 32 -Call for proposal, Konferencë Studentore).</i>
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të	Siç është përmendur edhe në standardin II.4, ky program studimi, për faktin se ka përafërsi me programe të ngjashme ndërkombëtare, ka shkëmbyer një numër të konsiderueshëm studentësh në kuadër të programe Erasmus+ (Erasmus+ KA1) me




mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	<p>Universitetet partnere për një semestër. DDA në bashkëpunim me dekanatin ka qënë fleksibël në kohë dhe në përputhjen e moduleve që do të njihen kur studentët kthehen nga një semestër realizuar në Universitetet partnere. Kjo ka rritur numrin e studentëve që kanë aplikuar për të përfituar nga projektet Erasmus+ por edhe të atyre që kanë fituar.</p> <p>Në bisedën e realizuar me studentët e këtij programi mësuam se 3 nga studentët e këtij programi aktualisht ndodhen jashtë vendit në programe Erasmus dhe 2 studentë janë në pritje të përgjigjes së aplikimit që kanë kryer.</p> <p><i>(Doc. no. 41- LA Student Outgoing-Student Incoming).</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	<p>DDA, në bazë të kuadrit rregullator, përcakton qartë zhvillimin e procesit të diplomimit të studentëve të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve”</p> <p>Procedura e diplomimit të studentëve të programit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” përshkruhet si më poshtë:</p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” në DDA përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në fushën e ekonomisë dhe agrobiznesit. Punimi i diplomës është një punim i pavarur shkencor i studentit.</li> <li>2. Departamenti informon studentët përmes standave të tij, faqes së internetit, apo edhe takime me studentët për kriteret që kërkohet të plotësohen për procedurat e punimit të diplomës. Kriteret janë publike në çdo kohë por intensifikohet komunikimi në mes të semestrit të parë të vitit të dytë.</li> </ol>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të	<ol style="list-style-type: none"> <li>3. Departamenti përcakton kriteret dhe standartet e përgatitjes së një punimi diplome të nivelit të dytë “Master i shkencave”</li> </ol>



rëndësisë dhe peshës specifike.	4. Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti Drejtim Agrobiznesi. Në përfundim të semestrit të tretë, studenti plotëson një formular tip, ku specifikohet emri i studentit, fusha e studimit të kërkuar, propozimi për profesorin udhëheqës pasi është marrë edhe aprovimi i tij. Ky dokument dorëzohet në department, ku ky i fundit organizon një mbledhje për miratimin e temave dhe propozimeve të studentëve.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	5. Departamenti harton listën e studentëve dhe udhëheqësin shkencor të cilat miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit të DDA-s.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	6. Udhëheqësi i miratuar i punimit të diplomës planifikon një kalendar komunikimi me studentin (format e komunikimi: me email ose takime të përcaktuara në mjediset e Fakultetit) në lidhje me mbarëvajtjen e punës për realizimin e punimit dhe përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollon puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit dhe pedagogu.
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	7. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë.
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	8. Studenti dorëzon kopjen e punimit të diplomës të miratuar nga udhëheqësi shkencor në Departament. 9. Mbrojtja e diplomës behet përpara një komisioni me 5 anëtarë të propozuar nga departamenti dhe miratuar nga dekanati. 10. Mbrojtja e diplomës bëhet me gojë dhe vlerësimi final i studentëve është me notë.  <i>(Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 20 ; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 32; Doc. no.5-Rregullores se FEA-s-Neni 37 &amp; Doc. no.72 - Procesverbal mbrojtje, MSc)</i>



<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Kuadri rregullator i DDA përcakton qartë procedurën e përgatitjes së diplomës si më poshtë (<i>Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 22; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 34</i>)</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë "Master i Shkencave" në programin e studimit të kryer, të firmosur nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori i UBT-së, e cila është dokument zyrtar.</li> <li>2. Modeli i diplomës "Master i shkencave" në programet e Studimit të DDA-s, miratohet nga senati akademik.</li> <li>3. Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin/shtojcën e diplomës, sipas modelit të miratuar.</li> <li>4. Emërtimi i diplomave "Master i shkencave" të DDA-s bëhet në përputhje me programin e studimit të ndjekur nga studenti.</li> </ol>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>				
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>(<i>Doc. no. 73-Model Diplome i plotësuar &amp; Doc. No. 74 Diplomë suplement MSc</i>)</p> <p>Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, me kërkesë të tij. Në këto raste studentët depozitojnë pranë ZSS një kërkesë dhe brenda një afati të caktuar u jepet një kopje e firmosur dhe vulosur e programit të ciklit të studimit Master Shkencor.</p> <p>(<i>Doc. no. 75 - Programi i shkurtuar i Masterit të Shkencave "Administrim i Ndërmarrjeve" nga ZSS</i>)</p> <p>Dokumentacioni për studentët ruhet nga IAL për një periudhë të pacaktuar në hardcopy ( Regjistri themeltar i studentit, Regjistri i arritjeve akademike të studentit dhe Regjistri i lëshimit të diplomave) si dhe në databazën digjitale të UBT, sistemi ESSE3.</p> <p>Dokumentacioni në 'hard copy' ruhet në ambjentete e ZSS-së së universitetit. UBT paraqet, sipas rregullave përkatëse, informacione për studentin, në rastet kur kërkohet.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR  
REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, DDA analizon nevojat dhe kërkesat për personelin akademik të programit të studimit duke përpiluar një dokument ku planifikohet ngarkesa mësimore e vitit në fjalë. Në përfundim të këtij procesi, departamenti parashikon se cilat janë nevojat për personel të ftuar, të cilët do të përmbushin detyrat dhe përfitojnë të drejta kundrejt një kontrate. Për menaxhimin e marrdhënies së punës me këta individë, UBT ka miratuar edhe rregulloret përkatëse në lidhje me menaxhimin dhe rekrutimin e personelit (<i>Rregullore e drejtorisë së Menaxhimit të MBNJ &amp; – Rregullore e rekrutimit UBT</i>).</p> <p>Bazuar në nevojat e përcaktuara nga DDD, procesi i rekrutimit të stafit të ftuar koordinohet me Drejtorinë e Menaxhimit të Personelit dhe Pagave. (<i>Rregullore e rekrutimit UBT - Neni 3, Pika 4</i>).</p> <p>Kjo drejtori posedon dosjen e plotë, për secilin anëtar të personelit akademik, të përgjegjës të programit, si dhe të stafit ndihmës për programin e studimit.</p> <p>Nga vizita e realizuar në zyrën e BNJ, nga dosjet e personelit akademik të shqyrtuara (2 dosje) rezultoi se të dhënat në lidhje me titujt e fituar në kohë dhe karrierën përditësohen duke plotësuar informacionin. Specialisti i Zyrës së Burimeve Njerëzore, i përgatit informacione të detajuara për evidencat e punonjësve (<i>Rregullore e Drejtorisë së MBNJ dhe pagave- Neni 4, pika 7 dhe Neni 7, pika 10</i>). Këto evidenca janë të vlefshme si për institucionet brenda vendit (si INSTAT) edhe për ato jashtë vendit. Informacioni i gjeneruar ruhet në arkivën e UBT-së (<i>Rregullore e Drejtorisë së MBNJ dhe pagave- Neni 4, pika 7; Neni 7, pika 1,2,3 &amp; 4; Neni 9</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Drejtorja e menaxhimit të Personelit dhe Pagave ndjek procedurat e posaçme për rekrutimet e personelit akademik në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e Rregullores së kësaj drejtorie. Kjo drejtori është përgjegjëse, në bashkëpunim me departamentin, për plotësimin e nevojave të programit të studimit për staf akademik si dhe për procesin e përzgjedhjes së stafit akademik të ftuar.</p>

	<p>Edhe nga vizita e realizuar në zyrën e BNJ dolën në pah detyrat që kryen në lidhje me këtë process. Kjo procedure konsiston në: koordinimin e punës me njësinë bazë për programin e studimit, ku njësia bazë paraqet kërkesën për personel të ftuar bazuar në nevojat e evidentuara në fillim të vitit akademik si dhe kriteret e veçanta; më pas hartohet oferta e punës duke përfshirë këtu kriteret e pranimit të përgjithshme dhe të veçanta; më tej vazhdohet me shpalljen e njoftimit për vend pune vakant në web si dhe në buletin e APP-së, për një afat kohor 20 ditë; më pas krijohen komisionet për vlerësimin e dosjeve, zhvillohet konkursi dhe pas tij jepet informacioni përfundimar dhe shpalljet e vendimi.</p> <p><b>(Rregullore e Drejtorisë së MBNJ dhe pagave- Neni 6)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Siç përmendet edhe më sipër, Drejtoria e Menaxhimit të Personelit dhe Pagave, në bashkëpunim me DDA realizon procedura të qarta për mbarëvajtjen e procesit të rekrutimit të personelit akademik.</p> <p>UBT, mbështetur në rregulloren e rekrutimit, përcakton të gjitha hapat e procedurës që parashikon rregullorja <b>(Rregullore e rekrutimit UBT, Neni 3 &amp; Neni 4)</b>, të cilat respektohen në mënyre rigoroze; si dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit <b>(Rregullore e rekrutimit UBT, fq.8-9 “Kriteret e rekrutimit”)</b> të cilat, siç u përmend edhe më sipër, bëhen publike si në APP edhe në faqen zyrtare të UBT. Në anekset e kësaj rregulloreje mund të shikohen qartësisht formatet e pikëzimit të këtyre kriterëve <b>(Rregullore e rekrutimit UBT, fq.8-9 “Kriteret e rekrutimit” &amp; Praktikë punësimi staf akademik)</b>.</p> <p>E njëjta procedurë u shpjegua edhe gjatë vizitës së kryer në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>DDA në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit dhe Pagave respekton në mënyrë rigoroze nenet e rregulloreve në lidhje me menaxhimin dhe rekrutimit e stafit të saj. Rregullorja e rekrutimit përcakton qartësisht kriteret për përzgjedhjen e stafit akademik sipas titujve akademikë. Në anekset e këtyre rregulloreve specifikohen kriteret e përgjithshme në lidhje me notën mesatare të dy cikleve të studimit dhe profilin e studimeve; gjithashtu gjejmë të pasqyruara edhe kriteret specifike që lidhen me studime të mëtejshme, përvoja e punës në mësimdhënie, tituj akademik të fituar brenda apo jashtë vendit, njohuri të gjuhëve të huaja, aktiviteti botues shkencor, etj. <b>(Rregullore e rekrutimit UBT,</b></p>

	<i>fq.8-9 “Kriteret e rekrutimit” &amp; Praktikë punësimi staf akademik).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit. Kjo si në aspektin e kushteve por edhe të mundësive për të marrë informacionin e nevojshëm.</p> <p>Nga vizita e realizuar në ambjentet e Institucionit, konstatoam se DDA e ka prioritet sigurimin e mjediseve për realizimin e detyrave dhe dhënien e mundësive të barabarta personelit akademik të saj. Çdo anëtar i personelit akademik ka një zyrë të pozicionuar në një nga dy godinat e FEA, ku mund të punojë më mënyrë të pavarur. Zyrat janë të pajisura me mjete dhe pajisje të nevojshme (si kompjuter, fotokopje videoprojektor etj.) për zhvillimin e detyrave përkatëse të personelit akademik</p> <p>Rikonstruksioni i mjediseve të DDA ka krijuar mundësinë e përfshirjes në mënyrë funksionale të zyrës së sekretarisë së departamentit me qëllim realizimin më të mirë të kontaktit me stafin, studentët dhe pjesën tjetër të stafit ndihmës.</p> <p>Departamenti angazhohet plotësisht për të përmirësuar mjediset e zhvillimit të mësimin, të cilat rezultojnë të mjaftueshme, të ndriçuara duke siguruar kushte të mira për zhvillimin e mësimin. Sistemi wireless në mjediset e FEA krijon kushte të mira për të përmirësuar edhe teknikat e mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Në strategjinë e UBT ndër të tjera, prioritet është edhe kërkimi shkencor. Kërkimi shihet si pjesë integrale e rolit akademik dhe një faktor kyç në promovim. Institucioni e ka vendosur theksin në identifikimin e fushave të qendrueshme të kërkimit si dhe në bashkërendimin e përfshirjen e elementeve të planifikimit të veprimtarisë shkencore në nivel departamenti. <i>(Plani Strategjik i UBT)</i></p> <p>Institucioni, gjithashtu dhe DDA, mbështet aktivitetin kërkimor dhe shkencor ku nëpërmjet të cilit nxit personelin akademik për zhvillim</p>

	<p>profesional të vazhdueshëm (<i>Statuti i UBT- Neni 59, pika 5a</i>). Tematika e kërkimit në UBT zhvillohet në përputhje me prioritetet e kërkimit dhe programet e ofruara (<i>Statuti i UBT- Neni 59, pika 6</i>).</p> <p>Organizimi i grupeve mësimore dhe kërkimore në DDA parashikon një ndarje më të orientuar të punës kërkimore e shkencore në drejtim të fushave dhe projekteve prioritare. Detyrat dhe funksionet e këtyre grupeve kërkimore në drejtim të kërkimit shkencor janë të përcaktuara qartë dhe përfshijnë përmbushjen hartimin dhe implementimin e planeve vjetore të kërkimit shkencor, organizimin e bashkëpunimeve me grupe të tjera kërkimore e shkencore brenda ose jashtë Institucionit apo vendit, bashkëpunimeve me sipërmarrjet private, publikimin e rezultateve të punës kërkimore shkencore dhe nxitja e botimeve shkencore brenda dhe jashtë vendit, etj. (<i>Rregullore e DDA- Neni 7, Pika B</i>).</p> <p>Personeli akademik i DDA ka treguar arritje të kënaqshme në fushën e kërkimit. Ky fakt mbështetet në numrin e kënaqshëm të artikujve shkencorë të botuar në revista të huaja të njohura si edhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare organizuar brenda dhe jashtë vendit (<i>Publish&amp;Perish_Staf akademik DDA 2018; Raporti i Analizës së Punës Kërkimore UBT 2017 &amp; Analiza e punes shkencore DDA 2018</i>). Kualifikimi i personelit akademik në fushën e kërkimit ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies (<i>Plani Strategjik i UBT</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për realizimin e një procesi mësimor cilësor dhe me teknika inovative. Institucioni krijon mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimin (si, videoprojektorët, disponibiliteti i shërbimit të internetit etj.) dhe vendosjen në dispozicion të materialeve udhëzuese në përdorimin e metodave inovative, të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm komunikimin e shpejtë dhe efektiv me studentët.</p> <p>Metodat inovative që përdoren dhe zhvillohen për rritjen dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies listohen si më poshtë (<i>Udhëzues për zhvillimin e metodave inovative</i>):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>E-Learning</i> është një mënyrë elektronike e të mësuarit, që nënkupton dhënien e njohurive, mësimdhënies ose studimit, duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike si kompjuter, pajisje mobile etj;</li> <li>• <i>Google site</i> është një aplikacion online që ndihmon në krijimin e një projekti në web ose të një faqe web-i.</li> </ul>

	<p>Pedagogët në UBT kanë krijuar me anë të këtij aplikacioni websitet e tyre personale ku studentët mund të aksesojnë materialet e lëndëve që zhvillohen nga këta pedagogë.  <a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/site%20manager/home">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/site manager/home</a></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>MOODLE</i> (Virtual Learning Environment) - një aplikacion LMS (Learning Management System) i cili mundëson menaxhimin e materialit mësimor dhe administrimin e procesit mësimor, nëpërmjet krijimit të faqeve web dinamike për studentët nga ana e pedagogëve.</li> <li>• <i>TEEAL</i> (The Essential Electronic Agricultural Library) është një bibliotekë online ku stafi akademik i UBT mund të aksesojë publikime të ndryshme.</li> <li>• <i>Moduli online "Njohuri për informacionin"</i> është një pakete e përkthyer me libra online të Universitetit të Cranfield (Mbretëria e Bashkuar), e cila orienton studentin se si të gjejë informacionin e duhur për të shkruar një detyrë apo punë shkencore. Ky modul është rezultat i Projektit TEMPUS.</li> <li>• <i>Sistemi ESSE3</i> është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi në Universitet, jeta universitare deri në mbrojtjen e diplomës.</li> </ul> <p>Personeli akademik i departamentit të Drejtimit të Agrobiznesit ka qënë pjesë e mjaft mobiliteteve Erasmus+ me karakter trajnues për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies. Në objektivat dhe rezultatet e këtyre mobiliteteve janë qartësisht të motivuara qëllimet e vizitave dhe pritshmëritë e tyre. Në kuadër të këtyre projekteve të bashkëpunimit, personeli akademik i DDA ka qënë pjesë e disa trajnime të rëndësishme në këtë kontekst, përmendim këtu: "Grant Writing" dhe "Prioritization Settings" (organizuar nga projekti AHEED), trajnimi i realizuar nga projekti DOCSMEC në lidhje me e-learning si dhe trajnimi për përdorimin e metodës "Conjoint Choice Analyses" (projekti AHEED - UBT me Universitetin e Hawaii) si një metodologjie kërkimi. Si rezultat i përdorimit të metodologjisë së kërkimit janë realizuar shumë artikuj shkencor dhe punime doktorature.</p> <p>(Lista e projekteve të UBT 2017-2018 &amp; <i>Analiza e punes shkencore DDA 2018</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve</p>	<p>Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit kujdeset që të respektojë planet, objektivat dhe rezultatet e paracaktuara të programit të studimit. Planet mësimore, syllabusi, orari i mësimit dhe</p>





njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	dokumenta të tjera që personeli akademik depoziton në departament (si regjistri i pedagogut, rezultatet e vlerësimit të studentëve gjatë semestrit, etj) dëshmojnë për korrektësi dhe respektim të këtyre elementeve nga personeli akademik duke krijuar në këtë mënyrë një vazhdimësi komunikimi me studentët. Ky fakt mbështetet dhe dëshmohet nga pyetësorët që studentët plotësojnë përpara sezonit të provimeve (2 herë në vit), në vlerësimin e performancës së personelit akademik, rezultatet e të cilit janë pjesë e analizën vjetore të njësisë kryesore dhe asaj bazë. Nga ana tjetër, vihet re angazhimi i personelit akademik të programit në përmirësimin e vazhdueshëm të materialeve mësimore. Mundësia për të shfrytëzuar bibliotekën fizike dhe bibliotekën online "TEEAL" ka mundësuar përdorimin e materialeve dhe artikujve shkencorë bashkëkohorë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			✓	

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkesor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Procesi mësimor për programin e studimeve zhvillohet pranë ambienteve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Këto ambiente janë të ndara në dy godina kryesore, Godina A dhe Godina B. Godina A është e organizuar në 2 kate dhe ka në përbërje të saj 7 salla leksionesh dhe 14 salla seminaresh, si dhe 4 laboratorë (të pajisura me 25 kompjutera secila sallë) për zhvillimin e lëndëve të ndryshme të programit. Ndërsa godina B është e organizuar në 4 kate dhe ka në përbërje të saj 8 salla leksionesh dhe 23 salla seminaresh, si dhe 2 laboratorë (krijuar dhe vendosur në funksionim në shtator 2017) për zhvillimin e lëndëve të ndryshme të programit. Në kompjuterat e këtyre laboratorëve janë instaluar të gjitha programet (software) e nevojshme për realizimin me sukses të punës së pavarur nga studenti. Këto salla janë produkt i projekteve të ndryshme
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive	

bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	ndërkombëtare (të koordinuara nga anëtarët e stafit të FEA-s) dhe investim i universitetit (dy sallat me fonde të Universitetit).			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Ambientet ku zhvillohet mësimi i këtij programi studimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme në përputhje me normativën e përcaktuar në VKM. nr. 418 date 10.05.2017, sipas të cilit kërkohen 2.5 m <sup>2</sup> për një student. Duke ju referuar sipërfaqes totale rezulton se FEA zotëron kapacitete mbajtëse për një numër prej 1544 studentë (3860:2.5).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Mjediset e FEA janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Mjediset mësimore, në varësi të funksionit të tyre (auditorë, sallaleksionesh, klasa seminaresh) janë të pajisura me të gjitha mjetet e përshtatshme për zhvillimin e mësimdhënies, përfshirë: kompjutera, (Lap-Top), video-projektorë, lidhje interneti që nevojitet për zbatimin e procesit mësimor, etj. Në klasat e seminareve mund të përdoren mjetet audiovizuale që janë të depozituara në department dhe mund të ofrohen nga sekretaria e departamentit për të realizuar prezantime, detyra apo projekte kursi. Një nga klasat është e pajisur edhe me Smartboard me sistemin elektrik dhe wireless e cila mundëson zhvillimin e mësimin në kushte shumë të mira. Gjithashtu, siç përmendet edhe në Standardin IV.2.1, cdo zyrë e personelit akademik janë të pajisura me pajisjet e nevojshme dhe internet për të mundësuar përmbushjen e detyrave të personelit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<i>(Infrastruktura Lista e Mjediseve ne funksion te Mesimit te UBT &amp; Lista e projekteve FEA)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht ✓

<b>Standardi IV.4</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke	Në mjediset e Universitetit bujqësor të Tiranës ekzistojnë dy mjedise biblioteka:



<p>garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>- Biblioteka qendrore “Mentor Përmeti” dhe - Biblioteka e Fakultetit Ekonomik, e cila është e vendosur në mjediset e godinës B.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Këto dy biblioteka sigurojnë mundësi të barabartë për studentët e programit që të shfrytëzojnë kapacitetet e tyre si për të studiuar ashtu edhe për të përdorur literaturën e tyre.</p> <p>Studentët kanë akses të plotë në shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës, pa pagesë, duke patur mundësinë të shfrytëzojnë edhe platforma online. Informacioni online odrohet nga burime elektronike me abonim ose falas, nga projekte të ndryshme si Research4life me 5 programe: Hinari, Agora, Oare, Ardi, Goali. Biblioteka e UBT-së, pjesë e së cilës është edhe biblioteka e FEA-s, disponon platformën Springshare (<a href="http://ubt.edu.al/sq/biblioteka-e-universitetit-bujqesor-te-tiranes/platforma-springshare-lnss-western-balkans-albania/">http://ubt.edu.al/sq/biblioteka-e-universitetit-bujqesor-te-tiranes/platforma-springshare-lnss-western-balkans-albania/</a> <a href="https://lnss-albania.libguides.com/?b=g&amp;d=a">https://lnss-albania.libguides.com/?b=g&amp;d=a</a>) që mundëson rritjen e interaktivitetit të shërbimeve të bibliotekës me studentët.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu, studentët, mund të shfrytëzojnë edhe informacionin nga katalogu online i bibliotekës (<a href="http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss">http://www.al.cobiss.net/scripts/cobiss</a>).</p> <p>Të gjithë Informacionin në lidhje me shërbimet që ofron biblioteka studentët e aksesojnë edhe online në faqen përkatëse (<a href="http://ubt.edu.al/sq/sherbimet-ne-biblioteke/">http://ubt.edu.al/sq/sherbimet-ne-biblioteke/</a>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka e Universitetit Bujqësor si rezultat i pjesëmarrjes në projekte që kanë patur në focus veprimtarinë e saj ka zhvilluar strategjinë e saj dhe Politikën e Pasurimit të fondit të Bibliotekës.</p> <p>Në Bibliotekën e FEAs, studentët e këtij programi studimi gjejnë tekstet mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve që ndjekin dhe literaturën ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazën e planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. Në këtë bibliotekë gjenden: 500 tituj në gjuhën shqipe, 2.200 tituj në gjuhë të huaj si dhe 1.700 materiale-periodikë. Fondi i bibliotekës pasurohet në mënyrë të vazhdueshme (në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj) duke synuar të reflektojë ndryshimet cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në përditësimin e fondit merren në konsideratë</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre,</p>	

<p>në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>vazhdimisht edhe sugjerimet e studentëve në mënyrë që të sigurohet literaturë sa më e përshtatshme.</p> <p>Përveç materialeve fizike të cilat ofrohen në librarinë e UBT apo dhe ne Bibliotekën e FEAs, institucioni zotëron edhe library elektronike TEEAL (mundësuar nga projekti AHEED që UBT ka patur me Universiteti e Hawaii), me akses në disa prej revistave më të mira. Përditësimi i kësaj biblioteke në vazhdimësi bëhet nga IAL.</p> <p>Nga vizita e realizuar në ambjentet e Bibliotekës së FEAs u vu re se biblioteka ofron hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët. Salla e studimit ka një kapacitet 50 vende dhe është e pajisur me kompjutera nga ku studentët mund të aksesojnë librarinë elektronike dhe të kryejnë punë kërkimore individualisht apo në grup. Kapaciteti i stafit të bibliotekës është i tillë që përballon nevojat e studentëve për shërbim, apo edhe shfrytëzim të mjediseve për punë në grup apo prezantime. Biblioteka frekuentohet çdo muaj nga studentët. Orari i shfrytëzimit të bibliotekës është i përshtatshëm për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimit, i cili është plotësisht i mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të studentëve të programit të studimit.</p> <p><i>(Plani Strategjik i Bibliotekës: Biblioteka &amp; Biblioteka online TEEAL)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">✓</p>

<p><b>Standardi IV.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një një sistem të të menaxhimit të brendshëm në të cilin regjistrohet dhe arkivohet i gjithë informacioni në lidhje me studentët nga momenti i regjistrimit deri në çertifikimin përfundimtar, pajisja me diplomën sipas ciklit përkatës.</p> <p>Ky sistem është konceptuar të funksionojë në dy drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Informacion i regjistruar dhe ruajtur në mënyrë elektronike;</li> <li>- Informacion i regjistruar dhe ruajtur në mënyrë fizike.</li> </ul>



	<p>Zyra e cila kujdeset në menaxhimin e një procesi të tillë është Zyra e Studimeve dhe Studentëve (ZSS) dhe kryen veprimtarinë e mëposhtme (<i>Rregullore e ZSS - Kreu V, pika 1,2&amp;3</i>):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistrimi i studentëve dhe mbajtja e bazës së të dhënave dhe rezultatet e tyre, në formë shkresore dhe elektronike;</li> <li>• Plotësimi i të gjithë dokumenteve individuale çertifikues mbi rezultatet e pjesshme ose të plota të studimeve;</li> <li>• Mbajtja e dokumentacionit mbi procesin mësimor dhe ndjekja e ecurisë së procesit mësimor; Mban informacion lidhur me studimet (planet mësimore, strukturat e vitit akademik etj.) për të gjitha drejtimet e diplomimit në të tre ciklet e studimeve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në Universitet (<i>Rregullore e ZSS - Kreu VI.1.1</i>).</li> </ul> <p>Kjo zyrë menaxhon edhe dokumentacioni themelor për studentët në përputhje me ligjin në fuqi, cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistri themeltar i studentit i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër unik matriculimi deri në marrjen e diplomës ose certificate, i cili pasqyrohet në këtë regjistër.</li> <li>• Regjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e arritura të tij gjatë aktivitetit akademik sipas programeve të studimit.</li> <li>• Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave që vërteton emetimin e çertifikatave dhe diplomave.</li> </ul> <p>Këto 3 regjistra ruhen, pas diplomimit, në arkivën e Shtetit Shqiptar, ndërsa në arkivën e UBT-së, si kopje e njësuar me origjinalin në hardcopy dhe elektronike, ruhen për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së Institucionit.</p> <p><i>( Statuti i UBT- Neni 67 dhe 68; Rregullore e DDA- Neni 95)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në përputhje me statutin e UBT-së dhe rregulloren e DDA informacioni në lidhje me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe partner të angazhuar, ruhet në formë elektronike dhe në hardcopy në disa njësi të UBT-së: (1) Departamenti i DDA, (2) FEA, (3) UBT, (4) Zyra e Personelit dhe Pagave, dhe (5) Zyra e Financës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informacioni që ruhet për stafin akademik, ndihmës-akademik dhe të angazhuar dokumentohet përmes Cv-së, planeve mësimore, syllabuseve, ngarkesës akademike, ngarkesës për kontributin institucional dhe ngarkesës</li> </ul>

	<p>intelektuale. Këto dokumente ruhen në departament dhe bëhen pjesë integrale e analizës mësimore dhe shkencore të departamentit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza mësimore dhe shkencore duke qënë se përcillet në Fakultet dhe Rektorat, bëhet pjesë e të dhënave të përgjithshme të institucionit.</li> <li>• Dokumentacioni për pedagogët e ftuar të programit ruhet në departament, fakultet, në zyrën e personelit dhe pagave si dhe në zyrën e financës.</li> <li>• Informacioni rreth dosjes së stafit akademik, ndihmës-akademik, administrativ dhe të angazhuar gjendet në një format tip në zyrën e personelit dhe pagave dhe përditësohet sa herë ka ndryshime të titujve, gradave apo pozicioneve (<i>Rregullore e Drejtorise se MBNJ dhe pagave - Neni 4</i>).</li> <li>• Informacioni i dokumentuar për stafin akademik, ndihmës-akademik, administrativ dhe të angazhuar ruhet edhe në zyrat e financës dhe buxhetit përmes përcaktimit të kategorisë së punonjësve, raportit për ngarkesën mësimore dhe gjithë dokumentacioni për pagat, pagesat, honoraret dhe shpërblimet. Ky dokumentacion i bëhet transparent edhe vetë punonjësve.</li> </ul> <p>Informacioni në lidhje me veprimtarinë e personelit akademik ruhet në portalin e UBT-së nëpërmjet accounteve personale të tyre. Informacion që ka karakter informues për publikun e gjerë apo sistemin ESSE3, ku mund të ruhet dhe analizohet marrëdhënia e stafit me studentin në terma të vlerësimit për lëndët ku pedagogu është kordinator (<i>Pamje nga web i pedagogut</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit krijon akses për personelin dhe studentët përmes formave të ndryshme.</p> <p>Raportet e analizës mësimore dhe shkencore në nivel departamenti, diskutohen dhe miratohen në mbledhje departamenti duke krijuar mundësinë që çdo anëtar i programit të studimit të ketë mundësi të marrë informacion.</p> <p>Informacionin në lidhje me aktivitetin e personelit të programit bëhet publik në websitet personale të personelit, web, stenda siguron informacion për publikun.</p> <p>Shpërndarja e informacionit që lidhet me mbarëvajtjen e procesit mësimor dokumentohet në stenda dhe web-in e Unversitetit me seksion të veçantë për fakultetin, departamentin apo edhe programin e studimit. Ky informacion lidhet me strukturën e vitit</p>



	<p>akademik, orarin mësimor, kurrikulën e programit, prioritet e kërkimit dhe fushat e ekspertizës, mundësitë e punësimit, kompetencat e stafit dhe studentëve etj.</p> <p><b>(Struktura e Web-it UBT)</b></p> <p>Informacion me karakter didaktik gjendet edhe në portalin e UBT-së në websitet e pedagogëve për të mundësuar marrjen e informacion nga të interesuarit në distancë (<a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/</a>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit ka integruar sistemin ESSE3 për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi në Universitet, jeta unversitare deri në mbrojtjen e diplomës. Studenti mund të monitorojë studimet e tij përmes një kodi unik identifikimi, që e shoqëron atë në gjithë eksperiencën e tij në Universitet. Përmes këtij sistemi studenti merr në kohë reale informacion në lidhje me të dhënat e regjistrimeve, lëndët, për të drejtën për të hyrë ose jo në provim, prenotimin e provimit, grafikun e provimeve online, vlerësimin e bërë nga pedagogu gjatë semestrit, vlerësimin në provim dhe notën përfundimtare notat, etj.</p> <p>Në lidhje me hapjen e grafikut për provime në këtë sistem, për sezonet e rregullta ky proces bëhet automatikisht nga sekretaret përkatëse të programit të studimit. Në sezonet e vjeshtës ku proces bëhet nëpërmjet prenotimit nga vet studentit në këtë sistem.</p> <p><b>(Manual regjistrimi studentet Esse3)</b> <b>(Udhëzues për zhvillimin e metodave inovative)</b></p> <p>Personeli akademik i departamentit shfrytëzon hapësirën personale në portalin e UBT-së (<a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/home">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/home</a>) për të komunikuar në mënyrë sa më eficiente me studentët në lidhje me procesin mësimor-kërkimor.</p> <p>Secili anëtar i personelit akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi komunikon me studentët e kursit në lidhje me informacione për leksionet e moduleve përkatëse, rastet studimore, detyrat e kursit si dhe e materialeve të tjera. Në këtë hapësirë të përbashkët studentët kanë akses në leksionet e modulit, syllabusin e tij, strukturën e modulit si edhe mënyrën e administrimit të tij përgjatë semestrit. Ata gjithashtu marrin në këtë hapësirë edhe informacion në lidhje me vlerësimin gjatë vitit.</p> <p>Website i UBT-së, me seksione të veçanta për DDA, siguron informacion të rëndësishëm për karakteristikat e programit</p>

	<a href="http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/departamentidrejtin-agrobiznesi/">(http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/departamentidrejtin-agrobiznesi/)</a> .			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Mbledhja dhe monitorimi i informacionit bëhet nga një ekip i përbërë nga drejtuesi i departamentit të DDA, drejtuesit e grupeve mësimore-kërkimore dhe sekretari i departamentit, të cilët monitorojnë informacionin në lidhje me aktivitetin akademik të stafit duke filluar me raportimin për respektimin e orarit mësimor, ngarkesës mësimore, etikës në komunikim, dokumentacionit duke hartuar cdo vit një përmbledhje të ngarkesës mësimore, akademike dhe asaj të kontributit institucional për cdo anëtar të stafit të programit. Raportet e monitorimit dhe vlerësimit përcillen në fakultet. Nga ana tjetër sistemi mund të vlerësojë në kohë reale ndërhyrjet në sistem si edhe nëse ka parregullsi apo mungesë të gjenerimit të informacionit nga ana e stafit akademik. Ky informacion vlerësohet dhe raportohet në organet drejtuese që më pas mund të vlerësojë dhe të ndërmarrë masa ndërhyrës për përmirësimin e situatës së konstatuar.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Informacioni në lidhje me programin e studimit në faqen e web-it gjendet në dy gjuhë në gjuhën shqipe dhe angleze. Faqja në gjuhën angleze është në ndërtim për t'u përputhur me dizajnimin e ri të faqes së universitetit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓



<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UBT harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare, ku si pjesë integrale është edhe raporti financiar që harton Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Procesi i financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.



<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Raporti financiar i hartuar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në UBT detajon dhe konkludon koston për student për ciklet e studimit Bachelor, Master professional dhe Master i Shkencave. Plani financiar detajon kostot për të gjithë zërat në shërbim të realizimit të programit që nga shërbimet operative, kostot e burimeve njerëzore, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, shpenzimet për bibliotekën etj.</p> <p><i>(Kosto mesatare e nje studenti &amp; Raporti Financiar i Vitit 2017)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Insitucioni auditohet çdo vit, në mënyrë të rregullt, nga grupi i ekspertëve të auditit të brendshëm të tij.</p> <p>Burimet potenciale të financimit janë tre:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• financim nga buxheti i shtetit</li> <li>• financim nga tarifat e studentëve si edhe</li> <li>• financim nga shërbimet që UBT ofron për aktorë të tretë.</li> </ul> <p>Për të siguruar transparencën e mbledhjes dhe përdorimit të fondeve, UBT bën publike pasqyrën financiare të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe nga burimet e tjera të financimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Insitucioni harton gjithashtu edhe raportin e analizës financiare për tre vitet e kaluara për të evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si edhe nivelin e realizimit të shpenzimeve. Ky dokument shërben për të identifikuar nevojat për financim të planifikuara, si rrjedhojë, ndërhyrjet e posaçme dhe të nevojshme. Këto ndërhyrje mundësojnë rritjen e efektivitetit të përdorimit të parave si dhe garantimin e ecurisë dhe mbarëvajtjes së programit të studimit.</p> <p>Relacioni mbi projekt buxhetin afatmesëm dhe afatgjatë hartohet në mënyrë periodike nga njësitë përgjegjëse të UBT (Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e mbështetur nga personeli i drejtorive të tjera ndihmëse) dhe ka si qëllim kryesor të kontrollojë mbarëvajtjen e programeve të studimit të të gjitha cikleve përgjatë kohës së shtrirjes</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>së tyre. Ai përcakton edhe objektivat dhe investimet e nevojshme për afatin e mesëm që synojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në të gjitha programet e studimit. Gjithashtu në relacionin afatmesëm të projekt buxhetit planifikohen edhe rrugët e financimit të investimeve duke identifikuar burimet e mundshme të gjenerimit të të ardhurave.</p> <p><i>(Te dhena nga raporti financiar 2016-2017-2018 &amp; Relacion Projekt Buxheti 2017-2019)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UBT ka hartuar dhe vënë në zbatim politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë ciklin dytë studimeve universitare, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto politika janë përcaktuar në rregulloren e studimeve universitare të DDA).</p> <p>Programi i studimit ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe analitike (<i>Rregullores e Brendshme e DDA-s - Rregullore e programit të studimeve</i>) të nevojshme për zgjidhjen e problematikave komplekse në këtë fushë.</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve përcaktohen nga MASR ( udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës), statuti dhe rregullorja e studimeve të DDA, FEA-s dhe UBT-së (<i>Rregullore e Brendshme e DDA-; Rregullore e programit të studimeve</i>).</p> <p>Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit është 2 vite akademike.</p> <p>Numri total i krediteve që duhet të grumbullojë një student për finalizimin e këtij cikli studimi është 120 ECTS. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e saj.</p> <p>Studentët e këtij programi studimi diplomohen me punim diplome. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja e DDA përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të studimeve, apo transferimit të tyre gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit. Këto politika sigurojnë informim për kriteret, procedurat dhe afatet e aplikimit (duke përfshirë këtu edhe tarifatat përkatëse të programit), transferimit dhe përfundimit të studimeve.</p> <p><i>(Rregullore e DDA)</i></p>

	<i>( Rregullore e Programit te Studimit)</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret e pranimit dhe vazhdimësisë të studimeve, transferimit nga një program studimi në një tjetër, njohjes së studimeve të kryera në një program tjetër (i plotë ose i pjesëshëm apo edhe i realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit Erasmus, por jo vetëm) përcaktohen qartë në rregulloren e departamentit dhe atë të programit të studimit ( <i>Rregullore e DDA; Rregullore e Programit te Studimit</i> ). Ky informacion bëhet publik nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit në seksionin përkatës të departamentit të Drejtimit të Agrobiznesit ( <a href="http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/departamenti-drejtim-agrobiznesi/">http:// ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/departamenti-drejtim-agrobiznesi/</a> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Kriteret e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë të studimeve në DDA-së përcaktohen nga MASR (udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MASR për vitin akademik përkatës), statuti dhe rregullorja e studimeve të DDA, FEA-s dhe UBT-së ( <i>Rregullore e Brendshme e DDA; Rregullore e programit të studimeve</i> ).			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit komunikon me publikun e interesuar për ndjekjen e programit përmes disa mënyrave si psh. Informacioni përditësohet në faqen web të Fakultetit dhe seksionit përkatës të Departamentit në lidhje me përmbajtjen, karakteristikat e këtij programi studimi për aplikantët e interesuar etj			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit	Informacioni i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin paraqitet qartë në Rregulloren e DDA si dhe atë të programit të studimeve.

<p>akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Informacioni në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme paraqitet qartë në Rregulloren e DDA dhe në atë të programit të studimit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Për të gjithë studentët që kërkojnë të transferojnë studimet, DDA bën të mundur ekuivalentimin e një pjese të programeve sipas përcaktimeve në Statutin e UBT.</li> <li>2.Periodha dhe procedurat për transferimin e studimeve realizohen në fillimi të vitit akademikë në përputhje me aktet nënligjore të MASR).</li> <li>3.Studenti që është i interesuar të transferojë studimet në DDA paraqet një kërkesë pranë ZSS të UBT-së dhe dokumentacionin përkatës të nevojshëm. ZSS kryen verifikimet mbi legjitimitetin e institucionit të arsimit të lartë nga vjen studenti, nivelin e programit të studimit që ka ndjekur student si dhe origjinalitetin e dokumentave të paraqitur. Më pas, zyra përcjell në fakultetet përkatëse kërkesat e grumbulluara dhe dokumentacionin e verifikuar .</li> <li>4.Pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, me urdhër të Dekanit të Fakultetit, ngrihen dhe funksionojnë komisione <i>ad hoc</i> të Njohjes dhe Ekuivalentimit të Studimeve. Komisionet përbëhen nga tre antarë: Zv. Dekani për mësimin dhe kurikulat, përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i grupit mësimor, në varësi të programit të studimit dhe programit të modulit që kërkohet të ekuivalentohet. Zv. Dekani për mësimin dhe kurikulat është kryetar komisioni. Vendimi përfundimtar i ekuivalentimit (njohjes) të programeve të studimit firmoset prej tij dhe Dekanit të Fakultetit.</li> <li>5.Një modul ekuivalentohet) kur ka emërtim të njëjtë/të ngjashëm, apo që në përmbajtjen e tyre, trajtojnë tema mësimore të njëjta dhe ka një përputhje të përmbajtjes së saj dhe të ngarkesës në auditor, në masën mbi 80 % me modulën që zhvillohet në programin e studimeve të DDA-s.</li> <li>6.Komisioni bën ekuivalentimin e moduleve që ka dhënë studenti me modulën respektivë të programit të studimit, duke patur parasysh kreditet e modulit, programin e modulit, siç përshkruhet më sipër, si dhe notën e marrë.</li> </ol>

	<p>7.Në funksion të numrit të krediteve të njohura, dekani i fakultetit përcakton vitin ku do të regjistrohet studenti në përputhje me nenet e kësaj rregulloreje.</p> <p>Më pas ky proces bëhet transparent përmes faqes se webit duke specifikuar detaje që janë në funksion të transparencës së rankimit të studentëve apo njohjes ose jo të moduleve të caktuara.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit në këtë mënyrë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nëpërmjet Rregullores së DDA dhe Rregullores së programit të studimit departamenti informon qartësisht studentët mbi procedurat dhe kriteret për vlerësimin e dijeve në lëndë të ndryshme të programit të studimit, duke përfshirë këtu: (1) sistemin e vlerësimit, (2) format e vlerësimit, (3) format e kontrollit të dijeve, (4) kushtet për hyrjen në provim, (5) sezonet e provimeve, (6) organizimin e tyre e (7) komisionet e provimit, (8) zhvillimin e provimit, (9) shpalljen e rezultateve të provimit, (10) ankimimi dhe (11) përmirësimi i notës.</li> <li>2. Format e kontrollit të dijeve edhe pse gjendet në rregulloret e FEA, DDA dhe në atë të programit të studimit, i bëhet me dije studentit në javën e parë të fillimit të mësimin nga pedagogu/pedagogët përgjegjës i/të lëndës përkatëse.</li> </ol> <p>Studenti informohet edhe në distancë përmes websiteve personale të pedagogeve në lidhje me elementët e mësimin dhe vlerësimit të tij, nëpërmjet syllabusit apo planit kalendar që plotësohet në fillim të semestrit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti informon studentët përmes stendave të tij, faqes së internetit, apo edhe takime me studentët për kriteret që kërkohet të plotësohen për procedurat e punimit të diplomës. Kriteret janë publike në çdo kohë por intensifikohet komunikimi në mes të semestrit të parë të vitit të dytë.</li> <li>2. Departamenti përcakton kriteret dhe standartet e përgatitjes së një punimi diplome për nivelin Bachelor . Kriteret janë publike në çdo kohë por intensifikohet komunikimi në semestrat e fundit.</li> <li>3. Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti Drejtim Agrobiznesi. Në përfundim të semestrit të tretë, studenti plotëson një formular tip, ku specifikohet emri i studentit,</li> </ol>



	<p>fusha e studimit të kërkuar, propozimi për profesorin udhëheqës pasi është marrë edhe aprovimi i tij. Ky dokument dorëzohet në department, ku ky i fundit organizon një mbledhje për miratimin e temave dhe propozimeve të studentëve.</p> <p>4. Departamenti harton listën e studentëve dhe udhëheqësin shkencor të cilat miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit të DDA-s.</p> <p>5. Departamenti publikon informacion në lidhje me mënyrën e përpunimit të tezës me të gjithë studentët e vitit të fundit.</p> <p><b>(Rregullores se FEA-s- Rregullore e Brendshme e DDA – Rregullore e Programit të Studimi)</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Departamenti i DDA realizon një proces komunikimi transparent dhe periodik në lidhje me këtë program studimi nëpërmjet</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Një udhëzuesi në formën e një dokumenti elektronik .</li> <li>2. Organizimi i takimeve mbi programet e studimit përkatëse në UBT/FEA/DDA duke përdorur materiale promovuese të ndryshme.</li> </ol>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<p><b>Standardi V.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>DDA informon studentët në mënyrë të hollësishme në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nëpërmjet neneve përkatëse në Rregulloren e DDA dhe Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Ky informacion vendoset në dispozicion të studentëve në websitin e Fakultetit në seksionin e departamentit (<a href="http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/">http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/</a>). Informacioni në web në lidhje me organizimin dhe programet që ofron departamenti krijon mundësinë për të marrë informacionin e duhur në lidhje me organizimin e plotë të studimeve të këtij programi.</p>

	<p>Në fillim të çdo viti akademik, bëhet i mundur informimi në lidhje me strukturën e vitit akademik në të cilën detajohet kohëzgjatja e vitit akademik, ndarja e tij në semestra si dhe periudha e provimeve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj. Ky informacion vjen tek student në disa forma:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në hard-copy me anë të guidave, rregulloreve të posaçme, fletëpalosjeve, procedurave, etj., të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve të programeve përkatëse;</li> <li>2. Në formë elektronike në websit-n e universitetit, në seksionin përkatës të DDA, të i cili është i aksesueshëm nga të gjithë studentët si në mjediset e FEA dhe jashtë saj. Këtu mund të gjenden për programin e studimit, rregullorja e programit, kurrikula e plotë me informacionin e nevojshëm për lëndët, ndarjet e tyre në semestra, kreditet. Nga ana tjetër, personeli akademik i departamentit shfrytëzon hapësirën personale në portalin e UBT-së (<a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemenager/home">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemenager/home</a>) për të komunikuar në mënyrë sa më efikente me studentët në lidhje me informacione për leksionet e moduleve përkatëse, rastet studimore, detyrat e kursit si dhe e materialeve të tjera. Në këtë hapësirë të përbashkët studentët kanë akses në leksionet e modulit, syllabusin e tij, strukturën e modulit si edhe mënyrën e administrimit të tij përgjatë semestrit. Ata gjithashtu marrin në këtë hapësirë edhe informacion në lidhje me vlerësimin gjatë vitit (<i>Pamje nga web i pedagogut</i>).</li> <li>3. Informacioni i shpallur në stenda në mjediset e përcaktuara të FEA-s dhe DDA-së, ku përfshihet kurrikula e plotë me informacionin e nevojshëm për lëndët, ndarjet e tyre në semestra, kreditet, orari i mësimit, njoftime të ndryshme, pjesë të rëndësishme të rregullores, rezultatet e kontroleve, etj. Kështu në stendat dhe web e departamentit</li> </ol> <p>Vendimet e rëndësishme të marra nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Këshillat e fakulteteve dhe Dekanati në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, të studentëve, rezultatet e analizave të bëra, rezultatet e anketimit etj, u bëhen me dije studentëve në forma të ndryshme si (a) takime të drejtpërdrejta me studentët, (b) shpallje në mjediset e caktuara të</p>





	<p>universitetit,(c)njoftimevenë“website”(http://ubt.edu.al/sq/njoftimet/), etj.</p> <p><b>(Rregullore e FEAs)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Për t'i dhënë mundësi studentëve për të kryer praktika profesionale, intership apo dhe mundësi punësimi, Qendra e Karrierës dhe Alumni, përgjatë panairëve të karrierës që ka organizuar në UBT, ka nënshkruar 43 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (sipërmarrje, institucione publike, OJF).</p> <p><b>(Institucionet bashkëpunuese për praktikën profesionale)</b></p> <p>Nga biseda e realizuar me Z. Domi, Koordinator i QKA, u informuam se më datë 15 Maj 2019 Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), organizoi për të gjashtin vit radhazi Panairin e Karrierës pranë mjediseve të kampusit universitar. Ky panair shënon një event të rëndësishëm për UBT, sepse shërben si urë lidhëse ndërmjet sipërmarrjeve, institucioneve publike, organizatave të ndryshme pjesëmarrëse dhe studentëve për të krijuar mundësi punësimi, praktikë profesionale apo intership. Këtë vit, morën pjesë 46 sipërmarrje dhe organizata të profileve të ndryshme të cilat me anë të standave përkatëse, ofruan mundësi punësimi dhe praktika profesionale për rreth 536 studentë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët kanë mundësi të aksesojnë informacion të plotë në lidhje me organizimin e mësimit përmes orarit të afishuar në stendat e godinës së Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Ky orar bëhet i aksesueshëm edhe përmes website të Fakultetit ( <a href="http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/orari-i-mesimit-fea-sem-i-2018-2019/">http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/orari-i-mesimit-fea-sem-i-2018-2019/</a> ).</p> <p>Sinjalistika e qartë që fillon që në hyrje të universitetit, e bën të thjeshtë aksesimin e sallave dhe laboratorëve për studentët e UBT. Zyra e studimeve dhe studentëve (ZSS) krijojnë mundësinë që studentit të informohet në mënyrë profesionale në lidhje me problematikat që hasin gjatë procesit mësimor. Siç përmendet edhe më sipër në standardin IV.5.1&amp;4 kjo zyrë ofron në mënyrë të centralizuar një seri shërbimesh për studentët në lidhje me procesin mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Siç është shpjeguar në standardin IV.5.1&amp;4, Institucioni disponon një sistem të të menaxhimit të brendshëm në të cilin regjistrohet dhe arkivohet i gjithë informacioni në lidhje me studentët nga momenti i regjistrimit deri në çertifikimin përfundimtar, pajisja me diplomën sipas ciklit përkatës. Ky sistem menaxhimi ka integruar sistemin ESSE3 për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve nga aplikimi në Universitet, jeta unversitare deri në mbrojtjen e diplomës. Informacioni në lidhje me procesin mësimor bëhet lehtësisht i aksesueshëm përmes këtij ( <b>Manual regjistrimi</b> ).</p>

<b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Sistemi ESSE3 i mundëson studentit të marrë informacion të nevojshëm edhe në distancë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Në analizën mësimore që DDA përgatit çdo vit, gjejmë të pasqyruara statistikat vjetore në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në programet përkatëse, që kanë ndërprerë studimet, të diplomuar në programin e studimeve bachelor si dhe informacion mbi ecurinë e studentëve në këtë program studimi. Ky informacion regjistrohet dhe ruhet në departament së bashku me shumë të dhëna të tjera në lidhje me studentët.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Të dhënat statistikore e përmendura më sipër mund të gjenerohen në çdo kohë për cdo vit akademik nga sistemi ESSE3. <i>(Analiza e punës mesimore DDA 2018).</i> Departamenti është në gjendje në cdo kohë të analizojë të dhënat e studentëve nëpërmjet regjistrimit “hardcopy” që mban sekretaria mësimore si edhe të analizojë të dhënat e gjeneruara nga sistemi ESSE3. <i>(Nota mesatare e pranimeve 2016-2017)</i> <i>(Nota mesatare e pranimeve 2017-2018)</i> <i>(nota mesatare e pranimeve 2018-2019)</i> <i>(Studente të çregjistruar që nga 2014 -2019)</i> <i>(Studente të ardhur me transferim 2014-2019)</i> <i>(Studentet e diplomuar 2013-2018)</i> <i>(Statistika për studentet e regjistruar 2014-2019)</i> <i>(Mesataret e studenteve në përfundim të studimeve 2014-2018)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit	Nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit, Institucioni ruan të dhënat personale të studentëve. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve

<p>të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>kryhen, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e brendshme të universitetit (<i>Rregullore e FEAs, Neni 101</i>). I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm të informacionit në formë hardcopy dhe elektronike. Ky informacion është konfidencial dhe mund të aksesohet vetëm përmes një kërkesë me shkrim apo zotërimit të një account-i nga studenti. Ky i fundit, përmes numrit të matrikullimit, ka akses vetëm për të vëzhguar ecurinë e tij në sistem dhe të marrë të dhëna për këtë.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Departamenti mundëson raportin vjetor të analizës mësimore që nënkupton një vlerësim të punës së departamentit në tërësi dhe programeve në veçanti. Ky raport analizon gjendjen aktuale të programit duke iu përgjigjur disa prej problematikave që mund të jenë shfaqur dhe propozon ndryshimet e mundshme që mund të përmirësojnë situatën. Ky raport i shpërndahet anëtarëve të departamentit. Pas reflektimit, organizohet një mbledhje në të cilën anëtarët propozojnë idetë, mendimet e tyre duke e plotësuar edhe me shumë raportin dhe në fund ai miratohet. Raporti kalon në dekanat ku i bashkangjitet materialit të plotë të analizës për të gjithë Fakultetin. Në të njëjtën mënyrë raporti bëhet publik për anëtarët e dekanatit, organizohet një mbledhje për përmirësimin e tij dhe më pas miratohet në formën e një dokumenti të plotë. Më pas dokumenti i miratuar përcillet në rektorat. <i>(Analiza e punes mesimore DDA 2018)</i> <i>(Raporti i UBT 2017-2018)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p><b>Standardi V.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet</p>	<p>Institucioni parashikon në fillim të procesit të organizimit të zgjedhjeve në universitet, të përfshijë studentët në mënyrë thelbësore në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Studentët kanë përfaqësinë e tyre në Senat akademik, Komisioni i cilësisë dhe</p>

<p>vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>i kurrikulave si dhe në Komisionin e etikës me një mandat për një periudhë kohore 2 vjeçare (<i>Statuti UBT, Neni 64</i>). Gjatë kohës së realizimit të vizitës nga ekspertët e jashtëm në IAL, mësuam se FEA kishte përfunduar procesin zgjedhor për përzgjedhjen e studentëve që do të përfshihen në këto komisione për një periudhë 2 vjeçare. Gjatë këtij procesi studentët kanë patur mbështetjen e personelit dhe infrastrukturës së fakultetit për të organizuar mbledhjet e hapura apo shpalosur angazhimin e tyre</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Për një periudhë 2 vjeçare janë organizuar 4 mbledhje (3 mbledhje të komisionit të etikës dhe 1 mbledhje e komisionit të cilësisë dhe kurrikulave). Mbledhjet e komisioneve janë realizuar me një proces transparent duke i njoftuar përfaqësuesit e studentëve përmes kontakteve që kanë depozituar në fakultet (si psh. adresa e emailit apo numri i telefonit). <i>(Vendim KIZ per perfshirjen e studenteve)</i> <i>(Vendim komisioni i cilesise)</i> Studentët gjithashtu organizohen në Këshillat studentore, ku shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për problematika të ndryshme duke përfshirë këtu edhe çështje të planeve dhe programeve të studimeve apo të procesit mësimor.. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në institucionet e arsimit të lartë. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi (<i>Doc. - Statuti i UBT – Neni 65</i>). Nga takimi i realizuar me studentët mësuam se ata janë në dijeni të këtyre strukturave dhe të funksionimit të tyre, si dhe i mbështesin ato. Megjithatë, nga takimi i realizuar me përfaqësuesit e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, mësuam se më pak aktiv ka qënë komisioni i cilësisë dhe i kurrikulave ( 1 takim i realizuar ) në këto 2 vite. Gjithashtu mësuam se shfrytëzohet më shumë opinioni i studentëve që merret nga anketat e realizuara se nga perfaqesitë e tyre në komisionet përkatëse duke qënë se nuk kanë qënë shumë aktiv.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave</p>	<p>Programi i studimit është organizuar duke marrë në konsideratë aftësinë e studentëve për të përvetësuar në mënyrë sa më të përshtatshme njohuritë dhe duke përzgjedhur një kurrikul bashkëkohore. Në vlerësimin e ngarkesës akademike të studentit janë mbajtur në konsideratë si marrja e informacionit teorik edhe atij praktik përmes detyra dhe projekteve të kursit. Vlerësimi i studentit</p>



<p>joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>realizohet në mënyrë të shpërndarë gjatë semestrit kryesisht në raportin 60:40, 70:30 ose 80:20. Respektivisht 60, 70, 80 e vlerësimit përfitohet nga provimi përfundimtar dhe pjesa e mbetur e pikeve, 40, 30, 20% e vlerësimit përfitohet nga provimet e ndërmjetme, detyrat apo projektet e kursit dhe angazhimi aktiv në orët e seminareve. Kjo formë vlerësimi inkurajon angazhimin e plotë të studentëve gjatë gjithë kursit, por gjithashtu i parapërgatit ata për sezonin e provimeve ku mjafton vetëm një përsëritje e asaj çfarë kanë mësuar gjatë semestrit. Ky fakt na u pohua edhe nga studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Departamenti është bashkëpunues me studentët për të lehtësuar praktikat dhe procedurat e njohjes së plotë apo të pjesëshme të lëndëve që studentët mund të kenë realizuar në programe të mëparshme. Siç është përmendur edhe në standardin V.2.2, procedura është e thjeshtë, fillon me paraqitjen e kërkesës së studentit pranë ZSS duke paraqitur dokumentacionin përkatës, i cili kalon në procesin e vërtetimit të origjinalitetit dhe më pas kalohet tek instancat përkatëse që kryejnë procedurën e vlerësimit të përputhshmërisë së programeve duke konkluduar me një vendim. Në rastin kur kërkesa e studentëve vjen për lëndë që zhvillohen brenda Universitete studentit paraqet vetëm kërkesën për njohje të lëndës dhe vlerësimi i përputhshmërisë së programeve realizohet nga fakulteti. <b>(Rregullore e studimeve universitare).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Strukturat drejtuese të Universitetit gjatë tre viteve të fundit kanë ndërmarrë një iniciativë llogaridhënie para asamblesë akademike të institucionit për çështje që kanë të bëjnë më të gjithë veprimtarinë e UBT ku një vend të rëndësishëm zë edhe llogaridhënia dhe diskutimi për cilësinë e programeve të studimit. Gjatë këtij procesi përfshihen edhe studentët sepse ftohen të marrin pjesë në këtë diskutim. Procesi përfshin vijimësinë e procesit mësimor si edhe problematikat e vërejtura gjatë viteve paraardhëse akademike, masat e marra gjatë viti të fundit akademik dhe impakti i tyre. Më tej vazhdohet me planin e ndërhyrjeve për vitin e ardhshëm akademik</p> <p>Një kontribut tjetër në këtë kontekst janë rezultatet e marra nga anketimi i realizuar me studentët. Anketat e realizuara në (a) hard-copy ku merret një opinion më specifik në lidhje me modulën dhe pedagogun përkatës dhe (b) online, ku studentëve i kërkohet informacion më i përgjithshëm mbi procesin mësimor dhe çështje të tjera. Siç është shpjeguar edhe në kategoritë e mësipërme ky proces ndodh 2 herë në vit, përpara sezonit të provimeve, për të evituar ndikimin apo deformimin e vlerësimit. Pasi përpunohen të dhënat dhe nxirret rezultati, grupi i posaçëm i punës përgatit një raport, të</p>

	<p>cilin e vendos në dispozicion të departamenteve përkatëse. Rezultatet e këtij pyetësi janë pjesë e analizën vjetore të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p> <p>Një kontribut i rëndësishëm do të ishte dhe mendimi i Alumnit, të diplomuarve në këtë program studimi, të cilët tashmë janë pjesë e tregut të punës dhe njohin më nga afër problematikat dhe kërkesat e tregut në lidhje me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme të studentëve potencial i ardhshëm për punësim.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Nëpërmjet Rregullores së DDA dhe Rregullores së programit të studimit departamenti informon qartësisht studentët mbi procedurat dhe kriteret për vlerësimin e dijeve në lëndë të ndryshme të programit të studimit, duke përfshirë këtu: (1) sistemin e vlerësimit, (2) format e vlerësimit, (3) format e kontrollit të dijeve, (4) kushtet për hyrjen në provim, (5) sezonet e provimeve, (6) organizimin e tyre e (7) komisionet e provimit, (8) zhvillimin e provimit, (9) shpalljen e rezultateve të provimit, (10) ankimimi dhe (11) përmirësimi i notës.</p> <p>Studentët, në seksionet përkatëse të anketave (në hard-copy dhe online) që realizohen nga Institucioni mund të japin mendimin e tyre në lidhje me kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, duke përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit në të. Gjithashtu në takimin e realizuar me studentët, mësuam se pedagogët janë të hapur dhe bashkëpunues për të diskutuar me studentin në rast se do të ngriheshin pretendime për rishikimin e vlerësimit. Studentët rezultojnë të kënaqur në lidhje me këtë aspekt dhe nuk kishin hasur situatë të pakëndshme.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>✓</p>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Pedagogët e Departamentit që mbulon programin e studimit janë mjaft të angazhuar në:</p> <p>1 – Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>2 – Publikime në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>3 – Pjesëmarrje në Konferenca Shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Disa punime janë edhe në revista të mirënjohura me faktor impakti.</p> <p>Rezultatet e punimeve të kërkimit shkencor shpesh diskutohen në mbledhje Departamenti etj. Por nuk mund të thuhet që ka shumë politika specifike të motivimit të punës kërkimore – shkencore.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Ndërsa për studentët kjo realizohet kryesisht në disa lëndë ku ata angazhohen në projekte të ndryshme kërkimore të cilat më pas mund ti prezantojnë edhe në kuadrin e detyrave të kursit në lëndët përkatëse Brenda programit mësimor. Apo ti vazhdojnë si studime më të thelluara e më të zgjeruara në kuadër të temës së diplomës që përgatitet në semestrin e fundit të vitit të dytë të studimeve të programit Master i Shkencave.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Sa më sipër u konstatuan edhe gjatë takimeve të grupit të vlerësimit të jashtëm me pedagogët e Departamentit që mbulon programin e studimit dhe me studentët e vitit të parë dhe vitit të dytë të këtij programi Master.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>				
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				✓

<p><b>Standardi V.7</b></p>	
<p><b>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë,</p>	<p>Në lidhje me mobilitetet, UBT dhe veçanësisht DDA ka një aktivitet të gjerë. Përveç njoftimeve mbi mundësitë e aplikimit për studentët për të zhvilluar semestra studimi në universitete të</p>


kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	huaja jashtë vendit, inkurajohen dhe këshillohen edhe personalisht studentët mbi këto aplikime.			
<b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Pjesëmarrja e studentëve në punë të ndryshme kërkimore në kuadër të programit të disa lëndëve në vitin e dytë të studimeve por jo vetëm, krijon mundësinë për vijueshmëri dhe përgatitje të tyre për ciklin e tretë të studimeve.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Pedagogët e Departamentit që mbulon programin e studimit janë mjaft të angazhuar në: 1 – Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. 2 – Publikime në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. 3 – Pjesëmarrje në Konferenca Shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Disa punime janë edhe në revista të mirënjohura me faktor impakti. Rezultatet e punimeve të kërkimit shkencor shpesh diskutohen në mbledhje Departamenti etj. Por nuk mund të thuhet që ka shumë politika specifike të motivimit të punës kërkimore – shkencore.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Ndërsa për studentët kjo realizohet kryesisht në disa lëndë ku ata nagazhohen në projekte të ndryshme kërkimore të cilat më pas mund ti prezantojnë edhe në kuadrin e detyrave të kursit në lëndët përkatëse Brenda programit mësimor. Apo ti vazhdojnë si studime më të thelluara e më të zgjeruara në kuadër të temës së diplomës që përgatitet në semestrin e fundit të vitit të dytë të studimeve të programit Master i Shkencave.			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Sa më sipër u konstatuan edhe gjatë takimeve të grupit të vlerësimit të jashtëm me pedagogët e Departamentit që mbulon programin e studimit dhe me studentët e vitit të pare dhe vitit të dytë të këtij programi Master.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi V.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme	Departamenti ofron një sërë mundësish informimi për shërbimet e studentëve të përmbledhura si më poshtë:



<p>në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti ka një sekretari departamenti ku studenti merr asistencën e nevojshme në lidhje me organizimin e mësimit, lajmërimin për aktivitete të ndryshme, diplomimi, problematika në lidhje me procesin mësimor, etj.</li> <li>2. Sekretaria mësimore e cila është një njësi e centralizuar ku studenti mund të marrë një seri shërbimesh, të informohet në lidhje me ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi.</li> <li>3. Së treti, zyra e këshillimit të karrierës, ku studentët mund të marrin informacion në lidhje me trajnimet, praktikat apo ofertat e punësimit.</li> </ol> <p>Procedurat për informimin dhe transparencën në informim janë të përcaktuara në rregulloren e departamentit (<i>Rregullore e DDA, Kreu XIV</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Departamenti ka vënë në dispozicion disa instrumente për informimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve të cilat janë përmendur edhe më sipër në seksionet përkatëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sekretaria e departamentit është një njësi e vendosur pranë departamentit për asistimin e studentëve për problematikën që ata hasin në përditëshmërinë e tyre dhe që krijon mundësi për ti zgjidhur ato.</li> <li>2. Sistemi ESSE3 që përbën një sistem sekretarie online mjaft të domosdoshëm për t'u informuar në lidhje me ecurinë e studentit.</li> </ol> <p>Portalet e pedagogëve (<i>Pamje nga web i pedagogut</i>) përmes së cilëve studentët krijojnë një komunikim të vazhdueshëm për procesin mësimor, pasi në të mund të gjejnë informacione për leksionet e moduleve përkatëse, rastet studimore, detyrat e kursit si dhe e materialeve të tjera. Në këtë hapësirë të përbashkët studentët kanë akses në leksionet e modulit, syllabusin e tij, strukturën e modulit si edhe mënyrën e administrimit të tij përgjatë semestrit. Ata gjithashtu marrin në këtë hapësirë edhe informacion në lidhje me vlerësimin gjatë vitit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me</p>	<p>Në UBT është ngritur dhe funksionon Zyra qendrore e Karrierës dhe Alumni, e cila koordinon punën me 5 zyrat e karriere nga secili fakultet. Pranë FEA, prej mëse 5 vjetësh është ngritur zyra e Këshillimi të Karrierës për këtë fakultet. Kjo zyrë është e vendosur në godinën e Fakultetit dhe funksionon me orar të plotë për t'u ardhur në ndihmë nevojave të studentëve.</p>

<p>kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Për t'i dhënë mundësi studentëve për të kryer praktika profesionale, intership apo dhe mundësi punësimi, Qendra e Karrierës, përgjatë panairëve të karrierës që ka organizuar në UBT, ka nënshkruar 43 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (sipërmarrje, institucione publike, OJF).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p><b>(Institucionet bashkëpunuese për praktikën profesionale)</b></p> <p>Nga biseda e realizuar me Z. Domi, Koordinator i QKA, u informuam se më datë 15 Maj 2019 Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), organizoi për të gjashtn vit radhazi Panairin e Karrierës pranë mjediseve të kampusit universitar. Ky panair shënon një event të rëndësishëm për UBT, sepse shërben si urë lidhëse ndërmjet sipërmarrjeve, institucioneve publike, organizatave të ndryshme pjesëmarrëse dhe studentëve për të krijuar mundësi punësimi, praktikë profesionale apo intership. Këtë vit, morën pjesë 46 sipërmarrje dhe organizata të profileve të ndryshme të cilat me anë të stendave përkatëse, ofruan mundësi punësimi dhe praktika profesionale për rreth 536 studentë. Një tjetër funksion që realizon zyra qëndrore në bashkëpunim me zyrat e këshillimit të karrierës për fakultet përkatëse është gjurmimi i studentëve të diplomuar ndër vite. Studentët e diplomuar shprehen se profilet e punës që ofron tregu përputhen me njohuritë dhe aftësitë që ofrojnë programet e studimeve në UBT, duke konfirmuar që diploma e UBT është e vlefshme për tregun e punës (<b>Doc. Raport Performanca e QKA, fq. 19</b>)</p> <p>Nga Raporti i performances së QKA rezulton se Bordi i Alumnit si strukture formale është ngritur, por ende nuk ka realizuar asnjë aktivitet sipas parashikimeve të planit të punës apo edhe përshkrimeve në rregulloren e QKA (<b>fq. 19</b>). Një kontribut i rëndësishëm për programin e studimit do të ishte mendimi i këtij bordi duke qënë se ata tashmë janë pjesë e tregut të punës dhe njohin më nga afër problematikën dhe kërkesat e tregut në lidhje me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme të studentëve potencial i ardhshëm për punësim.</p> <p>Megjithatë duke parë rezultatet e mësipërme dhe nga bisedimi i realizuar me përfaqësuesit e kësaj zyre kërkohet një koordinim dhe bashkëpunim më i mirë me departamentin, personelin akademik dhe këto zyra në ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë që mbart kjo zyrë në ndërtimin e karrierës së studentit. Një mundësi e mirë për të patur një impakt të konsiderueshëm në gjurmin e studentëve të diplomuar mund të krijohet</p>





	nëpërmjet Projektit Gradua, i cili do të lejojë mbledhjen e të dhënave lidhur me performancën e tyre; lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) dhe do të krijojë lehtësi në vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit dhe bizneseve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Universiteti Bujqësor i Tiranës mbështet punën tek ndershmëria, kreativiteti, liria akademike, bashkëpunimi dhe shkëmbimi për kërkimet shkencore dhe edukimin ( <i>Doc. no. 37 - Manuali i Cilësisë, fq.4</i> ). Ky Universitet ka përgjegjësinë që ti ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve akademike, hulumtuese dhe shërbimesh duke treguar se janë plotësuar standardet e cilësisë ( <i>Doc. no. 37 - Manuali i Cilësisë, fq.5</i> ). Për të arritur sigurimin e cilësisë, UBT ka zhvilluar politikën e sigurimit të cilësisë duke ngritur një sistemin të menaxhimit të cilësisë në Universitet. Ai përfshin ( <i>Doc. no. 37 - Manuali i Cilësisë, fq.5</i> ):
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ angazhimin e strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë;</li> <li>✓ sigurimin e burimeve që garantojnë dhe përmirësojnë e cilësisë;</li> <li>✓ zhvillimi i programeve të studimit cilësore që plotësojnë nevojat e shoqërisë;</li> </ul>





<p>studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>✓ përcaktimin e procedurave, standardeve dhe metodave që ndihmojnë në monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, por gjithashtu bazuar edhe takimin e realizuar me përfaqësuesit e kësaj strukture konkludohet si më poshtë:</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore (<b>Doc. no. 12–Rregullore e Programit të Studimit – Neni 61, Pika 1 ; Doc.6 - Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 85, Pika 1; Doc. no.5-Rregullores se FEA-s-Neni 91, Pika 1</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori me studentët (<b>Doc. No.28 - Model Pyetësori Studentët</b>) për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi. Për hartimin e këtij pyetësori angazhohet zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila më pas kalon modelin e pyetësorit në instancat përkatëse për të marrë miratimin. Anketa është e thjeshtë, disponohet në hard-copy dhe synon tërheqjen e opinionëve të studentëve lidhur me procesin e mësimin dhe çdo dukuri tjetër që lidhet me të. Ky proces ndodh përpara sezonit të provimeve, për të evituar ndikimin apo deformimin e vlerësimit. Pasi përpunohen të dhënat dhe nxirret rezultati, grupi i posaçëm i punës përgatit një raport, të cilin e vendos në dispozicion të departamenteve përkatëse. Rezultatet e këtij pyetësori janë pjesë e analizën vjetore të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p> <p>Nga takimi i realizuar me zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, mësuam se studentëve, përveç pyetësorit në hard-copy, iu vihet në dispozicion edhe një pyetësor online (<b>Doc.no.106- Anketa institucionale</b>) ku ata mund të japin opinionin e tyre në lidhje me procesin mësimor në përgjithësi. Megjithatë, ky pyetësor nuk është plotësuar në masë nga studentët.</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë i nënshtrohen vlerësimit të parë, vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues (<b>Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 62, Pika 1&amp;2 ; Doc.6-</b></p>

	<p><b><i>Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 86, Pika 1&amp;2; Doc. no.5-Rregullores se FEA-s-Neni 92, Pika 1&amp;2).</i></b></p> <p>Universiteti në fund të çdo viti akademik kryen rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Dekani i Fakultetit, përgjegjës për këtë proces, aktivizon komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregullores së tyre (<b><i>Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 63, Pika 1 ; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 87, Pika 1; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 93, Pika 1).</i></b></p> <p>Realizimi me sukses i procesit të rishikimit kërkon grumbullimin e të dhënave të nevojshme përgjatë vitit akademik. Departamenti organizon procesin e tërheqjes së opinionëve të studentëve në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha modulet (<b><i>Doc. no. 37 - Manuali i Cilësisë Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 63, Pika 2 ; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 87, Pika 2; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 91</i></b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngrre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Në UBT, Sektori i Mësimit, Kurrikulave & Vlerësimit Institucional është përgjegjës për ndjekjen e problemeve që lidhen me mësimin dhe vlerësimin institucional ( <b><i>Doc. No. 56 – Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ 2017, Neni 9 &amp; Doc.no.3 - Statuti i UBT, fq.6</i></b> )
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të	<b>1. Zyra e Mësimit dhe Kurrikulave</b> Kujdeset për menaxhimin e: procesit të rishikimit të kurrikulave të programeve të ndryshme dhe reflektimin e saj në sistemin ESSE3; analizës mësimore; procesin e anketimit nga ana e studentëve; si dhe procesin e kontrollit në auditor për të siguruar mbarëvajtjen e programeve të studimit.

<p>programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Zyra mesimore dhe kurrikulave çdo vit menaxhon <i>procesin e rishikimit të kurrikulave të programeve</i> të ofruara nga të gjitha fakultetet e UBT. Është një procedure normale dhe e njëjtë për çdo cikël studimi, e cila fillon me mbledhjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm të programeve të studimit në lidhje me kurrikulën përkatëse për çdo program. Ky dokumentacion përpara se të kalojë në këtë zyrë kalon në disa nivele: duke përfshirë plotësimin e tyre nga stafi përkatës, më pas kalohet tek GMK përkatëse, verifikohet nga përgjegjësit e departamenteve përkatëse dhe në dekanatet përkatëse. Pasi Zyra mesimore dhe kurrikulave e merr këtë dokumentacion fillon verifikimin e tij, pra verifikon detajet e kurrikulës duke përfshirë këtu ndarjen e moduleve sipas viteve dhe semestrave, ndarjen e krediteve sipas kategorizimit të lëndëve dhe totalin e tyre (120 ECTS në total për Master Shkencor) në përputhje me ligjin në fuqi. Gjithashtu ajo kujdeset edhe për të verifikuar planifikimin e ngarkesës për personelin akademik për vitin e ardhshëm. Pasi bëhet verifikimi, dokumentacioni kalohet për firmë tek Rektori dhe miratohet çdo vit pavarësisht nëse ka apo jo ndryshime në kurrikul.</p> <p>Një tjetër instrument matës për mbarëvajtjen e programit të studimit është menaxhimi i rezultatit të <i>analizës mesimore</i>, process i përvitshëm, nën drejtimin e Zv Rektorit përgjegjës për mësimin. Kjo zyrë pasi merr informacionin, raportet nga fakultetet përkatës, e përpunon atë dhe prodhon produktin që është raporti përfundimtar përmbledhës i analizës mesimore të insitucionit,</p> <p>Procedurë tjetër është edhe <i>përpunimi i anketave</i> të realizuara në (a) hard-copy ku merret një opinion më specifik në lidhje me modulën dhe pedagogun përkatës dhe (b) online, ku studentëve i kërkohet informacion më i përgjithshëm mbi procesin mësimor dhe çështje të tjera.</p> <p>Kjo zyrë kujdeset gjithashtu edhe për procedurën që <i>lidh kurrikulën me sistemin ESSE3</i>. Nëse ka ndryshime të kurrikulës (spostime të moduleve në vite apo semestra), ato duhet të verifikohen dhe më pas të reflektohen me anë të azhurnimit të systemit duke lejuar që studenti të ketë të pasqyruar informacionin e saktë në lidhje me modulet dhe provimet përkatëse.</p> <p>Procedurë tjetër është edhe <i>menaxhimi i web të UBT</i>. Në këtë faqe afishohet i gjithë informacioni i përmendur më sipër duke filluar nga kurrikula, orari, rezultatet e anketimit dhe deri tek vendimet dhe urdhëresat e Senatit.</p> <p><b>2. Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit institucional</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	



Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Funksionimi i kësaj zyre shtrihet gjatë gjithë vitit akademik në përputhje me etapat e zhvillimit të procesit mësimor. Metodologjia e punës konsiston në identifikimin e detyrave që do të kryhen gjatë vitit akademik dhe përcaktimin e istancave përkatëse përgjegjëse për realizimin e tyre dhe afatet të përmbushjes së tyre.

**Realizimi i Anketave** – Kjo zyrë kujdeset për hartimin e pyetësor dhe kalimin e formës së tij në instancat përkatëse (Rektorati dhe Senati) për të marrë miratimin. Anketa është e thjeshtë, disponohet në hard-copy dhe synon tërheqjen e opinionëve të studentëve në lidhje me modulën dhe pedagogun përkatës. Gjithashtu, këtë vit kjo zyrë është kujdesur edhe për zhvillimin e një pyetësori online, ku studentëve i kërkohet informacion më i përgjithshëm mbi procesin mësimor dhe çështje të tjera. Megjithatë, ky pyetësor nuk është plotësuar në masë nga studentët. Ky proces ndodh 2 herë në vit, përpara sezonit të provimeve, për të evituar ndikimin apo deformimin e vlerësimit. Pasi përpunohen të dhënat dhe nxirret rezultati, grupi i posaçëm i punës përgatit një raport, të cilin e vendos në dispozicion të departamenteve përkatëse. Rezultatet e këtyre pyetësorëve janë pjesë e analizës vjetore të njësisë kryesore dhe asaj bazë.


**Analiza mësimore** është një proces i përvitshëm nën drejtimin e Zv Rektorit përgjegjës për mësimin. Kjo zyrë, pasi merr raportet nga fakultetet përkatës, ku pasqyrohen masat që duhet të ndërmerren për vitin ardhshëm akademik në përputhje me problematikën e evidentuara, përpunon këtë informacionin dhe prodhon produktin që është raporti përfundimtar përmbledhës i analizës mësimore të insitucionit. Në fund të raportit, nxirren detyrat dhe afatet kohore të përmbushjes së tyre në lidhje me pika të dobëta që mund të evidentohen, të cilat kërkojnë përmirësim për vitin pasardhës.

**Kontrollet në auditor**- gjithashtu kjo zyrë kujdeset edhe për mbarëvajtjen e procesit të sezonit të provimeve, respektimin e orarit nga pedagogët gjatë

**Performanca e pedagogëve** - Një moment tjetër i rëndësishëm është edhe matja e performances së pedagogëve çdo vit e cila realizohet në 3 drejtime: (a) në drejtim të procesit të edukimit, (b) në drejtim të procesit të kërkimit dhe (c) në drejtim të procesit të divulgimit përcjellja publike e dijeve dhe aftësive në shërbim të shoqërisë .

	<p>Dokumentacioni i cili përfshin procesin e rishikimit të kurrikulave dhe analizat mësimore, një proces që zhvillohet gradualisht duke filluar nga departamentet deri tek kontrolli nga strukturat përkatëse, kalon nga poshtë-lart drejt instancave më të larta (Senat dhe Rektorat) të cilat marrin vendime mbi bazën e këtij informacioni të paraqitur. Këto vendime kalohen nga lart-poshtë dhe i bëhen të ditur strukturave, departamenteve apo personave përkatës. Ky proces finalizohet me një plan masash i cili është në funksion të përmirësimit të ecurisë së programeve të studimit dhe cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër në Standardin VI.2, procesi i sigurimit të brendshme të cilësisë realizohet duke përdorur një qasje nga poshtë-lart, një proces që zhvillohet gradualisht duke filluar nga departamentet dhe më pas kontrolli nga strukturat përkatëse drejt instancave më të larta (Senat dhe Rektorat) të cilat marrin vendime mbi bazën e këtij informacioni të paraqitur. Një metode nga poshtë-lart.. Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet në tre mënyra nëpërmjet: (1) kontrollit të pedagogëve të rinj nga pedagogë me përvojë dhe pjesëmarrja e pedagogëve të rinj në leksionet e realizuara nga lektorët me përvojë, për të fituar eksperiencë; (2) vlerësimit të performacës së çdo pedagogu mbi bazë vjetore; dhe (3) anketave drejtuar studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Analiza e këtyre elementeve bëhet në rang departamenti dhe më pas përfshihet në analizën e punës mësimore dhe asaj shkencore. Këto dokumenta diskutohen në departamentin përkatës dhe më pas percillen në dekanatin përkatës. Nga ana e tij institucioni në mënyrë të përvitshme harton raportet e veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin pikërisht raportet e analizës së procesit mësimor dhe analizës së kërkimit për secilin fakultet.</p>





	<p>Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të Institucionit dhe me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional që ka përgjegjësinë institucionale. Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UBT për çdo program mësimi përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Këto metoda përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Vlerësimi me notë/pikë (materializuar në procesverbal)</li> <li>2.Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë (materializuar në procesverbal përfundimtar)</li> <li>3.Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet (materializuar në procesverbal përfundimtar)</li> <li>4.Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> </ol> <p>Të gjitha këto elemente të metodave të drejtpërdrejta të vlerësimit faktohen në një seri dokumentash duke filluar me regjistrin e pedagogut (hard copy dhe elektronik) i cili pasqyron vlerësimet e studentëve deri para hyrjes në provimin final. Procesverbali final pasqyron sërish këto vlerësime dhe shton edhe vlerësimin e provimit final duke konkluduar me vlerësimin përfundimtar të studentit në modulin në fjalë.</p> <p><i>(Doc.no.60 - Regjistri i pedagogut; Doc. no.61 - Pasqyra e vlerësimit të studentit gjatë vitit &amp; Doc. no.105 - Model Procesverbali)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e</p>	<p>Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit që ofrohen, UBT në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës dhe Alumni, ka organizuar pyetësorë të vazhdueshëm që kanë si qëllim gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet.</p> <p>Nga të gjithë studentët e gjurmuar të FEA të diplomuar gjatë vitit 2017-2018, rezulton se 12,17% janë të diplomuar të programit Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve”. Kompetencat, njohuritë dhe</p>

<p>programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program</p>	<p>aftësitë e fituara pas mbarimit të këtij programi studimi i kanë dhënë mundësi studentëve të punësohen në sektorin e Agrobiznesit apo edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë, duke qënë se 57.14% e të diplomuarve janë punësuar në profilin për të cilin janë diplomuar <b>[Doc- Gjurmimi (mbajtja e të dhënave) viti akademik 2017-2018]</b>. Një aspekt i rendësishme i këtij sondazhi lidhet me përmirësimin e vazhdueshëm dhe përputhjen e kurrikulave të studimeve me vendet e punës që mbajnë aktualisht të diplomuarit.</p> <p>Studentët e diplomuar shprehen se profilet e punës që ofron tregu përputhen me njohuritë dhe aftësitë që ofrojnë programet e studimeve në UBT, duke konfirmuar që diploma e UBT është e vlefshme për tregun e punës (<i>Doc. no.8 – Raport Performanca e QKA, fq. 19</i>)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>✓</p>

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës nëpërmjet kuadrit rregullator, përcakton dhe harton politika dhe procedura që garantojnë vlerësimin e cilësisë (<i>Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 61, Pika 1 ; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 85, Pika 1; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 91, Pika 1</i>).</p> <p>Në procesin e sigurimit të cilësisë për programet e studimit në UBT janë përfshirë studentët, personeli akademik dhe strukturat e sigurimit të cilësisë në UBT. Programet e studimit kanë pësuar ndryshime të vazhdueshme në aspektin kurrikular (<i>Doc. no. 37 - Manuali i Cilësisë</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në statutin e UBT (në nenin 69) parashikohen politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ku pranë Degës së Mësimin, Kurrikulave &amp; Vlerësimin Institucional është organizuar dhe funksionon Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë, e cila fokusohet në këto veprimtari:</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së</p>	<p>✓ Evidentimi i problematikave të lidhura me mësimin.</p>

<p>programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Evidentimi dhe ndjekja e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies.</li> <li>✓ Sigurimin i bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies.</li> <li>✓ Vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.</li> <li>✓ Realizimi i studimeve për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Universiteti.</li> <li>✓ Organizimi dhe ndjekja e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo programi studimi.</li> <li>✓ Orientimi dhe udhëheqja metodike të procedurave të veprimit për vlerësimin e brendshëm në departamente dhe fakultete.</li> <li>✓ Vlerësimi i performancës së stafit akademik.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Raportet e vlerësimit, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë (<i>Doc.no.12 – Rregullore e Programit të Studimit – Neni 61, Pika 4 ; Doc.6- Rregullore e Brendshme e DDA –Neni 85, Pika 4; Doc. no.5- Rregullores se FEA-s-Neni 91, Pika 4).</i></p> <p>Në planin e masave të publikuar nga rektorati i UBT, janë përcaktuar qartë detyrat, dhe përshkallëzimi i tyre nga njësia kryesore, tek njësia bazë e deri në nivel GMK. Një sërë detyrash brenda këtij plani masash lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si kontrolli i vazhdueshëm i kurrikulave, syllabuseve, organizimi i pjesëmarrjeve në orë leksionesh të hapura apo ftesa ndaj lektorëve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë etj.</p> <p><i>(Doc.no. 104 - Plan i masave FEA)</i></p> <p>I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të Institucionit dhe me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional që ka përgjegjësinë institucionale.</p>

	<i>(Doc. no. 37 - Manuali i Cilësisë)</i>			
	<p>Një nga objektivat kryesore të UBT është edhe përfshirja dhe aktivizimi i të gjithë aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit. Institucioni është gjithashtu shumë transparente lidhur me çfarëdo informacioni, mase apo aktiviteti që duhet të ndërmeret lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Institucioni konsultohet me aktorë të jashtëm dhe palë të treta, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>Nga takimi i realizuar me përfaqësueset e Sektorit të Mësimit, Kurrikulave &amp; Vlerësimit Institucional mësuam se zhvillohen pyetësorë, ku seksione të veçanta të tij i drejtohen bizneseve që sot operojnë në treg për të tërhequr opinionin e tyre në lidhje me ndryshimet që mendohen të bëhen në kurrikulat e programit në përmirësimin e tyre, nëse janë të nevojshme këto ndryshime në përputhje me kërkesat e tregut, apo nëse ka çështje të tjera, drejtime specifike që kërkojnë vëmendje të veçantë për ndërhyrje.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				✓

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës përcakton në dokumente përkatëse politika dhe strategji për organizimin dhe veprimtarinë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, transparente, të cilat bëhen publike për studentët dhe gjithë të interesuarit.</p> <p>Siç u diskutua edhe në takimin e realizuar Sektorit të Mësimit, Kurrikulave &amp; Vlerësimit Institucional, informacioni në lidhje me instrumentet matëse që përdoren për vlerësimin dhe ecurinë e programeve të studimit përfshihet në dokumentacionin vlerësues të këtij sektori. Rezultatet e anketimit komunikohen publikisht për të gjithë anëtarët e stafit të UBT. Rezultatet finale</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	

legjislacionin për të dhënat personale.	të përfituara prej pyetësorëve bëhen publike, duke ja komunikuar stafit. Rezultatet e anketimeve si dhe analizat në nivel departamentesh bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe vjetore që përgatitet në fund të çdo viti akademik nga ky sektor përkatës
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Publikimi i çfarëdo rezultati privat që lidhet direkt me individë të caktuar bëhet brënda respektimit të lirisë akademike dhe ruajtjes së privatësisë. Raportet individuale i bëhen të njohura çdo stafi akademik dhe ndihmës në adresën e tyre elektronike.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UBT, në funksion të përmirësimin të programeve të studimit harton një plan masash i cili adreson në mënyrë të detajuar masat/ ndërhyrjet që duhet të ndërmerren për të përmirësuar ecurinë e programeve të studimit për vitin e ri akademik. <i>(Doc.no. 87 - Analiza mësimore UBT 2018 &amp; Doc.no. 104 - Plan i masave FEA)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas dispozitave të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. Ndërmjetësuesit, përmes Koordinatorit të Sigurimit të Cilësisë hartojnë dhe japin raporte për aktivitetet dhe iniciativat e reja që lidhen me sigurimin e cilësisë për të gjitha njësitë e UBT. Funksionimi i Komisioneve është i rregulluar nga Statuti, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Komisionet koordinojnë, përpilojnë dhe raportojnë aktivitete dhe iniciativa të reja lidhur me sigurimin e cilësisë në të gjitha njësitë e UBT nëpërmjet Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Koordinatorit Institucional. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Institucionit është përgjegjës para Senatin për punën e tij. Ai diskuton dhe vendos për çështje të fushës së menaxhimit të cilësisë dhe promovon, kooperon dhe monitoron aktivitetet e sigurimit të cilësisë në universitet dhe anëtarët e tij. Për më tepër ai monitoron vetëvlerësimin impaktin dhe procedurat e vlerësimit të universitetit. Komisioni përgatit propozime për aktivitete për cilësinë, duke përfshirë prioritetet që duhet të kryhen në universitet në vitin pasardhës që vijnë si rezultat i impaktit që kanë dhënë masat e marra gjatë vitit paraardhës akademik. Propozimet e tij ja prezanton Senatit akademik. <i>(Doc. no. 37 - Manuali i Cilësisë, fq.18).</i>

Strukturat drejtuese të Universitetit gjatë tre viteve të fundit kanë ndërmarrë një iniciativë llogaridhënie para asamblesë akademike të institucionit për çështje që kanë të bëjnë më të gjithë veprimtarinë e UBT ku një vend të rëndësishëm zë edhe llogaridhënia dhe diskutimi për cilësinë e programeve të studimit. Gjatë këtij procesi përfshihen edhe studentët sepse ftohen të marrin pjesë në këtë diskutim. Proçesi përfshin vijimësinë e procesit mësimor si edhe problematikat e vërejtura gjatë viteve paraardhëse akademike, masat e marra gjatë viti të fundit akademik dhe impakti i tyre. Më tej vazhdohet me planin e ndërhyrjeve për vitin e ardhshëm akademik  
(Doc.no.114 - Njoftim i takimit me asamblenë)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht


**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave” në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” ” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës.”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit adreson nevojat specifike të tregut të punës në fushën e menaxhimit të agrobiznesit.
2. Personeli akademik i DDA, i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar dhe i aftë për të përmbushur detyrimet e këtij programi studimi.
3. Fusha kërkimore-shkencore e secilit nga anëtarët e këtij stafi është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku ata japin mësim.
4. Personel akademik ka një experience mjaft të mire pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit.
5. Personel akademik ka një experience mjaft të mire të publikimit të artikujve në revista të njohura.
6. DDA ka një eksperience mjaft të suksesshme në exchange mobility në kuadër të programe Erasmus.
7. Pjesëmarrje aktive të studentëve të FEA të vitit të fundit master në konferencat studentore të organizuara nga shoqata e studentëve.
8. Komunikim i vazhdueshëm i pedagogëve me studentët për çështje të ndryshme dhe asistim i tyre si psh. për aplikime në programet Erasmus.
9. Infrastruktura përsa i përket sallave të leksioneve, seminareve, laboratoreve etj, është e mjaftueshme për mbulimin e programit të studimit.
10. Sistemi informatik i jep informacion studentëve mbi lëndët dhe pedagogët dhe nga ana tjetër mundësi komunikimi me ta.
11. Orari mësimor me sa u konstatua nga takimet me studentët, është i përshtatshëm për kërkesat e tyre.

**Pika të dobta**

1. Për lëndë të caktuara të programit, literatura bazë dhe ndihmëse nuk është plotësisht e mjaftueshme dhe e përditësuar me literaturën e 5 viteve të fundit. Në lëndët ku përdoret cikël leksionesh, bëhet i vështirë identifikimi i materialit tek i cili është bazuar pedagogu në hartimin e temave të syllabusit. Mungesa e përdorimit të një stili të caktuar të paraqitjes së literaturës në syllabus, e bën të vështirë përcaktimin e literaturës së përditësuar për këto lëndë.
2. Mungesa e praktikës profesionale për studentët e ciklit të dytë Master gjatë periudhës së përgatitjes së mikrotezës.



3. Bashkëpunimi me aktorët e biznesit nuk është plotësisht i mjaftueshën në lidhje me praktikat profesionale.
4. Ka problematika në mbledhjen e informacionit nga studentët e diplomuar, pra në gjurmimin e tyre. Bordi i alumnit nuk funksionon në mënyrë aktive, ekziston por nuk janë mbledhur asnjëherë.

### **Rekomandime**

1. Për një program studimi Master i Shkencave nevojitet një literaturë më voluminoze krahasuar me literaturën e ciklit të parë të studimeve Bachelor, për të lejuar studentët të thellojnë plotësisht njohuritë e përfituara në ciklin e parë të studimeve.
2. Përdorimi i një stili të caktuar të paraqitjes së literaturës në syllabus (si psh. APA) do të lejonte evidentimin e disa elementeve të rëndësishëm për të identifikuar literaturën e përditësuar.
3. Referuar zhvillimeve të fundit në fusha të caktuara, ku këto të fundit përfshihen në modulet e këtij programi studimi, nevojitet një literature e përditësuar që pasqyron këto zhvillime. Një nga mënyrat e pasqyrimin të këtyre zhvillimeve është edhe dokumentimi i punës kërkimore-shkencore të pedagogëve në syllabuset e moduleve përkatëse si një vlerë e shtuar për programin.
4. Krijimi i mundësisë për të kryer një intership apo praktikë profesionale pranë një biznesi apo organizate të caktuar gjatë periudhës së realizimit të mikrotezës, do t'i vinte në ndihmë studentit për ta aftësuar dhe parapërgatitur atë për tregun e punës. Kjo mundësi mund të krijohet nëpërmjet implementimit të Projektit Gradua, i cili përveç të tjerave, do të krijojë lehtësi në vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit dhe bizneseve.
5. Ngritja sa më shpejt e rrejtit Alumni në mënyrë funksionale dhe të vazhdueshme.

### **Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave” në “Menaxhim Agrobiznesi” me profil “Administrim i Ndërmarrjeve” ” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës.”**

#### **Strengths and affirmations**

1. The study programme addresses the specific labor market needs in the field of agribusiness management.
2. Qualified academic staff capable of fulfilling the obligations of this study programme.
3. The research area of each staff members is in conformity with this study programme, the nature and the specifics of the modules where they teach.
4. Active participation of academic staff in scientific conferences at home and abroad.
5. Very good experience of academic staff in publishing articles in high-impact journals.
6. DDA has a successful exchange mobility experience within Erasmus programme.



7. Active participation of final year master students in student conferences.
8. The academic staff has a continuous communication with the students about different topics, as for example about the applications in the Erasmus Programs.
9. The Infrastructure, regarding the classes of lessons, seminars and laboratory is quite enough sufficient for this study program.
10. The Online System used by the Institution gives information to the students about the subjects, the lecturers and on the other side is a good way of communication.
11. The class hours and its schedule, are appropriate for the students, as it was seen in the meeting during the visit at the Institution.

### **Weaknesses**

1. Mandatory and recommended literature is not fully sufficient in certain programme subjects. Difficulty in defining the updated literature, especially in subjects where a cycle of lectures is used. The updated literature is not reflected in certain subjects.
2. Lack of professional internship for final year master students during preparation of Micro-thesis.
3. Collaboration with business actors is not fully sufficient in the context of professional internship.
4. There are many challenges in gathering information from the graduated students. The alumni board is not indeed functional. It currently exists, but it never had a meeting yet.

### **Recommendations**

1. Master's degree programme requires more voluminous literature than Bachelor's degree programme, to allow students to deepen the knowledge acquired in the first cycle of studies.
2. Using a certain writing style for syllabus bibliography would allow the identification of some elements, useful for identification of the updated literature.
3. An updated literature is needed to reflect the latest developments in certain areas. One way of reflecting these developments is the documentation of the latest research works of lecturers in syllabuses.
4. Creating an opportunity for final year master students to perform a professional internship with a particular business or organization during preparation of Micro-thesis. The internship period would help them to be preparing for the job market requirements. Implementation of Gradua Project will be a good opportunity for Institution to establish a better collaboration with businesses in relation to professional internships for students.
5. The functioning of the Alumni Group as soon as possible and continuously.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Niveli i përmbushjes	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				✓
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				✓
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				✓
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				✓
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				✓
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				✓

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Alban Korbi

2. PhD Ani Mbrica